

NJË USHTRI PËR KOSOVËN?

Raport për Evropë numër 174 – 28 korrik 2006

PËRMBAJTJA

| | |
|--|-----------|
| PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME DHE REKOMANDIMET | i |
| I. HYRJE | 1 |
| II. ARKITEKTURA E PËRKOQSHME E SIGURISË | 2 |
| A. KAPACITETET ZYRTARE TË SIGURISË | 3 |
| 1. Organet vendore të themeluara dhe të mbikëqyrura nga UNMIK-u..... | 3 |
| 2. Kapacitetet e qeverisë së Kosovës | 5 |
| B. AGJENTËT E JOSTABILITETIT TË BRENDSHËM..... | 7 |
| 1. Aktorët joformalë shqiptarë..... | 7 |
| 2. Strukturat serbe në veri | 9 |
| C. FORCAT NDËRKOMBËTARE TË SIGURISË..... | 10 |
| 1. KFOR-i..... | 11 |
| 2. Policia e UNMIK-ut | 12 |
| III. TRUPAT MBROJTËSE TË KOSOVËS: PENGESË APO MUNDËSI..... | 13 |
| A. MANDATI | 13 |
| B. PËRBËRJA DHE AFTËSITË | 16 |
| C. TMK-JA DHE SHOQËRIA KOSOVARE..... | 19 |
| D. MARRËDHËNIET ME BASHKËSINË NDËRKOMBËTARE | 22 |
| IV. RRUGA PËRPARA NESH..... | 26 |
| A. KONTEKSTI USHTARAK RAJONAL | 26 |
| 1. Perceptimet e shqiptarëve dhe serbëve për NATO-n..... | 26 |
| 2. Shqetësimet dhe rreshtimi ushtarak i Serbisë..... | 27 |
| 3. Drejt sigurisë kolektive | 28 |
| 4. Ushtria si ilaç për paramilitarët | 29 |
| B. OPSIONET USHTARAKE..... | 30 |
| 1. Dobitë e pasjes së ushtrisë | 31 |
| 2. Idetë e TMK-së | 31 |
| 3. Rreziku i shtëpisë së lënë në gjysmë | 32 |
| 4. Me apo pa TMK-në? | 33 |
| 5. Mes shpërbërjes dhe transformimit | 33 |
| 6. Gjetja e “brumit” të duhur | 34 |
| 7. Përfaqësimi i interesave të Serbisë | 35 |
| 8. Respektimi i traditës | 36 |
| 9. Dobitë e shtyrjes së kësaj pune | 37 |
| V. KONKLuzion | 38 |
| SHTOJCAT | |
| A. HARTË E KOSOVËS..... | 41 |
| B. FJALORTH I SHKURTESAVE DHE AKRONIMEVE | 42 |

NJË USHTRI PËR KOSOVËN?

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME DHE REKOMANDIMET

Bashkësia ndërkombëtare është vetëm disa muaj larg vendimit që pritet ta bëjë Kosovën shtet por planet për aranzhmanet për sigurinë kanë mbetur prapa. Mbi të gjitha bashkësia ndërkombëtare nuk bën të lejojë që Kosova të bëhet shtet i dobët; Kosova e ardhshme ka nevojë të keto institucione të mirëfillta që do të garantojnë sundimin e ligjit dhe paprekshmërinë e kufijve të saj, që do ta luftojnë krimin e organizuar dhe terrorizmin ndërkombëtar. Në kërkim të njohjes së pavarësisë së Kosovës nuk mund të bëhet pazar me elementet që janë të rëndësishme për ndërtimin e një shteti stabil. Përbërës thelbësor i strukturave të sigurisë në Kosovën e pavarur duhet të jetë një ushtri e ndërtuar pjesërisht mbi Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK), por më e vogël si forcë dhe e orientuar kah misionet ndërkombëtare siç janë misionet paqeruajtëse dhe që në pesë vitet e para do t'i nënshtrohet kontrollit të rreptë të NATO-s dhe do të ketë madhësi dhe kompetenca të kufizuara.

Nevojat për siguri në një Kosovë të pavarur janë më se të qarta. Ajo ka nevojë për siguri të brendshme dhe mbrojtje nga sulmet nga jashtë, por në të njëjtën kohë nuk mund të bëhet kërcënim për fqinjët. Strukturat ekzistuese, formale, të sigurisë duhet të vihen nën kontrollin e institucioneve të reja të qeverisë demokratike. Strukturat e armatosura ekzistuese, joformale, edhe ato të mbetura nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës si edhe ato të lidhura me krimin e organizuar, duhet të minimizohen. Pakicat etnike – veçanërisht serbët e Kosovës – duhet të mbrohen e jo të kërcënohen nga strukturat shtetërore të sigurisë.

NATO duhet të jetë e gatshme që të mbajë forcën e saj paqeruajtëse në Kosovë (KFOR) në gjendjen në të cilën është tani për një kohë më të gjatë, që të garantojë mbrojtjen nga jashtë dhe – në një masë më të vogël – të kontribuojë në ruajtjen e stabilitetit të brendshëm, pra duhet t'u rezistojë presioneve që kjo forcë të reduktohet dhe të shuhet fare para se shteti i ri të normalizojë marrëdhëniet me Serbinë dhe të dy këto vende të bëhen anëtarë të programit Partneritet për Paqe (PpP) (Partnership for Peace - PfP).

Edhe pse sipas disave – pasi ka prani të KFOR-it – Kosova e varfër dhe e ndarë nuk ka nevojë të ketë ushtrinë e saj, megjithatë demilitarizimi i plotë nuk është i realizueshëm. Mosbesimi i madh që mbretëron e bën këtë ide të paqëndrueshme. Kjo do të shndërrohej në një fasadë pas të cilës do të fshiheshin grupet paramilitare jozyrtare duke e kthyer vendin e ri – dhe fqinjët e saj – në vend më pak të sigurt dhe më pak të aftë për të mbajtur rendin dhe ligjin. Një ushtri zyrtare, e vogël, e zhvilluar nën mbikëqyrjen e NATO-s, është mjeti më i mirë për të bërë demilitarizimin gradual të shoqërisë si dhe për t'ia mundësuar Kosovës pjesëmarrjen në marrëveshjet kolektive rajonale për sigurinë, që janë çelës i sigurisë dhe demilitarizimit të qëndrueshëm.

Nëse do të menaxhohej dhe udhëhiqej mirë, ushtria do të ndihmonte në zhvillimin e një identiteti stabil dhe multi-etnik, apo së paku etnikisht neutral, të shtetit të ri. Ndërtimi i një ushtrie profesionale, të bashkuar dhe që përfaqëson të gjitha komunitetet, në një shtet të përcarë thellë mes shumicës shqiptare dhe pakicës serbe refuzuese, kërkon që hapat të zgjidhen me kujdesin më të madh. Elementet që nuk dëshirojnë të bëhen pjesë e saj nuk duhet të detyrohen të bëjnë këtë; në anën tjetër, një ushtri e tillë nuk mund të krijohet pa marrë në konsideratë institucionet ekzistuese dhe aspiratat e shumicës që kanë var shpresat dhe besimin në forcën mbrojtëse civile të dalë nga UÇK-ja, TMK-në.

Do të jetë shumë e vështirë që të ndërtohet një identitet i Kosovës që nuk do të jetë ekskluzivisht shqiptar. Bashkësia ndërkombëtare duhet të jetë realiste dhe të shfrytëzojë levat që ka për të ndikuar në shoqërinë kosovare. TMK-ja, me evoluimin e pjesshëm nga rrënjë dhe bazë paramilitare, me varësinë në ekspertizën e NATO-s dhe me vullnetin që të bëjë ndërrime thelbësore, paraqet një rast të mirë për të ndërtuar një ushtri.

Kjo ushtri duhet të jetë e vogël, e pajisur me armatim të lehtë, forcë multi-etnike me 2.000 deri 3.000 trupa, të trajnuar nga një mision i veçantë i NATO-së sipas një plani dhe orari transparent dhe e cila do të bëhej operacionale plotësisht diku kah vitet 2011-2012. Kjo

nuk do të duhej të dyfishonte funksionet policore por do të duhej të ishte e orientuar kah kërcënimet nga jashtë, të bëjë hapat e parë operacional në iniciativat rajonale dhe operacionet paqeruajtëse ndërkombëtare, e pastaj gradualisht të bëhet anëtare e PpP si dhe anëtare e vet NATO-s. Qysh në viti 2007 duhet kërkuar rastin për dërgimin e tyre jashtë vendit, duke shfrytëzuar ekspertizën e ndërtuar në TMK, siç është ajo për deminim. Detyrat e ushtrisë në çështjet e sigurisë së brendshme duhet të kufizohen në masë të madhe dhe të mos shkojnë shumë më larg se sa mandati që ka tani TMK-ja për mbrojtjen civile, ndërtim dhe rindërtim.

E tërë kjo duhet të bëhet në bazë të marrëveshjeve të arritura në kuadër të zgjidhjes së statusit final të Kosovës. Këtu duhet të caktohen një varg kufizimesh për numrin dhe kompetencat e ushtrisë si dhe rolin e NATO-s në qeverisjen dhe udhëheqjen e saj. Kjo nuk është e thënë të negociohet me Prishtinën apo Beogradin e madje mund të ketë vetëm formën e një vendimi të Këshillit Veri-Atlantik të NATO-s apo të Grupit të Kontaktit që udhëheq procesin e statusit. Megjithatë, është më mirë që bashkësia ndërkombëtare të shfrytëzojë të gjitha levat që ka në dispozicion që gjatë zgjidhjes së statusit final të sqarohet kjo çështje e jo kjo të lihet pezull për t'u marrë me të më vonë. Duhet të synohet që Kosova, gradualisht, të futet në Partneritetin për Paqë (PpP), së bashku me Serbinë, e pastaj marrëveshja/vendimi të zëvendësohet me marrëveshje të reja. Mekanizmat e PpP-së mund të shfrytëzohen që ushtria të përgatitet të marrë nga KFOR-i rolet për garantimin e sigurisë duke ia mundur KFOR-it që në fund të tërhiqet tërësisht.

NATO dhe BE duhet të vazhdojnë të bëjnë presion mbi Prishtinën që kjo të jetë më kreative në inkuadrimin (përfshirjen) e serbëve të Kosovës në çështjet e sigurisë e veçanërisht në ushtri. Tradita serbe duhet të përfaqësohet në ushtri, duke plotësuar traditën shqiptare të UÇK-së dhe të TMK-së. NATO dhe BE duhet të punojnë së bashku edhe në krijimin e një ambienti që do të mirëpret dhe do të mbështesë iniciativat e Prishtinës. Shpejtësia e hyrjes së Serbisë në BE dhe në NATO duhet të kushtëzohet edhe me trajtimin që ajo i bën fqinjët të vet jugor, veçanërisht me atë se sa i inkurajon apo i dekurajon serbët e Kosovës që të integrohen në strukturat e reja.

REKOMANDIMET

Pregaditjet paraprake:

1. Grupi i Kontaktit, Këshilli i Sigurimit i OKB-së dhe Zyra e të dërguarit special të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për procesin për statusin e ardhshëm të Kosovës (UNOSEC) duhet të

përcaktojnë statusin final të Kosovës ashtu që të lejojë krijimin e ushtrisë.

2. Grupi i Kontaktit dhe NATO duhet të përpilojnë një aneks apo një formë tjetër ligjërimit apo politikisht obliguese në kuadër të zgjidhjes së statusit final që do të paraqesë hapat që do të ndërmerren për të zhvilluar një forcë mbrojtëse të vogël të Kosovës, që do të kufizonte numrat dhe kompetencat e saj – të mos ketë më shumë se 3.000 trupa dhe të mos ketë tanke, artileri të rëndë, predha tokë-tokë apo fluturake sulmuese – deri atëherë kur edhe Kosova edhe Serbia të bëhen pjesë e Partneritetit për Paqe (PpP) të NATO-s.
3. NATO duhet të shohë TMK-në si burim primar për krijimin e ushtrisë së re dhe nuk duhet ta shpërbëjë atë para se të ndërtohet struktura e re.

Ndërtimi i kapaciteteve në ndërkohë:

4. KFOR-i duhet të zhvillojë një partneritet më të afërt me TMK- në, të thellojë dhe standardizojë marrëdhëniet trajnuese në tërë Kosovën, ashtu që të gjitha Task-Forcat Shumëkombëshe të bashkëpunojnë deri në nivelet më të ulëta.
5. Donatorët duhet të ushqejnë më tepër TMK-në: të ofrojnë më shumë trajnime të specializuara, më shumë fonde për infrastrukturë dhe për projektet për rindërtim si dhe më tepër pajisje për rolet e saja për mbrojtjen e civilëve.
6. Qeveria e Kosovës duhet të shtojë kapacitetet e veta për përpilimin e politikave të sigurisë, të shtojë buxhetin për krijimin e ministrisë së mbrojtjes dikur mes 2007 e 2008, apo që së paku të mbajë buxhetin prej 15 milion dollarë në vit për TMK-në, sa është tani, dhe të sigurohet se çfarëdo rritjesh të ardhshme të atij që do të jetë buxhet i mbrojtjes do të jenë të qëndrueshme.
7. Donatorët duhet të shtojnë fondet për demobilizimin e 1.500 deri 2.000 anëtarëve të TMK-së, në koordinim me qeverinë e Kosovës që do të duhej të përgatiste bazën ligjore për demobilizimin dhe me Organizatën Ndërkombëtare për Migrim (International Organisation on Migration – IOM) e cila duhet të rinisë operacionet për një program të ri të ri-sistemimit në Kosovë.

Hapat drejt formimit të ushtrisë, nga viti 2007:

8. Me kërkesë të qeverisë së Kosovës dhe sipas udhëzimeve të statusit final të propozuar, NATO duhet të themelojë një mision trajnues ushtarak të veçantë që do të vepronte në kudër të Zyrës së

- Koordinatorit të TMK-së: kjo zyre duhet të riuatohet dhe t'i raportojë komandantit të KFOR-it (COMKFOR) pas largimit të Misionit të OKB-së (UNMIK).
9. Ministria e Mbrojtjes e Kosovës duhet të themelohet gjatë viteve 2007-2008 duke pasur për bazë Zyrën e Koordinatorit të TMK-së të cilës do t'i rritej numri i stafit vendor; nga viti 2007 duhet të fillojë të veprojë Këshilli kombëtar i sigurisë në të cilin zyrtarët ndërkombëtarë do të përfaqësonin interesat e pakicës serbe nëse këta për fillim bojkotojnë institucionet.
 10. Shtabi i përgjithshëm i TMK-së, Zyra e Koordinatorit të TMK-së dhe misioni trajnues i NATO-s duhet që bashkërisht të filtrojnë të gjithë pjesëtarët e TMK-së të cilët do të shërbejnë në ushtrinë e re, duke u bazuar në këto parime:
 - (a) NATO duhet të ketë fjalën përfundimtare për të gjithë kandidatët;
 - (b) Vlerësimi duhet të bëhet në bazë të testeve, avancimit të akumuluar profesional të kandidatit si dhe dosjeve të disiplinës;
 - (c) Pjesëtarët e TKM-së, kandidaturat e të cilëve nuk do të pranohen si dhe ata që nuk dëshirojnë të shërbejnë në forcën e ardhshme do të orientohen për demobilizim dhe për programet për risistemim; dhe
 - (d) Vendet e mbetura në ushtri duhet të plotësohen gradualisht me rekrutë të ri.
 11. Ushtria e re duhet të ketë uniforma të stilit të ushtrisë amerikane apo të ushtriave evropiane, ndryshe nga uniformat e TMK-së apo uniformat tjera që kanë konotacione të historisë së vonë të vendit, si dhe distinktivë dhe simbole që janë etnikisht neutrale.
 12. Anëtarë të interesuar të NATO-s duhet të ndihmojnë me donacione në pajisje për ushtrinë e re, në koordinim me misionin trajnues.
 15. NATO duhet të caktojë kritere strikte për hyrjen e Kosovës në PpP, përfshirë përfaqësimin e serbëve në ushtri dhe, në bashkëpunim me BE-n, të inkurajojë qeverinë e Kosovës që të krijojë hapësirë politike dhe iniciativa konkrete që do të ndihmojnë në përmbushjen e këtyre kritereve.
 16. NATO dhe BE, së bashku, duhet t'ia bëjnë të qartë Serbisë se anëtarësimi i saj varet shumë nga qëndrimi që ka ndaj Kosovës, veçanërisht nga ajo nëse i inkurajon apo i dekurajon serbët e Kosovës që të integrohen në strukturat e shtetit të ri.

Prishtinë/Beograd/Bruksel, 28 korrik 2006

Hapat e ardhshëm, drejt Partneritetit për Paqe:

13. Dega e ushtrisë për mbrojtjen civile dhe rindërtim, që do të inkorporojë ekspertizën e TMK-së, duhet të jetë operacionale menjëherë, ndërsa dega e këmbësorisë duhet të jetë gati pas trajnimeve gjegjëse, dikur rreth viteve 2011-2012.
14. Specialistë të elementeve mbrojtëse të ushtrisë së Kosovës, siç janë deminuesit, duhet të dërgohen në misione paqeruajtëse ndërkombëtare sa më parë që të jetë e mundur, para se e tërë ushtria të jetë operacionale.

NJË USHTRI PËR KOSOVËN?

I. HYRJE

A duhet Kosova e pavarur të ketë ushtrinë e saj, sikur çdo vend tjetër? Disa vende anëtare të Grupit të Kontaktit¹ nuk mendojnë kështu: si një shtet i dobët që duhet të punojë të fitojë njohje dhe besimin e fqinjëve të vet dhe botës më gjerë, do të ishte më mirë që tërë energjitë dhe resurset t'i derdhë në zhvillimin civil. Në çështjen e sigurisë në Kosovë bashkësia ndërkombëtare nuk di çfarë të bëjë. A duhet të përqendrohet në ruajtjen e territorit dhe kufizimin e kompetencave të tij apo duhet të mbështesë zhvillimin e Kosovës në një faktor që kontribuon në sigurinë rajonal dhe që është partner i barabartë në rajon? Pasi forca e NATO-s në Kosovë (KFOR) do të mbetet në Kosovë edhe pasi kjo të fitojë – siç pritet – pavarësinë e kushtëzuar, shumë pyesin pse Kosova të ketë një forcë kombëtare sidomos nëse kjo do të zemëronte edhe më tepër Serbinë që edhe ashtu e ka të vështirë të pranojë statusin e ri. Të tjerët theksojnë që do të ishte e rrezikshme që Kosovës t'i mohohet që të jetë edhe formalisht e barabartë me fqinjët e saj në çështjet e sektorit të sigurisë, që të jetë “delja e zezë” e rajonit, pa të drejtë që të jetë pjesë e Partneritetit për Paqe të NATO-s e më vonë edhe e vet e aleancës.

Kompromiset diplomatike rreth paketës për statusin e Kosovës do të bazohen më pakë në problemet e Kosovës e më tepër në problemin e bashkësisë ndërkombëtare; një model i qëndrueshëm i sigurisë për Kosovën shumë lehtë mund të ndodhë të mos gjejë vend në emëruesin më të vogël të përbashkët të Grupit të Kontaktit. Prandaj, Grupi i Kontaktit nuk është i sigurt për atë se sa duhet të mbështesë konkluzionet e Rishikimit të Sektorit për Siguri të Brendshme, i njohur me akronimin në gjuhën angleze ISSR (Internal Security Sector Review) që po zhvillohet në Kosovë.² Misioni i OKB-së në Kosovë

(UNMIK) ka përvojë shtatëvjeçare në ndërtimin e institucioneve, përfshirë themelimin dhe mbajtjen e pasardhëses së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK), që ka aspirata të bëhet ushtri. Çarja mes shqiptarëve e serbëve vetëm sa thellohet edhe më sa më shumë që i afrohem vendimit për statusin, gjë që kufizon mundësitë për të përpiluar një plan ideal për sigurinë. Kur të vijë koha, dikur më vonë në vitin 2006, që bashkësia ndërkombëtare të jetë më e qartë sa i përket statusit të Kosovës, reagimet serbe sigurisht do të jenë një përzierje e pranimin të heshtur, eksodit dhe rezistencës në proporcione që është e vështirë të parashikohen. Organet e sigurisë të krijuara nga OKB-ja në Kosovë, në pjesën dërmuese të dominuar nga shqiptarët e Kosovës, do të gjenden në një kontekst të ri në të cilin debati dhe konsensusi për formën dhe rolin e tyre do të jetë i papërfunduar ndërsa shumë nga kapacitetet e tyre ende në ndërtim e sipër.

Nevojat për siguri të një Kosove të pavarur janë më se të qarta. Shteti i ri do të ketë nevojë të mbrohet nga sulmet nga jashtë dhe nga jostabiliteti i brendshëm dhe në të njëjtën kohë nuk bën të jetë kërcënim për fqinjët e vet. Strukturat ekzistuese formale të sigurisë duhet të jenë nën kontrollin demokratik të institucioneve qeveritare. Strukturat e armatosura ekzistuese joformale, edhe ato të dala nga UÇK-ja si edhe ato të lidhura me krimin e organizuar, duhet të minimizohen. Pakicat etnike – veçanërisht serbët e Kosovës – duhet të mbrohen e jo të kërcënohen nga strukturat shtetërore të sigurisë.

Edhe pse KFOR-i do të mbetet në Kosovë edhe për disa vite ndërsa misioni i ri i dominuar nga BE-ja do të marrë disa prerogativë që tani ka OKB-ja në mbikëqyrjen e policisë dhe drejtësisë, megjithatë pavarësia do të sjellë ndërrime edhe në sigurinë e brendshme të Kosovës por edhe në ekuacionin e sigurisë rajonale. Sot, arkitektura e sigurisë së brendshme në Kosovë është një rrjet kompleks i forcave ndërkombëtare, organeve zyrtare vendore të themeluara nga administrata ndërkombëtare, por edhe i organeve, grupeve dhe lëvizjeve joformale e ilegale. Ndër këta të fundit ka grupe të mbetura nga UÇK-ja, ka grupe kriminale e deri te grupet paramilitare të serbëve të

¹ Fillimisht i krijuar në vitin 1994 që të merret me çështjen e Bosnjës, Grupi i Kontaktit përbëhet nga vendet kryesore të interesuara për Ballkanin: Shtetet e Bashkuara, Mbretëria e Bashkuar, Franca, Gjermania, Italia dhe Rusia. Luan rol kryesor në përcaktimin e agjendës për caktimin e statusit të ardhshëm të Kosovës.

² Shih Raportin për Evropë të Grupit të Krizave numër 170, *Kosova: Sfidat e Tranzicionit*, 17 shkurt 2006, fq. 9-10, për një

përshkrim të hapave të parë të ISSR. Për më tepër, shih më poshtë.

Kosovës dhe strukturat e sigurisë së Serbisë. Atëherë çfarë duhet bërë për t'u siguruar se zbrazëtitë nuk shfrytëzohen nga aktorë të padëshirueshëm? Si të sigurohemi se shteti i ri i Kosovës i kontribuon stabilitetit rajonal dhe nuk e kërcënon atë? A janë qendrore apo periferike çështjet se çfarë të bëhet me TMK-në dhe nëse Kosova duhet të lejohet të ketë ushtri të veten?

Këto pyetje të vështira nuk mund të lihen për më vonë. Ky raport propozon si të lëvizet përpara duke supozuar se Kosova do të fitojë pavarësi të kushtëzuar deri më apo pak pas fundit të vitit 2006.

II. ARKITEKTURA E PËRKOHSHME E SIGURISË

Siguria në Kosovë ofrohet nga forca paqeruajtëse ndërkombëtare e udhëhequr nga NATO (KFOR) e përbërë nga 16.000 trupa që vijnë nga 37 vende dhe nga policia e UNMIK-ut e përbërë nga 46 vende të ndryshme. Deri sa të jetë në fuqi Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së e cila i dha fund luftës së vitit 1999 dhe në bazë të së cilës është ndërtuar sistemi pas luftës, përgjegjësitë dhe kontrollin e drejtpërdrejtë mbi çështjet e sigurisë i kanë Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së (PSSP) që kryeson UNMIK-un dhe mbikëqyr institucionet ligjvënëse³, dhe komandanti i KFOR-it (COMKFOR) që është përgjegjës për mbajtjen e një “ambienti të qetë dhe të sigurt” në kuadër të të cilit mund të funksionojë misioni civil. Ndarja e përgjegjësisë është e paqartë dhe për pasojë reagimi në trazirat e marsit 2004 ishte katastrofal.⁴ Duke filluar nga çereku i fundit i vitit 2004, ish-PSSP-ja i cili sa po është larguar, Soren Jessen-Petersen, vuri marrëdhënie më të afërta me Komandantët e KFOR-it, marrëdhënie të cilat bënë që në kohën e tij të evitohet rishfaqja e këtij problemi.

Rezoluta 1244 dhe Korniza Kushtetuese e vitit 2001 që e përgatiti UNMIK-u ka vënë frenat e çështjes së sigurisë në duart e UNMIK-ut, por që nga viti 2005, misioni ka punuar që të shpejtojë transferimin e kufizuar të kompetencave duke krijuar bazën ligjore për Shërbimin Policor të Kosovës si dhe fillet e ministrisë së Drejtësisë dhe asaj të Brendshme. Por, për sa kohë që në Kosovë të jetë UNMIK-u, ai dhe KFOR-i do të kenë fjalën e fundit e jo përfaqësuesit e zgjedhur të Kosovës,⁵ siç u pa në mars të vitit 2005 kur ndërmorën operacionin për dërgimin në qendrën e paraburgimit në Hagë të kryeministrit të deriatëhershëm.

³ Kapitulli Shtatë i Kornizës Kushtetuese i jep PSSP-së “autoritet mbi institucionet e rendit e ligjit dhe të shërbimit korrektues, që kanë personel vendor apo mbështeten nga personeli vendor”, dhe “të ushtrojë kontroll dhe autoritet mbi Trupat Mbrojtëse të Kosovës”.

Kapitulli i Tetë i jep PSSP-së pushtet dhe përgjegjësi për “të ushtruar kontroll dhe autoritet mbi menaxhmentin e administratës dhe financimin e sigurisë civile dhe gatishmërisë për emergjenca. Përgjegjësia do t'i transferohet gradualisht Institucioneve të Përkohshme të Vetë-Qeverisjes”. Në: http://www.unmikonline.org/pub/misc/FrameworkPocket_ALB_Dec2002.pdf.

⁴ Shih Raportin për Evropë të Grupit të Krizave numër 155, *Kolapsi në Kosovë*, 22 prill 2004.

⁵ Shih: Ilir Dugolli dhe Lulzim Peci, “Forcimi i mbikëqyrjes civile dhe i menaxhimit të sektorit të sigurisë në Kosovë”, KIPRED/Saferworld, nëntor 2005, për një kritikë të hapësirës së kufizuar që OKB-ja ka krijuar për angazhimin dhe përgjegjësitë e vendore.

Por, nën këtë shtresë të autoritetit ndërkombëtar dhe strukturave ndërkombëtare të sigurisë, faktori vendës është duke u fuqizuar gjithnjë e më shumë. Organet vendore që i ka zhvilluar UNMIK-u në shtatë vitet e fundit, siç është SHPK-ja, po luajnë rol gjithnjë e më të madh. KFOR-i dhe UNMIK-u bëjnë shpërndarje të tillë të forcave dhe përpilojnë politika që nuk lejojnë shqiptarët dhe serbët që të mobilizohen kundër njëri tjetrit në qytetin e ndarë të Mitrovicës dhe në veri në përgjithësi. Këta kanë bashkëpunuar me liderët e ish-UÇK-së siç janë ish-kryeministri Haradinaj dhe kryeministri i tashëm Çeku dhe me organizatat si TMK-ja që nga shoqëria shqiptare shikohen si shtylla të sigurisë por nga serbët dhe nga Serbia shihen si ekstremistë që synojnë të përmbyllin pastrimin etnik.

A. KAPACITETET ZYRTARE TË SIGURISË

1. Organet vendore të themeluara dhe të mbikëqyrura nga UNMIK-u

UNMIK-u është përgjegjës për disa organe të sigurisë dhe mbajtjes së rendit që kanë staf vendor: Shërbimin Policor të Kosovës (SHPK) që ka 7.000 trupa, Shërbimin Korrektues të Kosovës (SHKK) me 1.200 pjesëtarë dhe Shërbimin Doganor të UNMIK-ut me 560 pjesëtarë. Orari i procesit për statusin dhe jopopullaritetin relativ i UNMIK-ut si dhe gjasat që ky të përfundojë misionin e vet kah mesi i vitit 2007 kanë bërë që të shpejtohet ndërtimi i kapaciteteve dhe institucioneve vendore si edhe transferimi i kompetencave. SHPK-ja është zhvilluar në një shërbim të dalluar vendor që gradualisht ka marrë përgjegjësitë nga policia ndërkombëtare e OKB-së. Formalisht, shërbimi korrektues dhe shërbimi doganor janë të udhëhequra nga ndërkombëtarët por që të dy këto shërbime në masë dërmuese përbëhen nga stafi vendor. Në to tani janë vetëm disa zyrtarë të lartë ndërkombëtarë që drejtojnë zhvillimin e tyre por pa u bazuar shumë në ndërkombëtarët, gjë kjo që synohet të bëhet edhe në polici.

Ndryshe qëndron puna me TMK-në, që i është lënë në dorë UNMIK-ut në shtator të vitit 1999 si produkt i Marrëveshjes për Demilitarizim dhe Transformim, të qershorit 1999, mes UÇK-së dhe KFOR-it.⁶ Derisa SHPK-ja është zgjeruar, TMK-ja është tkurrur. Pagat dhe vendet e punës të 2.000 trupave rezervë nga gjithsej 5.000

trupa që ishin të punësuar me orar të plotë u ndërpre në vitin 2003 ndërsa TMK-ja më nuk ka fonde për t'i angazhuar ata. Derisa buxheti i SHPK-së është rritur në rreth 60 milion euro, ai i TMK-së ka mbetur në rreth 15 milion euro; policia është caktuar të kryejë punët që TMK-ja i donte për vete: mbrojtjen e afërt, anti-terrorizmin, sigurinë e ndërtesave qeveritare dhe lokacioneve religjioze serbe. Zyrtarisht, TMK-ja nuk ka rol në çështjen e sigurisë por shqiptarët vazhdojnë ta shikojnë si një shtyllë të veçantë të sigurisë; TMK-ja është më e popullarizuar se cilido institucion tjetër, përfshirë këtu edhe SHPK-në e KFOR-in.⁷

Të dyja, TMK-ja dhe SHPK-ja, kanë në gjirin e tyre nga 2.000 pjesëtarë të ish-UÇK-së.⁸ Duket ironike që është TMK-ja ajo që identifikohet me ish-kryengritësit ndërsa SHPK-ja shihet si një sukses i multi-etnicitetit edhe pse ajo ka po aq ish-luftëtarë të UÇK-së sa ka edhe TMK-ja. Rreth 25 për qind e 7.000 pjesëtarëve të SHPK-së si dhe 70 për qind e 3.052 trupave aktive të TMK-së një kohë ishin luftëtarë. Ata në TMK janë prej atyre që morën pjesë në programin për demobilizimin e UÇK-së, program ky i menaxhuar nga Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM). "Mua më ranë hise pjesëtarët e UÇK-së që nuk kishin çfarë tjetër të bënin", thotë ish-komandanti i TMK-së Çeku.⁹ Ata në SHPK kanë aplikuar për vendet e punës, janë futur në teste dhe janë zgjedhur, gjysma apo më tepër pas një marrëveshjeje për kuotën e dakorduar në fund të vitit 1999, ndërsa të tjerët janë pranuar vet gjatë fazave tjera të rekrutimit.

Dy komponenta tjera të rëndësishme të SHPK-së janë ish-policët, kryesisht shqiptarë, që kanë shërbyer para viteve

⁶ Teksti mund të gjendet në Internet në: www.nato.int/kfor/kfor/documents/uck.htm. Transkripti i konferencës për gazetarë të 21 shtatorit 1999 në të cilin PSSP-ja Bernard Kouchner dhe COMKFOR-i, Mike Jackson, komentuan marrëveshjen për krijimin e TMK-së, mund të gjendet në Internet në www.nato.int/kosovo/press/1999/k990921b.htm.

⁷ Rasti më i fundit është anketimi i bërë nga Qendra Gani Bobi, me 850 shqiptarë dhe pakica jo-shqiptare, publikuar nga KUMT Consulting, në fillim të qershorit 2006. TMK-ja gëzonte përkrahjen e 83,4 për qind të të anketuarve, SHPK-ja të 69,6 për qind, KFOR-i 63,2 për qind; 3,4 për qind nuk i besonin TMK-së, 8,8 për qind SHPK-së, 9,1 për qind KFOR-it. Institucionet e Përkohshme të Vetë-Qeverisjes (IPVQ) gëzonin besimin e 45-50 për qind të të anketuarve. Institucionet ndërkombëtare edhe më pak: Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) gëzonte besimin e 40 për qind dhe UNMIK-u të 30,7 për qind të të anketuarve; 30,6 për qind janë shprehur se nuk i besojnë UNMIK-ut. Një anketim tjetër i bërë në qershor për Raportin e Paralajmërimit të Hershëm të UNDP-së, me të gjitha grupet etnike ka dhënë rezultate të ngjashme: 87,15 për qind janë shprehur të kënaqur me TMK-në, 81,75 për qind me SHPK-në, 80,94 me KFOR-in. Rezultatet për IPVQ-në dhe UNMIK-un ishin të ngjashme me ato të anketës të bërë nga Gani Bobi.

⁸ Ekziston një diskrepancë mes numrave për fuqinë e UÇK-së në terren në vitet 1998-1999, që është 15.000 apo më pak, dhe numrit prej 25.000, sa janë regjistruar si luftëtarë të UÇK-së në programin për demobilizim të IOM-së të bërë në fund të vitit 1999/fillim të vitit 2000.

⁹ Intervistë e Grupit të Krizave, Prishtinë, 23 shtator 2003.

nëntëdhjetë në Krahinën Autonome të Kosovës si dhe ish-pjesëtarët apo pjesëtarët e tashëm të Ministrisë së Brendshme të Serbisë (MUP) prej të cilëve shumica marrin paga edhe nga Beogradi. Të gjitha vendet e lira në TMK, tani janë të rezervuara për kandidatët nga pakicat etnike. TMK-ja është duke u përpjekur t'i plotësojë këto vende përkundër pengesave që vijnë nga serbët e Kosovës dhe nga Beogradi. Në anën tjetër, SHPK-ja shumë më lehtë ka arritur kuotën prej 15 për qind pjesëtarë nga pakicat, ndërsa synon të ketë 20 për qind kur të arrijë numrin prej 7.400 pjesëtarëve sa është e planifikuar ti ketë. Beogradi nuk e ka penguar rekrutimin e serbëve as në Shërbimin doganor e as në atë korrektues.

Por, presioni për ndarje në vija etnike në SHPK dhe në shërbimin doganor është duke u shtuar. Shumica e politikanëve serbë janë në favor të krijimit të stacioneve të SHPK-së në nivel komunal në zonat e banuara me serbë e që do të ishin nën kontroll të dobët të qendrës në Prishtinë. Sidomos në veri serbët refuzojnë që të bëhen pjesë e njësisive në nivel rajonal apo që të marrin postet e larta në shtabin qendror në Prishtinë, ndërsa shqiptarët në njësitë rajonale si dhe në shërbimin doganor nuk priten mirë. Me një bashkëdyzim të kontrollit paralel nga MUP-i, të bojkotimeve dhe të kërcënimeve, lidhshipi serb në veri po përpiqet që të bëjë SHPK-në lokale një forcë çfarë atyre u konvenon. Ngjashëm ka ndikuar edhe në ndarjen në vija etnike të shërbimit doganor. Pasi në qershor 2006 doganierët shqiptarë janë kërcënuar, tani në veri të lumit Ibër shërbejnë vetëm doganierë serbë. Të gjithë serbët që kanë shërbyer në pjesë tjera të Kosovës tani janë dërguar të shërbejnë në veri që të plotësohet vakumi i krijuar pas tërheqjes së atyre shqiptarë, por edhe pas largimit nga puna të shumë doganierëve të përzier në kontrabandën e cila është aq e zhvilluar në veri.

Në vitin 2005 UNMIK-u ka ndërmarrë një iniciativë për dërgimin e policëve ndërkombëtarë në enklavat serbe në një rritje të stacioneve policore të fshatrave e që tani po zëvendësohen nga oficerë të SHPK-së. Kjo po shpie drejt krijimit të një policie kryesisht serbe që është relativisht e ndarë nga komanda në nivel komunal e dominuar nga shqiptarët.

UNMIK-u po i delegon gjithnjë e më shumë kompetenca SHPK-së, që tani kryen funksione të përditshme policore. SHPK-ja ka zhvilluar identitetin e saj dhe duket shumë më e fortë se sa para dy viteve, më e gatshme që të qetësojë turma se sa policia e UNMIK-ut dhe më e informuar për lidhjet kriminale në vend.¹⁰

Qytetarët tani janë më të gatshëm që ta ndihmojnë në zbulimin e krimeve ordinere edhe pse kur është fjala për grupet kriminale më të fuqishme që mendohet se kanë lidhje me politikën, bashkëpunimi me SHPK-në është më i zbehtë; ndërsa elementet e korruptuara në SHPK, gjykata dhe në prokurori pengojnë arritjen e rezultateve. Si në SHPK ashtu edhe në Shërbimin Doganor gjenerata e re e oficerëve duket më e motivuar profesionalisht por ka nevojë për mbrojtjen e mbikëqyrësve ndërkombëtarë për të mbajtur larg tyre forcat politike grabitqare. Profesionistë të tillë e mbajnë gjallë shërbimin doganor ndërsa mbrohen nga një drejtor i përgjithshëm ndërkombëtar. Në anën tjetër, një gjeneratë më e vjetër ende mban numrin më të madh të posteve të larta në SHPK.¹¹

SHPK-ja është e madhe në numër, me përafërsisht një polic për 300 qytetarë. Ky është numër i ngjashëm me atë në Maqedoninë fqinje por edhe në vendet tjera të Evropës Lindore.¹² Por, Krahinë autonome e Kosovës e para nëntëdhjetave kishte vetëm 3.000 policë. Për më tepër, numri i planifikuar prej 7.400 oficerëve të SHPK-së është dy herë më i madh se sa 3.500 deri 4.000 sa synohej të ishin në fillim.¹³ Zyrtarë të lartë besojnë se kjo forcë mund të rritet edhe pas përcaktimit të statusit final.¹⁴ Ky zgjerim në njëfarë mënyre mund të shikohet edhe si kompensim për mungesën e një ushtrie të Kosovës.¹⁵ Që nga mesi i vitit 2004, zhvillimi i SHPK-së i ka ngjarë më tepër zhvillimit të një ushtrie. Gjashtë Njësi Rajonale për Mbështetje të Operacioneve të njohura me akronimin në gjuhën angleze ROSU (Regional Operation Support Unit) i ngjasojnë një xhandarmerie dhe janë të pajisura e të trajnuara për t'u përballur me trazira – edhe pse UNMIK-u insiston se “ata janë të trajnuar që të mos i rrahin njerëzit”.¹⁶ Ekzistojnë plane që policia kufitare të rritet

zinxhir të vetin komandues. KFOR-i dhe UNMIK-u ose e neglizhuan ose nuk e lanë të angazhohet.

¹¹ Intervista të Grupit të Krizave me zyrtarë të SHPK-së dhe të Shërbimit doganor, maj dhe qershor 2006.

¹² Maqedonia ka 8.200 policë për një popullatë prej 2,4 milion banorëve, pra një për 293 qytetarë. Gjatë epokës sovjetike, Evropa Lindore kishte mesatarisht 1 polic për 380 qytetarë. Sipas një studimi të vitit 1965, në 136 vende, raporti ishte rreth 1:715. Shih (në gjuhën angleze) David H. Bayley, *Patterns of Policing: a Comparative International Analysis* (New Brunswick, 1985), fq. 76.

¹³ Shih Raportin për Evropë të Grupit të Krizave numër 74: *Mangësitë në polici: Rendi dhe ligji në Kosovën e re*, 6 gusht 1999, fq.7.

¹⁴ Intervistë e Grupit të Krizave, 30 shtator 2005.

¹⁵ Komisionari i policisë, Kai Vittrup, dha një shpjegim tjetër sipas të cilit kuantiteti është zëvendësuar për nivelin e ulët të ekspertizës dhe përvojës në shërbimin e ri. Intervistë e Grupit të Krizave, Prishtinë, 24 korrik 2006.

¹⁶ Po aty. Një gazetar dëshmitar i ka treguar Grupit të Krizave, se si këto njësi ia kanë dalë që më 28 qershor 2006, të

¹⁰ Shih Raportin e Grupit të Krizave, *Kolapsi në Kosovë*, op. cit. për të parë një përshkrim ndryshe të sjelljes së SHPK-së në trazirat e marsit 2004. Nuk kishte pajisje, as trajnim e as

nga 690 pjesëtarë sa ka tani në 1.700 pjesëtarë dhe që gradualisht të marrë numrin më të madh të përgjegjësive që tani ka KFOR-i. Është duke u përgatitur edhe Njësia e Armëve dhe Taktikave Speciale (Special Weapons and Tactics - SWAT).

Të gjitha stacionet policore dhe komandat rajonale, përveç asaj në Mitrovicë, janë në duart e SHPK-së. KFOR-i ia ka dorëzuar SHPK-së punën e përcjelljes së shumicës së konvojeve serbe si edhe mbrojtjen e disa lokacioneve religjioze serbe. SHPK-ja bën sigurimin e ndërtesave zyrtare si dhe të anëtarëve të lartë të institucioneve qeveritare (IPVQ). Në prill dhe maj 2006, kolonel të SHPK-së janë avancuar në rangun e ndihmës komisionarit dhe janë vënë në krye të divizioneve të ndryshme, ndërsa njëri është ngritur në rangun e zëvendës komisionarit të policisë. Përveç shefit të zhurmsëm të administratës së SHPK-së, të tjerët duken të kënaqur edhe pse janë të ulur në rendin e dytë ndërsa kolegët e tyre nga UNMIK-u kanë fjalën kryesore. Idetë e mëhershme që gjatë vitit 2006 komisionari i policisë së UNMIK-ut të delegojë shumicën e kompetencave të tij në duart e zëvendës të tij të ri dhe të bëhet vetëm mentor i tij janë lënë anash – u luajt një lojë më e sigurt: UNMIK-u do të mbajë frenat në çështjen e sigurisë deri sa të përcaktohet statusi.

2. Kapacitetet e qeverisë së Kosovës

Ndërrimet në qeveri në fillim të marsit 2006 sollën edhe emërimin e vonuar të kreve të ministrive të reja, asaj të brendshme dhe asaj të drejtësisë. Tani që janë emëruar, UNMIK-u është duke shqyrtuar transferimin e kompetencave tjera, përfshirë këtu edhe bërjen e ministrisë së brendshme bashkë-përgjegjëse me Komisionarin e policisë për mbikëqyrjen e SHPK-së. Disa pjesëtarë të policisë shprehin frikën, se ministria që kontrollohet nga LDK-ja do t'i japë ngjyrim politik shërbimit.¹⁷ Ministri, në anën tjetër, nuk beson se do të ketë pushtet të vërtetë derisa nuk largohet UNMIK-u.¹⁸ Përkundër krijimit të ministrive të reja dhe punës së "ISSR" (Rishikimi i Sektorit për Siguri të Brendshme), që mendohet të përpilojë propozimin e vet Kosovës për atë se çfarë konfiguracioni do të ketë shërbimi i Sigurisë, UNMIK-u mbetet motori i të gjitha iniciativave në sferën e sigurisë.

arrestojnë dhjetëra demonstrues pa ushtruar dhunë siç kishte genë rasti në herët e mëparshme.

¹⁷ Shih Raportin për Evropë të Grupit të Krizave numër 163, *Kosova pas Haradinajt*, 26 maj 2005; si dhe raportin tjetër të raportin tjetër, *Sfida e Tranzicionit*, op.cit. për informata shtesë për partitë politike të Kosovës dhe shqetësimet rreth aftësive të tyre, që të menaxhojnë në mënyrë të paanshme institucionet e sigurisë. LDK-ja është partia më e madhe politike në Kosovë.

¹⁸ Komente dhënë mediave, 9 qershor 2006.

Në fillim të qershorit 2006, u bë e ditur për krijimin e një trupi të ri, Këshillit për Siguri të Komuniteteve, që anashkaloi Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe asaj për Kthim dhe Komunitete. Edhe pse kryeministri Çeku ka mirëpritur themelimin e këtij organi si pararendës i Këshillit për Siguri Kombëtare, ky Këshill nuk mund të marrë këtë rol deri sa një numër më i madh i aktorëve nuk e kupton dhe e pranon rolin e saj potencial.¹⁹ Politikanët më të popullarizuar serbë në Kosovë do të kundërshtojnë përqëndrimin e prerogativave të sigurisë në duart e Prishtinës dhe do të bojkotojnë çdo organ të IPVQ-së. Serbët e Kosovës e shohin me sy të keq çdo politikan të tyre që i ofron bashkëpunim Prishtinës.²⁰

Pasi është bërë e qartë se UNMIK-u do të largohet së shpejti, duket se qeveria po pret që njëherë të ndodhë kjo e pastaj të fillojë të punojë. Shtimi i kapaciteteve të sigurisë është duke ecur ngadalë, si nëpër ministri ashtu edhe në zyrën e kryeministrit. Këtë të fundit e ka karakterizuar raporti jofunksional mes këshilltarëve për siguri dhe "Zyrës për siguri publike" që nga viti 2004.²¹ Zyra për koordinim të çështjeve të sigurisë që ndodhet në katin përdhës të ndërtesës së re qeveritare nuk është pajisur me staf dhe pajisje gjegjëse. Ministri i punëve të brendshme ka luksin që të zgjedhë se me cilat çështje do të merret e me cilat jo.²² Staf i kryeministrit thotë se planifikimi i mirëfilltë në çështjet e sigurisë do të fillojë

¹⁹ Në takimin e parë, më 16 qershor 2006, pa pjesëmarrjen e serbëve, diskutoi implikimet për sigurinë të deklaratave të komunave serbe në veri se do të bojkotojnë IPVQ-të dhe SHPK-në rajonale si dhe do të konsiderojnë organizimin për vetëmbrojtje.

²⁰ Një anketim i paradokohshëm tregoi se serbët e Kosovës më tepër u besojnë liderëve të tyre që nuk pranojnë të bashkëpunojnë me IPVQ-në, duke u dhënë notat më të larta figurave siç janë Peshkopi Artemije, Marko Jakshiq, Milan Ivanoviq dhe Rada Trajkoviq. Politikanët e serbëve të Kosovës që komunikojnë apo bashkëpunojnë me Prishtinën, siç janë Oliver Ivanoviq apo Sllavisha Petkoviq, kanë marrë nota të ulëta. Shih KUMT Consulting, *Pikëpamjet e Kosovës*, Numër 7, 16 qershor 2006.

²¹ UNMIK-u autorizoi krijimin e kësaj zyre nën kryeministrin Bajram Rexhepi në vitin 2004, që të zhvillojë kapacitetet për politika të sigurisë në institucionet e përkohshme. Zyra asnjëherë nuk ka funksionuar mirë. Kryeministri Çeku parasheh që kjo të bëhet Sekretariat i Këshillit për Siguri të Komuniteteve.

²² Në fillim të qershorit 2006, ai ishte i zëshëm në kërkimin e hapave për të shtuar prezencën e policisë në Kosovën veriore të dominuar nga serbët, por qëndroi krejtësisht i heshtur kur u desh të merrej me "rrethimin" e UNMIK-ut më 8 e 9 qershor nga lëvizja VETËVENDOSJE! Për dallim prej tij, Kryeministri Çeku u bëri thirrje protestuesve që të ndërprejnë protestën. Në fund, SHPK-ja ndërhyri për t'i dhënë fund demonstratës me ç'rast arrestoi 80 pjesëmarrës. Më vonë, ministri i kritikoi dënimet e shqiptuara në masën e dhjetë ditëve burgim.

vetëm pasi të dihet struktura e re kushtetuese. Mundësia që ky planifikim të bëhet tani në formë të draftit injorohet krejtësisht.²³

Edhe Kuvendi i Kosovës duket i papërgatitur për të mbikëqyrë organet e sigurisë: zgjedhjet me lista të mbyllura, hierarkitë rigjide të partive dhe puna aspak impresionuese, nuk premtojnë se mund të bëhet punë serioze, e pavarur, përmbajtësore dhe e përgjegjshme në komisionet që do të ishin përgjegjëse për shërbimet e sigurisë dhe të inteligjencës. Këshilli i Sigurisë Kombëtare mund të themelohet pas përcaktimit të statusit, por pa parapërgatitje adekuate kjo mund të shndërrohet në “pus pa fund”.

Në Kosovë vazhdojnë të funksionojnë edhe disa shërbime të pakontrolluara, të financuara privatisht e të lidhura me parti politike, por të lidhura edhe me shërbime të ndryshme zbulimi të vendeve perëndimore të cilat tash vonë kanë filluar të bashkëpunojnë më afër edhe me shërbimin e zbulimit të Serbisë.²⁴ UNMIK-u e pranon nevojën për një shërbim zyrtar të inteligjencës;²⁵ ISSR ende nuk e ka thënë fjalën e vet për këtë çështje. Mbretëria e Bashkuar, SHBA-ja e ndoshta edhe vende tjera, secila janë duke punuar në idetë e tyre për krijimin e saj. Ky shërbim nuk pritet të themelohet para përcaktimit të statusit dhe mendohet që t'i raportojë zyrës së kryeministrit²⁶ por Grupi i Kontaktit tani ka filluar të mendojë për atë se sa, nëse fare, duhet lejuar Kosova që të zhvillojë identitetin e vet të inteligjencës. Rajoni nuk ofron shembuj të mirë e të suksesshëm të organizimit të agjencive të brendshme të inteligjencës. Shumica e këtyre janë jashtë kontrollit demokratik ndërsa disa janë të lidhura edhe me krimin e organizuar. Kur kihen parasysh sfidat e krimit të organizuar trans-rajonal, kërkohet ekzistimi i një rrjeti të agjencive të inteligjencës që kanë kredibilitet dhe që bashkëpunojnë me njëra tjetrën, gjë që tani nuk ekziston.

Për dallim nga çështjet e policisë dhe të drejtësisë, nuk existojnë plane që Qeveria e Kosovës të bëhet përgjegjëse për TMK-në²⁷ dhe e ardhmja e kësaj organizate mbetet e paqartë. Formalisht ajo mbikëqyret nga Grupi për Zhvillim të TMK-së i përbërë nga UNMIK-u e KFOR-i,

që takohet përafërsisht një herë në tre muaj. Praktikisht, KFOR-i e mbanë nën mbikëqyrje konstante ndërsa që nga muaji gusht i vitit 2002, ndërveprimi i përditshëm i TMK-së me UNMIK-un bëhet nëpërmjet Zyrës së Koordinatorit për TMK-në që kryesohet nga gjeneralmajorë të njëpasnjëshëm britanikë që së bashku me pesëmbëdhjetë zyrtarë tjerë ndërkombëtarë, përfshirë këtu edhe katër të dërguar nga ushtria britanike, mbikëqyrin realizimin e mandatit të saj dhe kontrollojnë portofolin e saj. Kjo zyre është përgjegjëse për strategjitë dhe politikat e TMK-së që mundohet t'i mbajë të ndara nga përgjegjësitë për komandim dhe kontroll të kreut të TMK-së. Kjo kryen një pjesë të punëve të një ministrie të mbrojtjes dhe si e tillë mund të përbente thelbin e asaj Ministrie në të ardhmën.

Edhe pse qeveria e Kosovës si dhe ekipi negociues mbesin të pa-luhatur në atë se Kosova e pavarur do të ketë forcat e veta të armatosura, në anën tjetër këta nuk kanë kapacitetet për planifikime sigurie me të cilat do të duhej të fillohej. Në vend të kësaj, këta presin që vet TMK-ja të dalë me propozime për konfiguracionin e personelit dhe pajisjeve. Kur kihet parasysh se Kosova ka GDP prej përafërsisht 2,25 miliardë euro²⁸ dhe se vendet evropiane anëtare të NATO-s shpenzojnë për ushtrinë rreth 1,8 deri 1,9 për qind të GDP-së së tyre,²⁹ një ushtri e ardhshme e Kosovës realisht nuk mund të presë të ketë buxhet vjetor më të madh se shuma prej 43 milion euro e ndoshta do të duhet të pajtohet edhe me më pak se kaq. Parashikimet preliminare buxhetore të TMK-së thonë se shpenzimet vjetore për stafin e një ushtrie do të ishin rreth 10 milion euro ndërsa një buxhet bazë prej 20 apo 25 milionë euro do të mjaftonte për tri deri pesë vitet e para.³⁰ Kjo përputhet me strukturën “ideale” të buxhetit ushtarak në të cilin 50 për qind (apo më pak) janë shpenzime për personelin, 30 për qind për shpenzime operationale dhe 20 për qind për investime. Nëse mbahet madhësia e tashme e TMK-së me 3.000 trupa, kjo do të kërkonte një buxhet prej 7.000 euro në vit për një ushtar. Ushtria amerikane shpenzon përafërsisht dhjetë herë më shumë për një ushtar, ushtria e Serbisë shpenzon përafërsisht 10.000 euro e me reduktimet e planifikuara shumë shpejtë mund të shkojë në rreth 15.000 euro.

Buxhet i Kosovës për vitin 2006 është 690 milion euro, që është për 10 milion euro më pak se në vitin 2005,

²³ Intervistë e Grupit të Krizave, Zyra e kryeministrit, 12 qershor 2006.

²⁴ Intervista të Grupit të Krizave, Beograd dhe Prishtinë, 2006.

²⁵ Intervistë e Grupit të Krizave me PSSP-në Soren Jessen-Petersen, Prishtinë, 1 shkurt 2006.

²⁶ Shih: “Kosova së shpejti bëhet me Shërbim të Zbulimit?”, *Zëri*, 12 qershor 2006. Kryeministri Çeku ka hezitur që të emërojë një këshilltar për inteligjencën nga Sllovenia, që është dashur të fillojë punën në korrik 2006.

²⁷ Edhe pse ka plane që në të ardhmen të lidhet me Departamentin për Menaxhim të Emergjencave dhe reagim në emergjencat civile të ministrisë së brendshme.

²⁸ Parashikimet e FMN-së për vitin 2006. Shih (në gjuhën angleze): “Aide Memoire of the IMF Staff Mission to Kosovo” 22-31 maj 2006. Tutje: “Aide Memoire”

²⁹ Shtatë anëtarët më të ri të NATO-s janë zotuar të shpenzojnë së paku 2 për qind të GDP-së për mbrojtje. Shih: (në gjuhën angleze) Andrew Cottey, Timothy Edmunds, and Anthony Forster, “Beyond Prague”, *Nato Review*, vjeshtë 2002.

³⁰ Intervistë e Grupit të Krizave, qershor 2006.

ndërsa në vitin 2007 mendohet të jetë edhe më i vogël.³¹ Kosova po kërkon mjete nga donatorët që të mbulojë deficitin prej rreth 70 milion euro. Nëse nga këto mjete një pjesë shkon për çështjet e mbrojtjes, atëherë infrastruktura e financuar edhe ashtu dobët, sistemi shëndetësor dhe ai arsimor i Kosovës do të kenë edhe më pak resurse ndërsa donatorët do të jenë edhe më pak të gatshëm që të ndihmojë. Për më tepër, FMN-ja tërheq vërejtjen se disiplina buxhetore e qeverisë është dobësuar në muajt e fundit.³² Ekspertët financiarë ndërkombëtarë nënvizojnë se vetëm pagesat në kuadër të ligjit për veteranët e luftës, që do të fillojnë të paguhen nga janari i vitit 2007, do të kushtojnë më shumë se 20 milionë euro në vit³³ – pra kemi një ambient buxhetor në të cilin nuk është e lehtë të sigurohet shuma prej 15 milion euro sa shpenzohen tani për TMK-në. Do të ishte më reale të mendohet për reduktimin e numrit në 2.000 pjesëtarë ashtu që të plotësohen nevojat themelore të ushtrisë së ardhshme me aq sa është buxheti aktual i TMK-së.

Por, qeveria më së shumti çalon në fleksibilitetin politik dhe në kreativitet. Programi i OKB-së Standardet për Kosovën është një shabllon i lehtë për t'u ndjekur. Demonstrimi i angazhimit për “implementimin e standardeve” ngjan me plotësimin e fjalëkryqit. Kjo nuk kërkon nga politikanët që të kërkojnë zgjidhje kreative për problemet e Kosovës. Mendimi politik i shqiptarëve të Kosovës nuk është pjekur aq sa të pranojë veriu serb hapat e të cilit për të shkëputur të gjitha lidhjet me Prishtinën dhe për të konsoliduar një aparat të sigurisë që përjashton shqiptarët has vetëm në reagim me fjalë. Shqiptarët ende presin që bashkësia ndërkombëtare t’ua kthejë veriu e Kosovës. Me përjashtim të politikanit Veton Surroi, liderët tjerë politikë nuk po tregojnë angazhim për të kuptuar dhe për të adresuar frikën e serbëve.³⁴ Për më tepër, disa po e shfrytëzojnë veriu vetëm si mjet për marketing për vetveten e jo si sfidë për Kosovën multi-etnike.³⁵

³¹ Përfaqësuesi i FMN-së, Marc Auboin, në një konferencë me gazetarë, më 13 qershor 2006, tërhoqi vërejtjen se ekonomia do të shënojë ulje në vitin 2007 dhe buxheti duhet të zvogëlohet

³² “Aide Memoire”, op. cit.

³³ Korrespondencë e Grupit të Krizave, qershor 2006. Parashikimet e Ministrisë së Mirëqenies Sociale se shpenzimet vjetore do të jenë mes 10 deri 15 milion euro nuk janë vlerësuar si kredibile.

³⁴ Surroi ka udhëhequr një komisioni për konsultime me pakicat etnike në kontekst të përgatitjeve të Prishtinës për negociatat për statusin dhe ka bërë dy vizita në veri të Mitrovicës, në maj dhe në qershor 2006.

³⁵ Rast i dalluar është ai i kryesuesit të Komisionit për emergjenca të Kuvendit të Kosovës, Naim Maloku, i cili në muajin qershor 2006 e prezantoi një vizitë të parlamentareve rajonale të organizuar nga OSBE-ja si iniciativë të tijën. Publiciteti që ai krijoi bëri që vizita të anulohet.

Derisa transformimi i TMK-së në ushtri të ardhshme të Kosovës është *sine qua non* për ta, për Serbët ky është një mallkim i vërtetë. Me letargjinë e politike, liderët e shqiptarëve u lënë hapësirë grupeve tjera joformale. Vet mungesa e ideve është një kërcënim për sigurinë. Agjenda e shqiptarëve për ditët pas pavarësisë është pothuajse e zbrazët.³⁶ Kjo zvogëlon gjasat që Kosova të udhëhiqet nga institucionet e veta, shton rrezikun nga kolapsi dhe i bën serbët të frikësohen se shqiptarët kanë në mend gjëra për të cilat nuk po flasin.

B. AGJENTËT E JOSTABILITETIT TË BRENSHËM

1. Aktorët joformalë shqiptarë

Edhe pse disa pjesëtarë të ish-UÇK-së kanë vazhduar jetën e tyre në sfera tjera, rreth 4.000 mbesin personel aktiv i SHPK-së dhe TMK-së, ndërsa shumica e 25.000 që janë regjistruar në IOM më 1999 janë të papunësuar, veçanërisht ata në Drenicë dhe në Deçan (Dukagjin). Shoqata të zëshme por të margjinalizuara përfaqësojnë veteranët e luftës, invalidët e luftës si dhe familjet e dëshmorëve. Sidomos në Dukagjin, njësitë e ish-UÇK-së mbeten kohesive dhe janë mjaft tërheqëse për gjeneratën e re militante. Ata kanë armë dhe mund të mobilizohen shumë shpejtë.³⁷ Shumë djem nga Dukagjini kanë marrë pjesë në luftimet në Maqedoni, më 2001, duke u treguar më të zotë se sa me UÇK-në në vitet 1998 e 1999. KFOR frikësohej se gjatë trazirave të marsit 2004, luftëtarë nga Drenica dhe Dukagjini mund të mobilizoheshin dhe të sulmonin veriu e Mitrovicës. Luftëtarët e Dukagjinit gati sa nuk u mobilizuan kur në vitin 2005, Tribunali i Hagës ngriti padi kundër kryeministrit Haradinaj.³⁸ Një analist serb sheh në këtë, traditën ish-jugosllave të mbrojtjes me një ushtri qendrore (APJ) dhe forcat e mbrojtjes territoriale të bazuara në rezervistë – me TMK-së që vepron si APJ-ja dhe celulat e parregullta të ish-grupeve të UÇK-së si version kosovar i mbrojtjes territoriale.³⁹

Pjesë e pikturës janë edhe strukturat e krimit të organizuar. Shefi i K-SHIK-ut (shërbimi inteligjent i ish-UÇK-së i afërt me Partinë Demokratike të Kosovës,

³⁶ I pyetur për prioritetet e pas-pavarësisë zëvendës-kryeministri, Lutfi Haziri, u shpreh se implementimi i decentralizimit dhe i provizioneve tjera të marrëveshjes për statusin final do të dominojë agjendën e qeverisë për tri apo katër vitet e ardhshme. Intervistë e Grupit të Krizave, Prishtinë, 11 korrik 2006.

³⁷ Shih raportin e Grupit të Krizave, *Kosova pas Haradinajt*, op. cit.

³⁸ Ibid.

³⁹ Intervistë e Grupit të Krizave me Aleksandar Radiq, Beograd, 13 maj 2006.

PDK)⁴⁰ shprehet i habitur me atë se sa lehtë “disa nga komandantët tonë” janë rekrutuar nga krimi i organizuar pas luftës.⁴¹ Në vitet e fundit, disa grupe kriminale janë lidhur me LDK-në, partinë më të suksesshme politikisht. Disa e lidhin krijimin e grupeve kriminale, në një qytet në jug të Kosovës me ngritjen e një politikani të LDK-së, që nga viti 2004. Kriminelë që nuk kanë lidhje me UÇK-në kanë krijuar disa “ushtria çlirimtare” që janë paraqitur në fund të vitit 2005 në Drenicë, në Dukagjin, në Ferizaj dhe Kaçanik, dhe që aktivitet kryesor e kishin plaçkitjen në rrugët kryesore. Mes Drenicës e Prishtinës disa kriminelë kanë vënë lidhje me biznesmenë për të ndihmuar njëri tjetrin. Lirimet e shpeshta për t’u mbrojtur në liri apo ikjet nga duart e policisë të kriminelit Faton Hajrizi tregojnë se njerëz të gjyqeve dhe policisë i ndihmojnë atij.⁴² Në Dukagjin, anëtarët e njësisë “Shqiponjat e zeza” të UÇK-së duket se kanë ndërtuar një rrjet kontrabandimi. Kjo njësi ishte pikënisja kryesore e aksioneve të mundshme të dhunshme në ditët e ngritjes së aktakuzës kundër Haradinajt. Në trazirat e marsit 2004, grupet kriminale luajtën rol të madh.

Pjesa më e madhe e parave të fituara në Zvicër apo diku tjetër në Evropë janë futur në sferën e ndërtimitarisë në Kosovë dhe shumica e qytetarëve nuk e shohin krimin e organizuar si problem të madh për sigurinë.⁴³ Ende ka njëfarë simpatie për banditizëm.⁴⁴ Megjithatë, edhe pse komentatorë të huaj e lidhin krimin e organizuar shqiptar me strukturën fisnore, strukturat e forta tradicionale në familje, në pjesën më të madhe vepron si forcë frenuese ndaj rekrutimit; Tëhuajtja (lëçitja) është më e mundshme dhe më e rëndë e me konsekuenca më të mëdha se sa në shoqëritë më të atomizuara.⁴⁵ Megjithatë, papunësia e

madhe dhe në rritje e gjeneratave të reja, krijon kushte për kriminalizim të mëtutjeshëm të shoqërisë.

Lëvizja VETËVENDOSJE! e Albin Kurtit ka provuar të përftojë nga ky numër i madh i të rinjve të frustruar shqiptarë që u dalluan në trazirat e marsit 2004.⁴⁶ Ai i ka mobilizuar këta ekskluzivist kundër UNMIK-ut dhe vizitave të zyrtarëve serbë. Ai u përpoq që të shndërrojë protestën e 8 qershorit 2006, në të cilën morën pjesë disa qindra demonstrues, në bllokadë njëzetekatër orëshe të selisë qendrore të administratës së UNMIK-ut, duke nxitur kështu intervenimin e policisë. Ai dhe përkrahësit e tij bllokuan rrugët hyrëse në Kosovë për të penguar vizitën e kryeministrit Koshtunica më 28 qershor 2006. Në të dyja rastet, Kurti dhe shumë përkrahës të tij janë arrestuar.⁴⁷ Çak tjetër i lëvizjes janë çfarëdo koncesionesh që i bëhen Serbisë, përfshirë decentralizimin dhe masat për mbrojtjen e kishave që mund të krijojnë më tepër hapësirë dhe më shumë siguri për komunitetin Serb. Në thumb janë, sidomos zona speciale e vendosur rreth manastirit të Deçanit si dhe propozimet për decentralizim në Kosovën lindore. VETËVENDOSJE! nuk ka agjitur në zonën më të rrezikshme, atë të Mitrovicës.

Fushata a paradokohshme e Kurtit për të bojkotuar prodhimet serbe ka nxitur ankesa nga ana e kryetarit të Serbisë Tadiq, por edhe përkrahje nga afaristë shqiptarë në Kosovë që kishin interes në zvogëlimin e konkurrencës. Duke e shpallur UNMIK-un armik, lëvizja me kujdes e ka anashkaluar qeverinë e Kosovës ndonëse organizata është larguar nga parimet e jodhunës në zgjidhjen e konfliktit. Kurti është afuar gjithnjë e më shumë me veteranët e UÇK-së dhe me partitë radikale LKP dhe LKÇK, ka adoptuar taktika më konfrontuese dhe ka filluar të flasë për nevojën për të kapur armët. Por, VETËVENDOSJE! nuk është bërë lëvizje masive popullore.⁴⁸

Megjithatë, ekziston potenciali që aktivizmi i masave të shndërrohet në “revoltë kundër institucioneve”.⁴⁹ Kjo do

⁴⁰ Shumë e lidhin këtë organizatë hije me krimin e organizuar. Për më tepër informata shih raportet e Grupit të Krizave *Kosova pas Haradinajt* dhe *Kosova: Sfidat e Tranzicionit*.

⁴¹ Intervistë e Grupit të Krizave me Kadri Veselin, Prishtinë, 17 nëntor 2005. PDK-ja është partia e dytë për nga madhësia në Kosovë. Ka dalë nga UÇK-së dhe nga qeveria e përkohshme e instaluar pas luftës.

⁴² Intervistë e Grupit të Krizave me një epror të SHPK-së, 17 maj 2006; “Prapë arratiset Fatoni”, *Express*, 12 qershor 2006.

⁴³ Anketimet e opinionit publik për ISSR; intervistë e Grupit të Krizave me një zyrtar të Sekretariatit të ISSR-së, Prishtinë, 8 maj 2006.

⁴⁴ Shih (në gjuhën angleze) Eric Hobsbawm, *Bandits* (1969, ribotim 2000), që tregon historinë e “plaçkitësve dhe banditëve të cilët opinioni publik nuk i sheh si kriminelë të thjeshtë por më parë si kampionë të barazisë sociale, hakmarrës apo si luftëtarë primitivë për lirinë”. Intervista e gazetës *Express* me banditin e ikur nga burgu, Faton Hajrizi, e bërë diku në Drenicë, tregon se kjo simpati shkon përtej popullatës rurale deri te gazetarët urbanë.

⁴⁵ Një epror i SHPK-së thekson se presioni nga familja ka ulur krimin në rajonin e tij, intervistë e Grupit të Krizave, Skenderaj, 17 maj 2006.

⁴⁶ Shih raportin e Grupit të Krizave *Kolapsi në Kosovë*, për përshkrim të trazirave, ndërsa në faqen 32 diskutimin për demografinë kosovare të dominuar nga të rinjtë dhe ndikimin që ka ky faktor në stabilitetin politik.

⁴⁷ Nga njësitë speciale të SHPK-së pjesëtarët e së cilës më parë ishin pjesëtarë të UÇK-së.

⁴⁸ Sipas anketës së bërë në qershor 2006, për “Raportin e paralajmërimit të hershëm” për UNDP-në, 16 për qind e shqiptarëve të Kosovës kanë shprehur gatishmërinë që t’i bashkohen VETËVENDOSJES!. 40 për qind të tjerë shprehën mbështetje të kufizuar. Një demonstratë e thirrur nga VETËVENDOSJE! dhe aleatët e saj që të protestohet kundër bisedimeve për statusin që po mbaheshin në Vjenë, më 24 korrik, tërhoqi vetëm 200 deri 300 pjesëmarrës.

⁴⁹ Sidomos nëse qeveria vazhdon të shpenzojë pa kontroll paratë e taksapaguesve me abuzimet gjatë prokurimit, blerjen

të mund të drejtohej edhe kundër institucioneve ndërkombëtare dhe të prekë kompromiset delikate të dakorduara me serbët e Kosovës. As ekonomia e Kosovës e as institucionet e saj politike e qeveritare nuk janë duke absorbuar energjinë e numrit të madh të rinjve.⁵⁰ Papunësia vazhdon të rritet ndërsa regjimi i ashpër i vizave i mban larg Bashkimit Evropian.⁵¹ Sistemi arsimor në vend se të përmisimit po shkon duke u përkeqësuar gjithnjë e më tepër. Rezultatet e testeve shkollore në vitin 2006 kanë qenë më të dobëta deri tani.⁵² Një numër i vogël, por që është në rritje të vazhdueshme, po i kthehet islamit vahabit. Raporti i parë i Rishikimi i Sektorit për Siguri të Brendshme (ISSR) me të drejtë konkludon se:

Diskrepanca mes trendeve demografike dhe zhvillimit ekonomik..... përbën kërcënim strukturor afatgjatë për Kosovën... Një popullatë e madhe e me edukim të dobët të rinjve do të jetë stimul i madh për trazira kriminale e sociale.⁵³

Atëherë kur këto tri grupe bëhen bashkë – veteranët e luftës, krimi i organizuar dhe të rinjtë – jashtë çfarëdo kornize institucionale, siç ndodhi në mars 2004, shfaqet rreziku më i madh për Kosovën në përgjithësi e për serbët e Kosovës në veçanti. Është thelbësore që të parët, veteranët dhe të tretët, të rinjtë të bëhen pjesë e institucioneve në të cilat mund të kontribuojnë dhe të besojnë.

2. Strukturat serbe në veri

Veriu serb i Kosovës është duke u bërë gati që t'i kundërvihet Prishtinës në çështjen e statusit final. Më së

e veturave të shtrenjta dhe faturat tmerrësisht të larta të telefonave mobilë. Hulumtimet e ISSR kanë zbuluar një shkallë të lartë të zhgënjimit të opinionit publik me IPVQ-në. “Raporti i Paralajmërimit të Hershëm” i UNDP-së i bërë në qershor 2006 konfirmon se popullariteti i qeverisë është në rënie, me 47 për qind prej tyre që theksojnë “shpenzimet pakufi në luks” si problem kryesor në menaxhimin me buxhet. Shih edhe Berat Buzhala, “Ëndrrat gjakënxehta mund të bëhen realitet”, BIRN Balkan Insight, 14 qershor 2006, në http://www.birn.eu.com/insight_39_8_alb.php.

⁵⁰ Shih raportin e Grupit të Krizave, *Kolapsi në Kosovë*, op.cit. fq. 32-36, për një përshkrim të mangësive dhe për rolin periodik të rinisë në zhvillimet sociale në shoqërinë e shqiptarëve të Kosovës.

⁵¹ Shih raportin e Grupit të Krizave numër 168 (në gjuhën angleze) *EU Visas and the Western Balkans*, 29 nëntor 2005, sidomos fq. 15.

⁵² Shih, për shembull: Bekë Abazi, “Testimi i arritshmërisë tregon rënie të dijës te nxënësit Mitrovicas”, *Zëri*, 30 qershor 2006; TV debatin në emisionin “Jeta në Kosovë” të RTK/BIRN, 12 korrik 2006.

⁵³ KIPRED, Rishikimi i Sektorit për Siguri të Brendshme (ISSR): Shqyrtimi strategjik i mjedisit dhe vlerësimi i rrezeve të sigurisë, mars 2006, në: www.kipred.net

paku që mund të bëj është që të thellojë bojkotimin e institucioneve qeveritare dhe ta bëjë të vështirë e madje edhe të rrezikshme për përfaqësuesit e saj dhe për shqiptarët që nuk janë banorë lokalë që të kalojnë në bregun verior të Ibrit. Nëse forca paramilitare hyjnë nga Serbia në pjesën veriore të Kosovës, tensionet do të rriten edhe më. Në rastin më të keq, serbët në veri, që edhe me mendje janë ndarë nga 60 për qind e serbëve që jetojnë në Kosovë në enklavat në jug të lumit Ibër, mund të kërkojnë bashkim formal me Serbinë. Sa ma drastike të jetë zgjidhja për veriun, aq më të cenueshëm nga reagimi i shqiptarëve do të jenë serbët e mbetur në pjesët tjera të Kosovës.

Që nga heqja e Rojeve të Urës nga listat e pagave, në vitin 2003, Beogradi dhe forca kryesore politike në këtë pjesë, Këshilli Nacional Serb (KNS) kanë punuar që të mbajnë një forcë të sigurisë por më pak të dukshme. Përveç në një pjesë të Zubinpotokut, ata e kanë bërë SHPK-në në tri komunat veriore si dhe në pjesën veriore të Mitrovicës aparat të tyre.⁵⁴ Gatishmëria e UNMIK-ut që të pranojë më shumë ish-oficerë të MUP-it në SHPK dhe trajnimi i tyre në pjesën veriore të Mitrovicës në vend se në Shkollën Policore në Vushtri, do ta fusë SHPK-në në veri edhe më tepër në duart e tyre.⁵⁵ Në kërcënimet e dhunshme në qershor të vitit 2006 UNMIK-u është përgjigjur duke dërguar më tepër policë ndërkombëtarë dhe duke refuzuar që të largojë shqiptarët nga njëra rajonale e SHPK-së mbi lumin Ibër.⁵⁶ Pas një përlëshjeje mes kufitarëve shqiptarë të SHPK-së dhe zëvendëskryetarit të komunës së Leposaviqit, serb, kah mesi i korrikut 2006, policë të tjerë ndërkombëtarë janë dërguar edhe në dy “hyrjet-daljet” në kufirin verior.⁵⁷

Serbia mbanë stacione policore paralele në këto pjesë, në të cilat punojnë oficerë të MUP-it në rroba civile,⁵⁸ numri

⁵⁴ Shih raportin për Evropë të Grupit të Krizave numër 165, *Zgjidhje për Mitrovicën, Jo Ndarje të Kosovës, 13 shtator 2005*, fq. 6, 26-28.

⁵⁵ Zëvendës PSSP-ja, Steven Schkook, kumtoi këtë iniciativë në qershor 2006, si masë për të fituar besimin e serbëve në veri.

⁵⁶ Në takim me Komisionarin e Policisë, Kai Vittrup, në qershor 2006, liderët serbë të veriut të Kosovës thanë se nuk do të mbajnë përgjegjësi për pasojat nëse njësitë rajonale, shqiptare, të SHPK-së nuk tërhiqen nga pjesa mbi lumin Ibër. Më 14 qershor, një polic i trafikut, shqiptar, në fshatin Graboc, në rrugën Mitrovicë-Leposaviq, është kërcënuar se do ta vrasin nëse shkon atje edhe një herë. Më 15 qershor, një veturë e Shërbimit doganor është sulmuar me një granatë në afërsi të liqenit të Gazivodës në komunën e Zubinpotokut.

⁵⁷ Dy “hyrjet-daljet” kufitare, në Leposaviq dhe Zubinpotok. Shih raportin e Grupit të Krizave, *Zgjidhje për Mitrovicën, Jo Ndarje të Kosovës*, op.cit. fq.13 për më tepër informata për këto vendkalime kufitare.

⁵⁸ Shih raportin e Grupit të Krizave, *Zgjidhje për Mitrovicën, Jo Ndarje të Kosovës*, op.cit. fq. 6, 26.

i të cilëve duket se është shtuar në këto javët e fundit.⁵⁹ Edhe pse Rezoluta 1244 kërkon tërheqjen e të gjitha forcave serbe të sigurisë nga Kosova, UNMIK-u dhe KFOR-i kanë mbyllur sytë para kësaj dukurie. Serbët insistojnë se Rezoluta 1244 u garanton të drejtën implicite që të kthejnë deri në 1.000 trupa të forcave të sigurisë. Rezoluta flet për “një numër të vogël të dakorduar”, “qindra e jo mijëra” policë serbë e jugosllavë... që do të lejohen të kthehen në Kosovë” që të përmbushin disa detyra specifike “nën mbikëqyrjen e prezencës ndërkombëtare të sigurisë”, edhe pse deri tani nuk ka pasur ndonjë marrëveshje për këtë.⁶⁰

Kjo e “drejtë” theksohet edhe në deklarinimin e “gjendjes së jashtëzakonshme në veri të Kosovës” nga ana e tri komunave veriore, më 5, 12 dhe 13 qershor 2006, që rezultoi me ndërprerjen e bashkëpunimit me SHPK-në në nivel rajonal, me krijimin e komiteteve emergjente dhe me kërkesat që “më shumë se 100” policë nga Serbia të lejohen të kthehen përndryshe këta do të rekrutojnë vet “999 policë serbë”.⁶¹ Kështu, dalëngadalë, ata kanë filluar të krijojnë një forcë paramilitare. Rreth 360 ish-rezervistë të ushtrisë jugosllave, me përvojë ushtarake në luftërat e viteve nëntëdhjetë, thuhet se janë mbledhur dhe marrin paga nga buxhetet e komunave të paguara nga Beogradi, e të cilët punojnë kinse si punëtorë administrativë nëpër fshatra.⁶² Kur kihet parasysh madhësia e territorit, ky numër nuk është edhe aq i madh. Shumica prej tyre duket se janë të sistematizuar në vendet ku edhe jetojnë, duke vepruar si roje të fshatit apo duke patrulluar të paarmatosur dhe duke mos formuar një forcë të gatshme për sulm.⁶³

⁵⁹ Intervistë e Grupit të Krizave me një burim nga Policia e UNMIK-ut, 24 korrik 2006.

⁶⁰ Një pano që thërret për këtë të drejtë të supozuar qëndron në qendër të pjesës veriore të Mitrovicës për gati një vit. Rezoluta thotë se “një numër i dakorduar i personelit të ushtrisë dhe policisë jugosllave e serbe do të lejohet të kthehet në Kosovë” për ndërlidhje, shënim dhe pastrim të fushave të minuara dhe për të pasur një prezencë në lokacionet religjioze dhe në vendkalimet kufitare kryesore. Oficerët civilë të MUP-it në veri nuk kryejnë kurrfarë detyrash. Ministria e brendshme e Serbisë ka informuar zëvendës-PSSP-në përgjegjës për Policinë dhe Drjetësinë, se ministria kishte 1.000 oficerë dhe nëpunës që veprojnë në Kosovë. Intervistë e Grupit të Krizave me ZPSSP Jean Dussourd, Prishtinë, 31 gusht 2005. Të informosh nuk është njësoj si të dakordohesh por Serbia ka arsye të konsiderojë heshtjen e UNMIK-ut si darkordim.

⁶¹ Këtë së pari e shpalli Zveçani, pastaj Zubinpotoku dhe Leposaviqi. Shih faqen në internet të Qendrës Koordinuese në: www.kc.gov.yu, për më tepër informata.

⁶² “Kosovo Serbs recruit ex-soldiers for defence” (Serbët e Kosovës rekrutojnë ish-luftëtarët për t’u mbrojtur), agjencia Reuters, 20 qershor 2006; Intervista të Grupit të Krizave, Mitrovicë, Washington, qershor 2006.

⁶³ Intervista të Grupit të Krizave, qershor e korrik 2006.

Serbët e veriut, sidomos ata në Mitrovicë, kanë qenë të kujdesshëm deri tani. Aftësitë e tyre ushtarake dhe mundësia që të mobilizohen shpejtë për një mbrojtje të armatosur, ka bërë që shqiptarët të mos ndërmarrin aksione kundër tyre por kanë qenë aq të kujdesshëm që strukturat e tyre t’i mbajnë larg syve dhe të mos provokojnë pa nevojë. Kjo ka evituar eskalimin e tensioneve deri në atë shkallë sa të nxitet një mobilizim i përgjithshëm i shqiptarëve kundër tyre. Beogradi është gjithashtu i kujdesshëm, siç është parë edhe gjatë trazirave të marsit 2004, kur serbët e Mitrovicës nuk e pranuan ndihmën e grupeve paramilitare nga Serbia ndërsa forcat e sigurisë në Serbi i ndaluan këto grupe dhe nuk i lejuan që të hyjnë në Kosovë.⁶⁴ Ka pasur shumë fjalë për këtë forcë të re paramilitare por ajo është parë shumë pak, gjë që i ka mundësuar UNMIK-ut që qetë të përsërisë se: “ne nuk kemi parë fakte për këtë”.⁶⁵

Mbetet të shpresojmë se një vetëpërbajtje e tillë do të bëjë të sigurohet një paqe joformale gjatë zgjidhjes së statusit. Struktura paramilitare serbe ndjek logjikën e eskalimit gjë që ka gjetur vend në kalkulimet e lidhshmit të KNS-së. Të vetëdijshëm se nuk kanë mjaft forca që t’i bëjnë ballë një sulmi të vendosur nga qendrat e UÇK-së, KNS-ja ka mbajtur takime të ndryshme në Krlevë, Jabllanicë dhe në disa qytete tjera të Serbisë për të shtuar përkrahjen për të. Me këtë, KNS-ja ndoshta ka bërë një përlllogari të gabuar duke menduar se shqiptarët po përmbahen vetëm për shkak të frikës nga forca e serbëve e jo edhe për shkak të ndjenjës së përgjegjësisë dhe për shkak të shqetësimeve për atë se si do të reagojë bashkësia ndërkombëtare.⁶⁶

C. FORCAT NDËRKOMBËTARE TË SIGURISË

KFOR-i (Misioni Paqëruajtës i NATO-së) do të mbetet në Kosovë edhe pas zgjidhjes së statusit. Për sa kohë, kjo nuk mund të thuhet, por kjo sigurisht që do të ketë rol në kalkulimet e shqiptarëve dhe serbëve. Vendimi për të qëndruar me dekada ka gjasa që të evitohet më shumë probleme se sa prospektet që brenda tri apo katër viteve të zëvendësohet nga një forcë e BE-së me mandat më të reduktuar. Pasi misioni i policisë së UNMIK-ut do të përmbillet në vitin 2007, mendohet që të mbahen disa oficerë dhe disa kompetenca ekzekutive ndërsa BE-ja të bëhet sponsor i tyre i ri. Zyrtarët e BE-së kanë ide tjera dhe dëshirojnë të krijojnë diçka të re. Në çështjen e policisë, si dhe sferat më të gjëra të sigurisë, tranzicioni

⁶⁴ Intervistë e Grupit të Krizave me një burim në Sigurimin Shtetëror Serb, Beograd, 11 maj 2006.

⁶⁵ Zëdhënësi i UNMIK-ut, Neeraj Singh, në konferencën e përjavshme me gazetarë, 14 qershor 2006.

⁶⁶ Intervistë e Grupit të Krizave me liderin e KNS-së, Marko Jakshiq, pjesa veriore e Mitrovicës, 14 qershor 2006.

nga UNMIK-u në BE mund të mos shkojë edhe aq lehtë. Ky i pari dëshiron të mbajë disa të drejta dhe një numër të personelit ndërsa kjo e dyta dëshiron që të bëjë plane pa kurrfarë presionesh.

Trazirat e marsit 2004 kanë zbuluar sa i brishtë është pushteti ndërkombëtar. Në tetëmbëdhjetë muajt e fundit, lidhshipi i UNMIK-ut është treguar i interesuar për të pasur kryeministra nga UÇK-ja apo TMK-ja e të cilët mund të ofrojnë garanci për sigurinë. Edhe pse në fillim kishin qenë skeptikë, UNMIK-u dhe KFOR-i e çmuan lartë kontributin e Haradinajt për mbajtjen e paqes pas ngritjes së padisë për krime lufte kundër tij; ai ka vazhduar të luajë një rol të madh prapa skene edhe pas lirimit që të mbrohet në liri.⁶⁷ Në të vërtetë, prokurorja e Hagës, Carla del Ponte, e ka akuzuar PSSP-në Jessen-Petersen, në Maj 2006, se afruar së tepërmi me të dhe për krijimin e një atmosfere që pengon hetimin e krimeve të bëra nga UÇK-ja.⁶⁸ Zyrtarët e Beogradit thonë se interlokutorët ndërkombëtarë e paraqesin kryeministrin Çeku si një njeri që mund të garantojë sigurinë.⁶⁹

1. KFOR-i

Reduktimi gradual i trupave të KFOR-it nga 45.000 sa ishin më 1999 është ndalur pas trazirave të marsit 2004. Prej atëherë ka qenë imperativ politik që të mbahet një numër përafërsisht i njëjtë i trupave. KFOR-i është rikonfiguruar që të përballet më mirë me trazira të reja. Trupat janë pajisur dhe trajnuar për t'u përballur me trazira dhe është bërë një sistematizim dhe përdorim më fleksibil i tyre. Pesë Brigadat Shumë-Kombëshe janë

⁶⁷ Pasi takoi Haradinajn më 11 korrik 2006, ushtruesi i detyrës së PSSP-së, Steven Schook, raportohet të ketë thënë: "Mendoj se kryetari i AAK-së do të vazhdojë t'i kontribuojë stabilitetit politik në Kosovë e veçanërisht gjendjes së sigurisë".

⁶⁸ Raporti i saj para Këshillit të Sigurimit ishte i sinqertë në kritikën që bëri: "E para, ekziston një bindje e përhapur ndër opinion publik se Ramush Haradinaj gëzon mbështetjen e UNMIK-ut, përfshirë përkrahjen personale të kryesuesit të saj, PSSP-së Jessen-Petersen. Kjo bindje, që mund të argumentohet me shumë fakte, ka ndikim frikësues tek dëshmitarët e TPNJ-së dhe i dekurajon dëshmitarët potencialë që të bisedojnë me hetuesit Zyrës së Prokurorëve të Tribunalit. E dyta, menaxhimi me dëshmitarët nga ana e UNMIK-ut ka qenë shpeshherë neglizhent dhe besimi në këtë sistem ka humbur. E treta, UNMIK-u me qëllim po i pengon prokurorët e Tribunalit që të kenë qasje në dokumentet relevante apo në informatat thelbësore që janë në dokumente. Prandaj, niveli i bashkëpunimit të ofruar nga UNMIK-u është krejtësisht i pakënaqshëm" (në gjuhën angleze) (S/2006/353, 31 maj 2006, Aneksi II, paragrafi 34 në www.un.org). UNMIK-u mohoi këto pohime: "UNMIK-u mohon vlerësimin e Prokurorës së TPNJ-së si të pabazë". Informatë për shtyp e UNMIK-ut numër 1563, 8 qershor 2006, në: www.unmikonline.org.

⁶⁹ Intervista të Grupit të Krizave, Beograd 11-12 maj 2006.

ristrukturuar në gjashtë Task-Forcë (Dërgata) Shumëkombëshe më pak të lidhura me territoret (sektorët) dhe bazat e tyre dhe me më shumë pushtet mbi ta nga shtabi qendror i KFOR-it. Por, kjo forcë mbetet në të njëjtën kohë edhe tepër e madhe edhe tepër e vogël. Punët e saj të përditshme mund të bëhen edhe nga një numër më i vogël i ushtarëve ndërsa në anën tjetër numri i tashëm i trupave nuk mjafton për t'u përballur me trazira të mëdha nëse këto shpërthejnë në disa lokacione përnjëherë.

KFOR-i ka bërë SHPK-në partner të vet. Privatisht, zyrtarë të KFOR-it thonë se edhe TMK-ja do të mund të kontribuonte në çështjet e sigurisë por rrethanat politike para përcaktimit të statusit të Kosovës e bëjnë këtë të pamundur. Ish-COMKFOR-i Kermabon pajtohej se "natyrisht" që TMK-ja do të mund të mbronte më mirë manastiret serbe se sa KFOR-i,⁷⁰ duke pranuar në njëfarë mënyre se qasja e tashme e KFOR-it nuk është edhe zgjidhja më e mirë.⁷¹ Disa e shohin partneritetin me TMK-në si dorëzim simbolik të monopolit të ndërkombëtarëve mbi çështjet e sigurisë, kredibiliteti i të cilëve edhe ashtu ka qenë vështirë të mbahet në të njëjtin nivel, pas trazirave të 2004-tës, përkundër gjithë atyre reklamave që i bën KFOR-i vetes nëpër TV.

Përveç se të mbrojtë kufijtë e Kosovës dhe të përgatitet që të përballet më mirë me trazira, KFOR-i gati se nuk bën asgjë tjetër që të ndihmojë UNMIK-un të mbajë një ambient të qetë e të sigurt. Gati që nuk ka ndihmuar fare në luftën kundër ekstremistëve dhe krimin të organizuar. Në veri të Kosovës nuk ka bërë asgjë për të penguar erozionin e autoritetit të UNMIK-ut apo për të penguar hapat drejt ndarjes. Është marrë vetëm me politikë "të butë" duke bërë TV reklama për tolerancën ndëretnike dhe për trashëgiminë kulturore dhe duke ndjekur evenimentet e ndryshme nëpër komuna. "I vetmi dallim

⁷⁰ Intervistë e Grupit të Krizave, 30 gusht 2005.

⁷¹ Pas një vargu të reklamave televizive të KFOR-it që promovonin respektimin për monumentet religjioze, grupi tjetër i reklamave të shfaqura në mesin e vitit 2005 tërhoqin vërejtjen se: "Reklamat në vijim kanë për qëllim të njoftojnë opinionin publik... se në rast të trazirave që kërcënojnë sigurinë dhe rendin e ligjin"; Në reklamë tregoheshin shenjat që do të ngritë KFOR-it për të themeluar "zonat blu dhe të kuqe" nëpër tërë Kosovën. Zonat blu janë të mbrojtura nga KFOR-i dhe nga policia. Nëse futesh në këto zona e rrezikon veten. KFOR-i dhe policia janë të vendosur që të shfrytëzojnë të gjitha mjetet që kanë, për të ju larguar nga zona". Zonat e kuqe kontrollohen vetëm nga KFOR-i. Civilët nuk lejohen në këto zona... Keni parasysh, KFOR-i do të përdorë të gjitha masat e nevojshme, përfshirë edhe forcën vdekjeprurëse që të pengojë hyrjen në këto zona".

mes nesh është se ne vozisim vetura të bardha ndërsa KFOR-i të zeza”, vëren një zyrtar civil ndërkombëtar.⁷²

Deri tash vonë KFOR-i nuk është dukur shumë në veriun serb dhe nuk ka pasur ndonjë bazë atje.⁷³ Një zyrtar ndërkombëtar shprehet i shqetësuar që KFOR-i asnjëherë nuk e ka mbajtur “një prezencë të atillë që nuk do të lejonte shpërthimin e ndonjë dhune”.⁷⁴ Një tjetër shton se prezenca e dobët atje, i jep veriut një ndjenjë të “Perëndimit të egër”.⁷⁵ Kah fundi i korrikut 2006 atje është dërguar një batalion gjerman. Më herët, në qershor 2006, KFOR-i ka ndërmarrë një hap simbolik duke rihapur bazën ushtarake “Noting Hill” në Leposaviq, komunën më veriore. Por, atje ka vend vetëm për një kompani ushtarake dhe KFOR-i mendon ta shfrytëzojë atë më tepër si “hotel” sa si një kazermë të përhershme. Pas qëndrimit prej disa javëve, kompania ushtarake ndërrohet me një tjetër, zakonisht nga një shtet tjetër. Edhe pse një diplomat shpresonte se kjo do të shërbejë pas statusit si “tregues se në veri ndodhet një kufi ndërkombëtar”,⁷⁶ duket se oficerët e KFOR-it janë pajtuar me ndarjen përgjatë lumit Ibër.⁷⁷ Përkundër të gjitha këtyre, KFOR-i mbetet i popullarizuar ndër shqiptarët. Me popullaritetin që ka dhe me rolin e siguruar pas statusit, KFOR-i jep ndjenjën e stabilitetit.

2. Policia e UNMIK-ut

UNMIK-u është duke u larguar. Tani në Kosovë shërbejnë 1.800 policë ndërkombëtarë, përfshirë këtu 500 policë speciale, ndërsa numri më i madh gjatë këtyre viteve ishte 5.000 policë. Deri në fund të vitit 2005 ende ishin 2.400 policë. Një reduktim i mëtutjeshëm i trupave në 1.325 që ishte paraparë të bëhet deri kah mesi i vitit 2006 është ndërprerë. BE-ja është duke u përgatitur për misionin e saj policor pas-statusit për të zëvendësuar policinë e UNMIK-ut, për të cilën gjë mund të mbajë mes 800 dhe 1.000 oficerë të saj. Policia e UNMIK-ut qëndron prapa SHPK-së duke mbajtur në duart e veta njësitë për hetimin e rasteve më të ndjeshme siç janë ato që kanë të bëjnë me krimin e organizuar, korrupsionin në nivelet e larta apo krimet e luftës. Disa oficerë që më parë ishin caktuar të monitorojnë dhe mentorojnë punën e SHPK-së në terren, tani janë kthyer në kryerjen e detyrave aktive.

Njësitë e Formuara Policore (Formed Police Units – FPU), të përbëra nga njësitë speciale nga Polonia, Rumunia, Ukraina dhe Pakistani, gjithsej 500 oficerë, janë forca kryesore e UNMIK-ut, me njësitë e dy vendeve të para të vendosura në rajonin e Mitrovicës. Por UNMIK-u, i vetëdijshëm për jopopullaritetin e vet, mundohet që të mos konfrontohet me turmat shqiptare përveç atëherë kur kjo është absolutisht e nevojshme, pasi këto konfrontime vetëm sa e zvogëlojnë edhe më simpatinë për të.⁷⁸ Njësitë Rajonale për Mbështetje të Operacioneve apo ROSU-të e SHPK-së janë angazhuar që të arrestojnë demonstruesit që mbanin të bllokuar selinë qendrore të UNMIK-ut më 9 qershor 2006 dhe ata që bllokuan hyrjen për në Kosovë në prag të vizitës së kryeministrit serb Koshtunica, më 28 qershor.⁷⁹

UNMIK-u ka shtuar angazhimin policor në raport me serbët e Kosovës tani që vendimi për statusin po afrohet. Që nga fillimi i vitit 2005 ka dërguar më tepër oficerë në enklavat serbe pasi këtyre u besohet më shumë se sa SHPK-së. Në muajt e fundit, grupe prej 40 oficerëve kanë kaluar nga puna monitoruese në punë vepruese në zonat serbe të Graçanicës, Shtërpcës dhe pjesës veriore të Mitrovicës. Në qershor UNMIK-u dërgoi 350 policë tjerë ndërkombëtarë në veri të Kosovës si reagim ndaj shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme nga komunat serbe. 150 policë tjerë ndërkombëtarë planifikohej të dërgoheshin kah mesi i muajit korrik. Në secilin rast, më e rëndësishme ishte rezultati politik i lajmit se sa përgatitja operationale adekuate, ndërsa duket se edhe numri i policëve të dërguar është më i vogël se sa që është pohuar.⁸⁰

Misioni policor i BE-së, pas statusit, planifikohet të jetë më i vogël dhe të merret edhe me policinë por edhe me gjyqësinë dhe në të njëjtën kohë të mbajë “funksione të kufizuara ekzekutive” në kuadër të prezencës më të gjerë

⁷² Intervistë e Grupit të Krizave, 16 qershor 2006.

⁷³ Një zyrtar amerikan, privatisht, i quajti “pallavra” refrenet e KFOR-it se nuk është e rëndësishme se ku janë të vendosura trupat por se ku veprojnë ato. Intervistë e Grupit të Krizave, Prishtinë, maj 2006.

⁷⁴ Intervistë e Grupit të Krizave, Prishtinë, prill 2006.

⁷⁵ Intervistë e Grupit të Krizave, Prishtinë, 24 maj 2006.

⁷⁶ Intervistë e Grupit të Krizave me një diplomat nga Evropa Perëndimore, Prishtinë, 23 maj 2006.

⁷⁷ Intervistë e Grupit të Krizave, Kosovë veriore, qershor 2006.

⁷⁸ Megjithatë, sulmet kundër stafit apo objekteve të UNMIK-ut kanë qenë të pakta në vitin e fundit. Një polic i UNMIK-ut, nga Nigeria, është vrarë nga një mjet shpërthyes i vendosur në veturën e tij në Prizren, në janar 2005. Shih raportin e Grupit të Krizave, *Kosova pas Haradinajt*, op.cit.fq. 4-6; dhe raportin, *Kolapsi në Kosovë*, op.cit.fq. 11-13, për përshkrim të periudhave kur këto sulme kanë qenë më të shpeshta.

⁷⁹ Planifikimi i dobët nga ana e UNMIK-ut ka pasur për pasojë përleshje fizike mes policëve të UNMIK-ut dhe pjesëtarëve të familjeve të të zhdukurve, duke nxitur zemërimin e vendorëve. Policia pat intervenuar që të largojë protestuesit që kishin bllokuar rrugën në qendër të Prishtinës, të ulur në rrugë, më 30 gusht 2004; ndërsa më 25 maj 2006, shkaktuan një incident ku 30 persona u lënduan në fshatin e shkatërruar nga lufta, Krushë e Vogël, derisa mbronin dy avokatë serbë të cilët i shpëtuan nga linçimi i mundshëm.

⁸⁰ Intervista të Grupit të Krizave me zyrtarë të lartë të UNMIK-ut në Prishtinë dhe me burime nga Policia e UNMIK-ut në veri të Kosovës, korrik 2006..

ndërkombëtare.⁸¹ Serbët, veçanërisht, mund të ndihen sikur reduktimi i menjëhershëm i numrit të policëve ndërkombëtarë do t'i lejë enklavat e tyre më të ekspozuara dhe te pa mbrojtura.

III. TRUPAT MBROJTËSE TË KOSOVËS: PENGESË APO MUNDËSI

Nga të gjitha organizatat zyrtare të sigurisë, TMK-ja ka rolin më të paqartë. Asaj nuk i është lejuar të luajë kurrfarë roli në çështjet e sigurisë e megjithatë të gjithë e shohin si një faktor të rëndësishëm të sigurisë.⁸² Shqiptarët i besojnë më shumë se SHPK-së, KFOR-it dhe Policisë së UNMIK-ut e megjithatë ka mbetur jashtë planeve për zhvillim të organeve të sigurisë dhe e ardhmja e saj mbetet e paqartë. Por TMK-ja nuk mundet të zhduket edhe aq lehtë. Ajo është themeluar në kuadër të konstelacionit të përgjithshëm institucional edhe pse shihet ndryshe nga secila palë. TMK-ja mundohet të tregojë se ka disiplinë dhe se është politikisht e paanshme dhe në shërbim të së ardhmes së Kosovës. Shqiptarët i besojnë tepër por bashkësia ndërkombëtare e sheh me dyshim, sikur të ishte një gjë e turpshme për të cilën nuk dëshiron të flasësh. Serbët e konsiderojnë TMK-në, përgjegjëse të drejtpërdrejtë për krimet kundër civilëve të komunitetit të tyre në vitet e vona të nëntëdhjeta, kur vepronte si Ushtri Çlirimtare e Kosovës (UÇK). A është pra TMK-ja një thumb që pengon zhvillimin e Kosovës apo është një instrument me të cilin mund të bashkëpunohet dhe që mund të ndihmojë shtet-ndërtimin në Kosovë?

Shumica e personelit të TMK-së në gjashtë zonat e saj mbrojtëse më parë nuk e kanë pranuar me dëshirë mandatin e tyre të përkohshëm civil, e në të vërtetë as shqiptarët e as serbët nuk e shohin TMK-në si organizatë që ka vetëm rol të tillë. Shqiptarët e shohin si ushtri të ardhshme të Kosovës. Serbët ia kanë frikën dhe e urrejnë për shkak të kaluarës së saj.⁸³ Ndërsa, derisa komunitetet në Kosovë e shohin nga prizma e të kaluarës apo e të ardhmes, bashkësia ndërkombëtare mundohet të mbajë sytë vetëm në të tashmen duke e bërë implementimin e mandatit të saj të përkohshëm një nga tetë standardet e OKB-së me të cilat matet gatishmëria e Kosovës për statusin final.

A. MANDATI

Më 20 qershor 1999, komandanti i UÇK-së, Hashim Thaçi, dhe komandanti i KFOR-it, gjenerali Mike Jackson, nënshkruan Marrëveshjen për Demilitarizim dhe

⁸¹ "Roli i ardhshëm dhe kontributi i BE-së në Kosovë", letër e dorëzuar bashkërisht nga Javier Solana, Përfaqësues i lartë i BE-së për politikë të jashtme dhe siguri, dhe Oli Rehn, Komisionari Evropian për Zgjerim, para Këshillit të Ministrave, në korrik 2006; sikur edhe në rastin e raporteve tjera që i kanë dorëzuar në qershor dhe dhjetor 2005, dokumenti nuk është publikuar, por joformalisht ka qarkulluar gjerësisht.

⁸² Edhe pse "nuk është forcë e sigurisë, (TMK) është faktor i sigurisë". Intervistë e Grupit të Krizave, me atëbotë komandantin e TMK-së, Agim Çeku, Prishtinë, 30 gusht 2005.

⁸³ Hulumtimet e opinionit për ISSR; intervistë e Grupit të Krizave me një zyrtar të sekretariatit të ISSR, Prishtinë, 8 maj 2006.

Demobilizim të UÇK-së. UÇK-ja u pajtua që gjatë tre muajve të ardhshëm t'ia dorëzojë KFOR-it të gjitha armët përveç revolveve dhe pushkët e gjuetisë si dhe t'i përmbahet Rezolutës 1244 që shtron kushtet për ndërprerjen e lutës dhe hyrjen e KFOR-it në Kosovë. TMK-ja zyrtarisht u themelua më 20 shtator 1999. Në të njëjtën kohë, KFOR-i nënshkroi Deklaratën e Parimeve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës ndërsa UNMIK-u miratoi një rregullore që i dha TMK-së status legal.⁸⁴ PSSP-ja dhe UNMIK-u morën nën kontroll TMK-në ndërsa COMKFOR-i mori përgjegjësinë për mbikëqyrjen e ditëpërditshme. Kështu, me anë të përfaqësuesve të tyre në terren, NATO dhe Sekretariati i OKB-së krijuan një institucion pasardhës të UÇK-së e në të njëjtën kohë përmbushën kërkesën e Rezolutës 1244 që ajo të demilitarizohet.⁸⁵

U vunë kufizime strikte në të drejtën e TMK-së që të përdorë forcën. Në mënyrë eksplicite nuk iu dha rol në çështjet e mbrojtjes, mbajtjen e rendit e ligjit apo në përballje me trazira. Disa pjesëtarë të zgjedhur u lejuan që të mbajnë armë të kufizuara, kryesisht për të mbrojtur instalacionet e tyre.⁸⁶ TMK-ja ishte, para së gjithash, trupë emergjente civile, e aftësuar që të veprojë në fatkeqësi të ndryshme, përfshirë fikjen e zjarreve, aksidentet industriale, operacionet e kërkim/shpëtimit dhe ndihmën humanitare. Përveç kësaj, iu dhanë edhe detyra ceremoniale, ato për deminim si dhe projektet për rindërtim për komunitete. Shpresohet se shumë shpejtë do të jetë në gjendje t'i kryejë këto shërbime pa ndihmën ndërkombëtare. Në fillim, në vitin 1999, PSSP-ja Bernard Kouchner u mundua që të bëjë personelin dhe eprorët e saj që të mësojnë dhe të pëlqejnë modelin e Sigurimit Civil Francez (Securité Civile).⁸⁷ Ai plan parashikonte që qindra pjesëtarë të TMK-së të shkojnë në Francë, Belgjikë, Itali e Gjermani që të shohin në vepër këto aksione dhe të mësojnë punën praktike të shpëtimit dhe

rindërtimit dhe kështu gradualisht të fitojë edhe besimin e serbëve.⁸⁸

Nga perspektiva e ndërkombëtarëve, ideja kryesore ishte që ish-luftëtarët të kontrolloheshin derisa t'i vinte rendi çështjes së statusit final. UÇK-ja qartë synonte të bënte TMK-në ushtri të ardhshme të Kosovës dhe kjo dëshirë nuk është zbehur aspak. Zyrtarë të lartë të NATO-së që kanë punuar me UÇK-në gjatë fushatës së bombardimeve më 1999 e kanë inkurajuar këtë. Një zyrtar i lartë ushtarak ndërkombëtar tregon: "UÇK-ja ka nënshkruar marrëveshjen për demilitarizim më 1999 me mendimin se do të transformohen në ushtri".⁸⁹ Kjo marrëveshje ka lejuar "formimin, pas një kohe, të Ushtrisë së Kosovës sipas modelit të Gardës Kombëtare të Amerikës dhe atë në kuadër të procesit politik të përcaktimit të statusit të ardhshëm të Kosovës, duke pasur parasysh Marrëveshjen e Rambouillet".⁹⁰

Edhe bashkësia ndërkombëtare edhe UÇK-ja kanë marrë nga negociatat atë që kanë dashur të dëgjojnë. Edhe pse Kouchner në ditën e formimit të saj qe shprehur se "Trupat nuk duhet të jenë ushtri... dhe nuk janë ushtri",⁹¹ UÇK-ja e shihte KFOR-in si bashkëbisedues kryesor dhe filloi të besonte se TMK-ja do të jetë një ushtri në ndërtim e sipër. Negociatat ishin të vështira dhe kjo e bëri pranimin nga ana e UÇK-së më të lehtë. Dhe është bindja dhe besimi se do të bëhet ushtri ajo që e ka bindë TMK-në, që t'i përmbahet mandatit të saj të kufizuar për mbrojtje civile.

Me kalimin e viteve dhe me ndërrimet e shumta të personelit që merrej me TMK-në, u humb konteksti në të cilin ishte përpiluar mandati dhe filluan të mbizotërojnë interpretime më të fjalëpërfjalshme. "Njerëzit kanë harruar pse jemi këtu, ku ka filluar krejt dhe ku duhet të përfundojë", thoshte një zyrtar ushtarak ndërkombëtar për kolegët e tij në vitin 2004.⁹² Një zyrtar tjetër ndërkombëtar që punonte me TMK-në më 2005 rikujtonte se "është dhënë fjala" dhe se aspiratat e TMK-së bazoheshin në marrëveshjen e vitit 1999 dhe në supozimin se bashkësia ndërkombëtare do të mbajë fjalën.⁹³ Megjithatë, nga selia e NATO-s në Bruksel tani vijnë fjalë tjera: "Kur është themeluar TMK-ja është shpjeguar edhe mandati i saj... nuk është thënë se do të transformohet në ushtri."⁹⁴ Duke shfrytëzuar marifetet e

⁸⁴ Rregullorja e UNMIK-ut numër 1999/8, në www.unmikonline.org.

⁸⁵ Rezoluta kërkonte që "UÇK-ja dhe grupet tjera të armatosura, t'u japin fund menjëherë të gjitha aksioneve ushtarake dhe të veprojnë në përputhje me kërkesat për demilitarizim të përcaktuara nga kryesuesi i prezencës ndërkombëtare të sigurisë në konsultim me PSSP-në". Rregullorja e UNMIK-ut numër 1999/8, në www.unmikonline.org.

⁸⁶ TMK-së i lejohet të ketë 200 armë për siguri dhe për ruajtjen e objekteve. Pasi u ka hedhur poshtë kërkesat për tri vite, KFOR-i më në fund ka lejuar rojet që të trajnohen për përdorimin e sigurt të armëve kah mesi i vitit 2006. Por, nuk është lejuar trajnimi në qitje me armë.

⁸⁷ Shih prezantimin e Ministrisë së Brendshme të Francës për një përshkrim të funksioneve dhe strukturës së saj, në (në gjuhën franceze):

www.interieur.gouv.fr/sections/a_1_interieur/defense_et_securite_civiles/presentation

⁸⁸ Konferencë për gazetarë, 21 shtator 1999.

⁸⁹ Intervistë e Grupit të Krizave, Prishtinë, 25 shkurt 2005.

⁹⁰ Marrëveshja për Demilitarizim dhe Transformim të UÇK-së, nënshkruar nga KFOR-i dhe Ushtria Çlirimtar e Kosovës, 20 qershor 1999.

⁹¹ Konferencë për gazetarë, 21 shtator 1999.

⁹² Intervistë e Grupit të Krizave, Prishtinë, 24 janar 2004.

⁹³ Intervistë e Grupit të Krizave, Prishtinë, 31 gusht 2005.

⁹⁴ Sipas një zyrtari të NATO-s i cili i ka folur në kushte anonimiteti gazetarit të Kohës ditore, Augustin Palokaj. Shih

avokatëve për t'i interpretuar marrëveshjet sipas nevojës, NATO mund të thotë se fjalët për themelimin e ushtrisë që janë në marrëveshjen për demilitarizim të qershorit 1999 nuk vënë lidhje të drejtpërdrejtë me themelimin e TMK-së në shtator 1999, prandaj ushtria e Kosovës mund të formohet edhe nga burime tjera, edhe pse kjo për TMK-në dhe për shumicën e shqiptarëve të Kosovës do të ishte shkelje e fjalës së dhënë.

Edhe pse TMK-ja do të presë edhe me tutje nëse është nevoja, mbajtja e *status quo*-së është opsion i padobishëm. TMK-ja ka jetuar më gjatë se sa që është paraparë, për së paku katër vite; faza emergjente ka përfunduar ndërsa komunat kanë zhvilluar kapacitetet e tyre për të përmbushur rolin e TMK-së. "Jemi duke e humbur rolin si organizatë civile emergjente", është shprehur gjeneral Çeku në vitin 2005.⁹⁵ Zyra e Koordinatorit pajtohet se TMK-ja "nuk ka mjaft punë".⁹⁶ Për më tepër, ajo nuk ka mjaft donacione.⁹⁷ Shpeshherë nuk ka pajisje për reagime në situatat emergjente siç ishin vërshimet që nxjerrën jashtë përdorimit gjeneratorët e KEK-ut në shkurt 2006.⁹⁸ Më pak se një e treta e personelit aktiv janë specialistë të kualifikuar; të tjerët nuk kanë përgatitje profesionale. Vetëm një grusht prej tyre janë trajnuar jashtë, e jo me qindra siç parashihte Kouchner-i.

Synimi ishte që kapacitetet për kërkim-shpëtim, zjarrfikëse, deminuese dhe të ngjashme të TMK-së të centralizohen në një Brigadë të Mbrojtjes Civile që do të përbëhej nga 500 trupa, edhe pse deri sot në të janë vetëm 330 trupa. Njësitë tjera të aftësuar janë për shërbime mjekësore dhe inxhinieri, ndërsa rreth 2.000 pjesëtarë tjerë që nuk janë pjesë e asnjërit nga këto elemente nuk kanë çfarë të bëjnë. 2.000 trupat rezervë që nga viti 2003 janë neglizhuar edhe më tepër. Thirrjet e herëpashershme për aktivizim i kanë mbajtur të involvuar deri në vitin 2005, por që atëherë më nuk ka pasur fonde as për këtë.

artikullin e tij "TMK-ja nuk mund të jete ushtri e Kosovës", *Koha Ditore*, 19 maj 2006.

⁹⁵ Intervistë e Grupit të Krizave, 30 gusht 2005.

⁹⁶ Intervistë e Grupit të Krizave, 31 gusht 2005.

⁹⁷ Trajnimet e IOM-it janë financuar nga SHBA-ja dhe kanë kushtuar mbi 20 milion dollarë. Këto fonde kanë mbaruar në vitin 2004 dhe më pas nuk është paraqitur asnjë donator tjerët. Në nëntor 2005, Holanda dhe Mbretëria e Bashkuar kanë ofruar fonde për disa projekte.

⁹⁸ Gjysma e "Batalionit për mbrojtje kimike e biologjike" nuk ka pajisje të duhura dhe mund të mbajë vetëm trajnime teorike. Mungojnë edhe pajisjet për kërkim-shpëtim. Për të nxjerrë një kufomë nga një pus komandanti i Zonës së tretë mbrojtëse të TMK-së, Komandanti i saj është dashur të blejë litar me paratë nga xhepi i vet. Pa rroba mbrojtëse, pjesëtarët shkuan në shtëpitë e tyre duke u ardhur era e kufomës. Intervistë e Grupit të Krizave, Pejë, 1 qershor 2006.

Ndërsa TMK-ja ende nuk e ka ndërruar identitetin e vet: ajo ende dëshiron të bëhet ushtri.

Në vitet e fundit TMK-ja ka mësuar si të lëvizë drejt synimit të saj edhe në kuadër të mandatit që ka tani. Më 2004, UNMIK-u nisi programin për vlerësimin e pjekurisë së IPVQ-së në qeverisje dhe në akomodimin e pakicave. Standardi i tetë dhe i fundit (i njohur si "standardi i tetë") është dizajnuar që të masë profesionalizmin e TMK-së, implementimin e mandatit që ka dhe progresit në rekrutimin dhe sistemimit në rangjet e veta të jo-shqiptarëve.⁹⁹ Nga mesi i vitit 2004 çdo çerekviti bëhej vlerësimi i tyre dhe TMK-ja e ka pranuar këtë proces edhe si sfidë por edhe si mjet. Standardi i tetë ka ndihmuar të bëhet e qartë përbrenda TMK-së se "gjërat duhet të bëhen mirë". Raportimet për të edhe në raportin e Eide-s edhe në ato të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së kanë bërë që kjo frymë të konsolidohet edhe më.¹⁰⁰

TMK-ja ka ndërmarrë shumë projekte për përmirësimin e infrastrukturës, gati një të tretën e tyre në fshatrat serbe. Pjesa më e madhe e donacioneve që i merr janë për projekte të tilla. Është bërë mjet shumë i përdorshëm për përgatitjen e lokacioneve për kthim, duke larguar rrënojat nga Lagjia Rome në Mitrovicë më 2005 apo duke bërë punë të ngjashme në fshatin serb Bablak, komuna e Ferizajit, në qershor 2006. Po këtë muaj, UNMIK-u ia besoi rindërtimin e fshatit serb Frashër/Svinjarë, i shkatërruar në trazirat e marsit 2004 – një nga trembëdhjetë standardet specifike që kërkohen të përmbushen nga Grupi i Kontaktit deri në vjeshtë. TMK-ja ka qëndruar e përkushtuar në këtë punë për të cilën nuk merr kurrfarë shpërblimi material e as mirënjohje nga komuniteti i gjerë serb në Kosovë. Tri zona të TMK-së në mënyrë aktive marrin fonde nga autoritetet komunale për projekte në fshatrat me komunitete pakicë.¹⁰¹ TMK-ja thotë për vete se është institucioni kosovar që më së shumti ua shtrinë dorën pakicave. "TMK-ja po ndihmon realizimin edhe të standardeve tjera, siç është kthimi, e jo vetëm atë tonin", thekson një gjeneral i TMK-së që shpreh edhe brengën se përqendrimi i tepërt në projektet

⁹⁹ Standardi i Tetë kërkon që TMK-ja t'i përmbahet plotësisht mandatit të vet si "organizatë civile për emergjencë, që në Kosovë bën reagime të shpejta kur rrezikohet siguria publike në kohë të emergjencave si dhe ndihmë humanitare." TMK-ja duhet të operojë "në mënyrë transparente, të përgjegjshme, të disiplinuar dhe profesionale dhe të përfaqësojë tërë popullatën e Kosovës". Shih www.unmikonline.org për pikat tjera vlerësimin e të cilave UNMIK-u e bën çdo çerekviti.

¹⁰⁰ Raporti i Eide's mund të gjendet në internet në (në gjuhën angleze): www.un.org/depts/dhl/da/kosovo/kosovo3a.htm, ndërsa raporti më i fundit i Sekretarit të Përgjithshëm (në gjuhën angleze) në: www.un.org/Docs/sc/sgrep06.htm.

¹⁰¹ Intervistë e Grupit të Krizave me Koordinatorin e TMK-së, Gjeneralmajorin Chris Steirn, Prishtinë, 28 prill 2006.

për serbët që do të mund të cenonte imazhin e TMK-së në messin e shqiptarët.¹⁰²

Nga ditët e para më 1999 dhe skandalet në vitet 2002-2003, disiplina në TMK është përmirësuar dukshëm. Në dhjetor 2005 është futur në fuqi kodi disiplinor. KFOR-i dhe UNMIK-u kanë ndihmuar që të fuqizohet zyra e inspektoratit të brendshëm (tash e pavarur). Një epror i SHPK-së shprehte keqardhje që policët e tij nuk kishin të njëjtat standarde të disiplinës sikur edhe zona e TMK-së.¹⁰³ Të rinj që studiojnë në universitet përkrah kadetëve të TMK-së janë impresionuar me shembullin që kanë dhënë ata.¹⁰⁴ Në televizion, TMK-ja duket e dhënë së tepërmi pas mësimit dhe disiplinës së kadetëve.¹⁰⁵

TMK-ja ka siguruar kurse intensive të gjuhës angleze për 7 për qind të personelit dhe kadetët e vet i dërgon për shkollim universitar. Por, niveli i lartë udhëheqës mbetet pak i zhvilluar dhe kështu trupat mbeten të pashfrytëzuara. Tepër shumë energji shpenzohet në atë që të duken si ushtri dhe në përpjekjet frustuese që të zgjerojnë mandatin e tyre. Numri më i madh i pjesëtarëve thjeshtë po presin dhe kështu paraqesin atë që bën tërë Kosova – presin për pavarësinë në vend se të punojnë të bëhen gati për të.

B. PËRBËRJA DHE AFTËSITË

Për dallim nga SHPK-ja që vazhdimisht është rritur, TMK-ja ka mbetur me të njëjtën njerëz të ish-UÇK-së që iu bashkëngjiten asaj në vitin 1999. Nga 25.000 që u regjistruan në IOM si ish-pjesëtarë të UÇK-së, 20.000 patën aplikuar për 5.000 vende në TMK.¹⁰⁶ Ka pasur një vazhdimësi nga UÇK-ja jo vetëm në personel, por edhe në uniforma, simbole, rangje dhe në strukturë. Që nga atëherë, rigjediteti i strukturës dhe përbërjes së TMK-së është forcuar për shkak të paqartësisë rreth asaj nëse do të lejohet të bëhet përsëri organizatë ushtarake. Deri sa të garantohet kjo, TMK-ja nuk është e gatshme që të ndërrojë. Individualisht, pjesëtarët e saj nuk dëshirojnë të largohen nga ajo deri sa të kenë siguruar pensionet apo vende tjera pune. Moshë mesatare e pjesëtarëve është ngritur nga 29 në 37. Shumë nga pjesëtarët e saj nuk janë mjaft të përgatitur fizikisht apo nuk kanë përgatitjen e duhur arsimore apo edhe janë të vjetër në moshë për të

qenë ushtarë. Një gjeneral i TMK-së pranon: “Në TMK nuk kemi më ushtarë. Duhet të rekrutojmë një gjeneratë të re”.¹⁰⁷

KFOR-i dhe liderët e UÇK-së i patën zgjedhur pjesëtarët e TMK-së. Ka pasur vende për 3.052 personel aktiv dhe 2.000 tjerë rezervë, ndërsa deri në vitin 2003 këto role kanë ndërruar. Edhe pse 10 për qind duhej të jenë jo-shqiptarë, një numër i vogël qenë emëruar nga pakicat. Përpjekjet e sinqerta për të bërë këtë filluan vetëm pas fillimit të programit të standardeve në vitin 2004. UNMIK-u e di se ky prag prej dhjetë për qind është vështirë të arrihet sepse ka tepër pak serbë që janë të gatshëm të hyjnë në një organizatë që ka dalë nga UÇK-ja. Serbët që e bëjnë këtë zakonisht i nënshtrohen presionit të bashkëkombësve apo edhe Beogradit dhe detyrohen ta lënë atë.¹⁰⁸ Përfaqësimi i pakicave është shtuar gradualisht nga 4,9 për qind sa ishte në korrik 2004 në 6,7 për qind sa ishte në korrik 2006, por shkalla e atyre që e lëshojnë organizatën mbetet e lartë:¹⁰⁹ sipas disave, për të mbajtur serbët në TMK janë ulur edhe standardet disiplinore, veçanërisht ato për mungesat.¹¹⁰ Si do që të jetë, komandanti i TMK-së, Sylejman Selimi, e emëroi një femër serbe në postin e majorit në një zyre të tij të jashtme disa javë pasi më 10 mars 2006 u emërua komandat dhe ka paralajmëruar se do të emërojë një serb të jetë zëvendëskomandant i tij.¹¹¹

Eprorët e lartë të TMK-së qenë caktuar në fund të vitit 1999 nga lidërimi i UÇK-së dhe prej atëherë kanë mbetur të njëjtët në shumicën e rasteve. Vala e arrestimeve nën akuzat për krime lufte, dorëheqjet dhe suspendimet për shkak të dyshimeve për pjesëmarrje në aktivitete të dyshimta kanë krijuar mangësi të shumta dhe vetëm në prill 2006 është institucionalizuar sistemi profesional i vlerësimit – kur ishte tepër vonë për të ndërruar hierarkinë. Një zyrtar ndërkombëtar që ka punuar së afërmi me TMK-në, thotë: “Eprorët e lartë janë krejtësisht të paaftë. Shumëçka bazohet në atë se sa njerëz i ke vrarë gjatë luftës, në lidhjet familjare e fafeshnore”. Shumica e këtyre eprorëve iu kanë bashkuar UÇK-së në fazat fillestare. Po ky epror shprehet se pjesëtarët më të ri

¹⁰⁷ Intervistë e Grupit të Krizave me Gjeneral Kadri Kastrati, Prishtinë, 9 qershor 2006.

¹⁰⁸ Që nga nëntori 2004 zyra ka themeluar “Task-Forcën 8” për të rekrutuar dhe mbajtur kandidatët nga pakicat etnike.

¹⁰⁹ Nga nja njëzet jo-shqiptarë që u regjistruan për trajnimet bazë të TMK-së në maj 2006, vetëm dy boshnjakë, një turk dhe një rom kanë përfunduar trajnimin. Katër serbë janë tërhequr që në ditën e parë.

¹¹⁰ “Ata janë të privilegjuar. Ata nuk kanë nevojë të vijnë me rregull. Ata vetëm i marrin pagat”, thotë një komandant i një njësie të TMK-së. Intervistë e Grupit të Krizave, 16 maj 2006.

¹¹¹ Shih: Përparim Isufi: “Sylejman Selimi i gatshëm ta emërojë një serb në postin e zëvendëskomandantit të TMK-së”, *Zëri*, 1 qershor 2006.

¹⁰² Intervistë e Grupit të Krizave, Prishtinë, 9 qershor 2006.

¹⁰³ Intervistë e Grupit të Krizave, 17 maj 2006.

¹⁰⁴ Intervistë e Grupit të Krizave, prill 2006.

¹⁰⁵ Një program i emituar në RTK, në muajin maj 2006, tregonte gjerësisht për inspektimet rigorozë që u bëhen dhomave dhe për dënimet që shqiptohen nëse nuk e rregullon mirë shtratin apo madje edhe vetëm nëse gota jote është me pluhur.

¹⁰⁶ “Programi për Trajnim të Trupave Mbrojtëse të Kosovës”, IOM, Prishtinë, 2004.

të TMK-së janë përgjithësisht shumë më shumë afër doktrinës dhe praktikës ushtarake bashkëkohore, ndërsa “gjeneratat e mëhershme janë komunistë të skajshëm dhe nuk do të ndërrojnë”.¹¹² Lideri i PDK-së dhe ish-shefi i UÇK-së, Hashim Thaçi, pranon se rangjet janë ndarë pa marrë parasysh aftësitë profesionale: “E di, unë i kam emëruar shumicën prej tyre”.¹¹³ E gjithë kjo dërgon mesazhe dekurajuese tek të rinjtë të cilët shohin se pa marrë parasysh se sa angazhohesh, “shoqëria” e atyre që kanë bërë emër në vitet 1998-1999 mbetet e mbyllur dhe i mban gjërat nën kontroll.

Koordinatori i UNMIK-ut për TMK-në pajtohet me shprehjen e një gjenerali të TMK-së¹¹⁴ se potenciali më i madh i këtij institucioni ndodhet në rangjet e mesme apo ato të poshtme. “Ka një ngritje në profesionalizëm, një entuziazëm të sinqertë që gjërat të bëhen siç duhet dhe ka shumë talent... kemi investuar shumë në nivelin e mesëm të menaxhmentit”.¹¹⁵ Pasi të gjitha konkurset në dy vitet e fundit kanë qenë të rezervuara për pakicat, ka qenë shumë e vështirë për të rinjtë shqiptarë të Kosovës që të inkuadrohen. Në anën tjetër, konkurrimi për kadetë tregon sa është interesimi për këtë. Në vitin 2005 për dymbëdhjetë vende kanë aplikuar 400 kandidatë; në maj 2006 për 22 vende kishin aplikuar 600 kandidatë.¹¹⁶

E tërë “pesha” e TMK-së është në maje të saj. TMK-ja është “skema më e madhe në Ballkan për financimin e ish-eporëve”¹¹⁷ pasi ka gati 80 eporë që komandojnë çdo ushtar aktiv dhe ka kolonela sa ndonjë ushtri e Evropës Perëndimore apo edhe më shumë. Rangjet e eporëve përbëjnë një të tretën e personelit aktiv. TMK-ja ka bërë reduktime duke bërë 2.000 pjesëtarë trupa rezervë në vitin 2003 në një mënyrë që e ka bërë edhe më të pazakontë strukturën: 60 për qind e rreshterëve dhe pjesëtarë të rangjeve më të ulëta janë demobilizuar ndërsa efektivit i eporëve ka humbur më pak se 20 për qind të pjesëtarëve. Tabela në vijim ilustron këtë mosfunksionim:

| Struktura e Forcës së TMK-së në korrik 2006 | | | |
|--|---------------|-------------------|----------------|
| <i>Rangu</i> | <i>Aktivë</i> | <i>Në shërbim</i> | <i>Rezervë</i> |
| Gjeneralkolonel | 1 | 1 | 0 |
| Gjeneralmajor | 2 | 1 | 0 |
| Gjeneralbrigade | 14 | 13 | 0 |
| Kolonel | 50 | 48 | 2 |
| Nënkolonel | 119 | 117 | 2 |
| Major | 209 | 203 | 13 |
| Kapiten | 356 | 356 | 60 |
| Toger | 440 | 436 | 136 |
| Kapter | 439 | 438 | 96 |
| Rreshter | 366 | 365 | 188 |
| Tetar | 1,035 | 1,028 | 1,438 |
| Ushtarë | 21 | 20 | 65 |
| <i>Gjithsej:</i> | <i>3,052</i> | <i>3,026</i> | <i>2,000</i> |

Eporët e lartë të TMK-së janë të vetëdijshëm për këtë problem. Ish-komandanti Çeku ka raportuar se komandantët e gjashtë zonave janë pajtuar me një plan për një forcë më të vogël, më profesionale dhe më të centralizuar.¹¹⁸ Por disa kundërshtojnë. “Nuk shoh se është e nevojshme që të ndryshohen rangjet, të hapen për njerëz të ri... fundi i fundit, nuk do të rijmë të gjithë këtu deri sa të vdesim”, thotë një komandant njësie me influencë, i cili shton se TMK-ja do të mund të zgjidhte këtë problem thjeshtë duke ulur gradat e disa oficerëve.¹¹⁹

Për tri vite TMK-ja ka përfutur nga një program trajnues me fonde të mëdha i realizuar nëpërmjet IOM-it. Fondet për të i ka dhënë SHBA-ja ndërsa trajnimet dhe doktrinën u zhvilluan nga përvoja e saj ushtarake. U trajnuan edhe vet trajnuesit e TMK-së. Por, fondet përfunduan në fund të vitit 2004 dhe TMK-ja u la pak a shumë vetëm. Ajo ka përmirësuar tri qendrat kryesore të trajnimit (në Prishtinë, në Ferizaj dhe në Gjakovë) ndërsa ka ndihmuar edhe qëndrimi dukshëm më profesional në tri vitet e fundit. Megjithatë, Komanda e Trajnimit dhe Doktrinës (Training and Doctrine Command - TRADOC) nuk mjafton. Shumë nga eporët e saj të lartë nuk e flasin gjuhën angleze gjë që e kufizon aftësinë e tyre për të mësuar nga literatura ndërkombëtare. TMK-ja është e vetëdijshme se ka nevojë për NATO-n për tu zhvilluar pasi ka nevojë për trajnime në logjistikë dhe menaxhment

¹¹² Intervistë e Grupit të Krizave, Prishtinë, 2 mars 2005.

¹¹³ Intervistë e Grupit të Krizave, Prishtinë, 6 mars 2005.

¹¹⁴ Intervistë e Grupit të Krizave me Gjeneral Brigade, Kadri Kastrati, Prishtinë, 9 qershor 2006.

¹¹⁵ Intervistë e Grupit të Krizave me Gjeneralmajorin, Chris Steirn, Prishtinë, 28 prill 2006.

¹¹⁶ Intervistë e Grupit të Krizave me A. Haxhosaj, shef i Qendrës së Trajnimit Fillestar në Gjakovë, 16 maj 2006.

¹¹⁷ Intervistë e Grupit të Krizave me stafin e zyrës së Koordinatorit të TMK-së, Prishtinë, 31 gusht 2005.

¹¹⁸ Intervistë e Grupit të Krizave, 20 gusht 2005.

¹¹⁹ Intervistë e Grupit të Krizave, 16 maj 2006.

për eprorët e lartë dhe të mesëm. Edhe pse nuk ka shënime për zhvillimit profesional që kanë pasur pjesëtarët e saj, TMK-ja është e vendosur që të mos e humbasë asnjë rast për trajnime madje edhe për oficerët e saj që vështirë se do të kalojnë fazën seleksionuese.¹²⁰ Në fillim të vitit 2006, trupat amerikane të KFOR-it ndërmoren një trajnim gjashtëmuor për eprorët profesionistë për 50 oficerë të TMK-së por nuk ka trajnues profesionale kështu që TMK-ja shpreson se këtë do ta bëjë një mision i specializuar i NATO-s.

Gjashtë zonat mbrojtëse të TMK-së rrjedhin nga zonat operative të UÇK-së, njësoj sikur edhe Shtabi i përgjithshëm i TMK-së. Gjatë luftës, "Shtabi i përgjithshëm" i UÇK-së vepronte përkrah komandantëve të zonave që ishin njaft të fuqishëm. Shumë prej tyre ishin "mësuar të veprojnë lirshëm dhe me pak mbikëqyrje komanduese."¹²¹ Kjo ka sjellë si pasojë një gjendje në të cilën eprorët e lartë funksionojnë më tepër si një rreth se sa si një piramidë. Sidomos komandantët nga Drenica nuk i pranojnë gjithmonë urdhrat nga shtabi qendror. Thuhet se komandanti i Gardës ceremoniale, Nuredin Lushtaku, ka refuzuar urdhrin që njësia e tij të bëjë nderë në ceremoninë e varrimit të Presidentit Rugova dhe për këtë është dashur të dërgohet një njësi tjetër.¹²² Edhe pse komandanti i Zonës së Drenicës, Bashkim Jashari, është pjesë e grupit punues të shtabit që punon në përpilimin e planit ideor për të ardhmen e TMK-së, ai është i sigurt se "fjalën e fundit megjithatë do ta kenë komandantët e zonave".¹²³

Profesionalisht, zonat e TMK-së janë zhvilluar në nivele të ndryshme. Njerëzit kryesorë që themeluan TMK-në ishin kryesisht nga Drenica që ishte emëruar Zona e Parë dhe tani konsiderohet si thelbi, zemra e TMK-së. Edhe njësia prestigjioze, Garda e TMK-së, e vendosur në Prishtinë, dominohet nga Drenica. Rajoni lindor i Gjilanit ka pasur pak luftë dhe strukturat e atjeshme të UÇK-së nuk qenë zhvilluar. Por, edhe pse për nga emri ishte e fundit, Zona e Gjashtë, duke iu falënderuar bashkëpunimit me trupat amerikane të KFOR-it ajo është bërë zona më dinamike, më e përparuar në komandim dhe më së miri e pajisur. Zonat tjera u ndien të turpëruara në një trajnim fushor në vitin 2003: derisa pjesëtarët e tyre flinin në tendat e vogla të UNHCR-së, pjesëtarët e Zonës

së gjashtë flinin në ato të ushtrisë amerikane që kishin edhe kondicionerë.¹²⁴

Oficerët e TMK-së thonë se edhe bashkëpunimi me trupat britanike ka qenë shumë frytdhënës, deri sa këto trupa nuk u tërhoqën në vitin 2003. Forcat e Skandinavisë që morën komandën në Brigadën Shumë-Kombëshe Qendër nuk kishin bashkëpunim me TMK-në.¹²⁵ Vetëm në qershor 2006 Shtabi qendror i KFOR-it dhe TMK-ja janë pajtuar rreth një pakete të trajnimeve të standardizuara tremujore e të cilat komanda e KFOR-it ka urdhëruar të implementohen nga të gjitha brigadat e KFOR-it në bashkëpunim me komandat e zonave.¹²⁶ Mungesa e një programi standard të trajnimit ka zbehur imazhin e NATO-s në TMK që ka zhvilluar preferenca të fuqishme për Mbretërinë e Bashkuar dhe SHBA-në ndërsa mbretërojnë përshtypje më negative për disa nga vendet tjera anëtare të NATO-s.

Komanda e Zonës së gjashtë është pro-aktive në kërkimin e projekteve të komunës për infrastrukturën, 10,4 për qind të pjesëtarëve të saj janë nga pakicat kombëtare ndërsa bashkëpunon në çdo nivel me trupat e KFOR-it në zonën e saj. Organizon trajnime për evakuime në rast të tërmeteve (Gjilanin e ka goditur një tërmet në vitin 2002), KFOR-i shpërndan të gjitha ndihmat e veta humanitare nëpërmjet saj ndërsa UNDP-ja e ka kontraktuar që të rehabilitojë tri rrugë që qojnë në fshatra serbe. Komanda e zonës e shfrytëzon mandatin e saj që të forcojë partneritetet dhe ka zhvilluar aftësitë menaxheriale dhe operacionale.¹²⁷ Zona e Parë paraqet një pamje krejt të kundërt. Komandanti i saj thotë se demobilizimi i vitit 2003 i ka dëmtuar kapacitetet e saja për projekte humanitare: "nuk po bëjmë shumë punë".¹²⁸ Këto dy zona dallojnë edhe në trajnime. Zona e Parë ushtron se si TMK-ja do të bashkëpunonte me SHPK-në nëse një grup i madh kriminal kërcënohet.¹²⁹ Zona e Gjashtë preferon që të mos shpenzojë energji në situatat që janë jashtë mandatit të

¹²⁰ Intervistë e Grupit të Krizave me Gjeneral Brigade Kadri Kastrati, Prishtinë, 9 qershor 2006.

¹²¹ Shih Raportin për Evropë numër 88 të Grupit të Krizave *Çfarë ndodhi me UÇK-në?*, 3 mars 2000, fq. 6-10, për një përshkrim të ndikimit të komandantëve të TMK-së.

¹²² Lushtaku këmbëngul se nuk ka marrë kurrfarë urdhri formal. Intervistë e Grupit të Krizave, Prishtinë, 16 maj 2006. Shih edhe raportin e Grupit të Krizave, *Sfida e tranzicionit*, op.cit.fq.20 për informata shtesë.

¹²³ Intervistë e Grupit të Krizave në Skenderaj, 17 maj 2006.

¹²⁴ Intervistë e Grupit të Krizave me Komandantin e Zonës së Tretë Mbrojtëse të TMK-së, Nazmi Brahimaj, Pejë, 1 qershor 2006.

¹²⁵ Intervistë e Grupit të Krizave, maj 2006.

¹²⁶ KFOR-i do të ofrojë trajnime për TMK-në për demokracinë dhe të drejtat e njeriut; logjistikë, personel dhe menaxhim; menaxhim të financave, analiza të organizatës, media, për zhvillimin e programeve për trajnim; sigurinë e informatave dhe sigurinë fizike; menaxhim të projekteve dhe menaxhim të emergjencave mjekësore.

¹²⁷ Intervistë e Grupit të Krizave me eprorin e TMK-së, Gjeneralin Imri Ilazi, Gjilan, 19 maj 2006.

¹²⁸ Intervistë e Grupit të Krizave, Skenderaj, 17 maj 2006.

¹²⁹ Vizita dhe intervista të Grupit të Krizave në Qendrën për simulime në TRADOC, Prishtinë, 15 maj 2006.

TMK-së dhe përqendrohet në simulimin e reagimeve në fatkeqësitë natyrore dhe krizat tjera të mundshme civile.¹³⁰

Këto dy zona dallojnë edhe në qasjen ndaj gjuhës angleze që është e nevojshme për trajnime të NATO-s dhe bashkëpunim ndërmjet forcave të armatosura. Mundësitë për mësimin e gjuhës angleze në TRADOC janë të kufizuara kështu që Zona e Gjashtë është marrë vesh me shkollat lokale për organizimin e këtyre kurseve.¹³¹ Deri sa eprori me rangun më të lartë që është ofruar nga Zona e Parë për t'u certifikuar për gjuhën angleze ishte një major, në Zonën e Gjashtë praktikisht e tërë hierarkia e Zonës i u nënshtrua testit.¹³² Për të përparuar në forcën e ardhshme, oficerët do të duhet të dinë gjuhën angleze. As zonat tjera nuk qëndrojnë më mirë në këtë aspekt dhe shumica janë më afër Zonës së Parë.

Një TMK e sigur që do të krijohej pas ndonjë vlerësimi profesional do të dukej shumë më ndryshe se sa TMK-ja e formuar në vitin 1999. Komandanti i Zonës së Gjashtë kërkon nga personeli i tij që të ushtrojnë sa më shumë që të kalojnë testet në të ardhmen dhe beson se 90 për qind prej tyre do të kalonin atë.¹³³ Komandantët e dy njëjësive të mëdha, që janë nga Drenica, megjithatë janë të mendimit se gati të gjithë pjesëtarët e tashëm e meritojnë që automatikisht të kalojnë në forcën e ardhshme mbrojtëse.¹³⁴ KFOR-i dhe UNMIK-u i shikojnë këta komandantë si pengesë e zhvillimit të mëtutjeshëm profesional të TMK-së. Ndërkombëtarët i kanë kthyer sytë kah Sylejman Selimi (i cili gjithashtu është nga Drenica) dhe presin që ai t'i shtyjë anash këta. Një tjetër nga kampi tjetër thotë: “Disa njerëz lartë në komandën e TMK-së janë të gatshëm që të na sakrifikojnë neve vetëm për t'ua bërë qejfin ndërkombëtarëve. Nuk do ta pranoj këtë; do të largohem me gjithë ushtarët e mi”.¹³⁵

C. TMK-JA DHE SHOQËRIA KOSOVARE

Në gjysmën e dytë të vitit 1999, TMK-ja e re dukej si një pjesë e mozaikut të gjerë të frontit të UÇK-së që do të dominonte institucionet e Kosovës. Pa e caktuar askush, UÇK-ja kontrollonte administratën e të gjitha komunave përveç atyre në veri të lumit Ibër. Lideri i saj, Thaçi,

kryesonte qeverinë e përkohshme.¹³⁶ Gjenerali Agim Ceku që më vonë u bë kreu i TMK-së, shprehej: “Një pjesë do të bëhet pjesë e policisë, një pjesë do të bëhen pjesë e administratës civile, një pjesë do të bëhen ushtarë të Kosovës si forcë mbrojtëse. Dhe një pjesë tjetër do të formojë një parti politike”.¹³⁷ Marrëveshja për demilitarizim mes NATO-s e UÇK-së thoshte se “bashkësia ndërkombëtare duhet të marrë plotësisht në konsideratë” kontributin e UÇK-së në krizën e fundit, si dhe të konsiderohet përfshirja e pjesëtarëve të UÇK-së në administratë dhe polici.

Veçanërisht në muajt e parë, pjesëtarët e padisiplinuar dhe plot vetëbesim të TMK-së silleshin sikur ata të ishin padrona apo zotërinjtë e ri të Kosovës që mund të bëjnë ligjet e veta. Disa vunë post-bloqe, disa provonin të bënin arrestime dhe ua dorëzonin të kapurit KFOR-it dhe UNMIK-ut. Njerëzit janë dërguar në bazat e TMK-së për t'u marrë në pyetje. Në disa raste, disa romë janë gjetur të vdekur në afërsi të bazave të TMK-së.¹³⁸ Pjesëtarët e TMK-së përpiqeshin të tregonin se janë më të rëndësishëm se sa SHPK-ja që sa po krijohej. Pasi prezenca e Policisë së UNMIK-ut ende ishte e paktë në terren, në pranverën e vitit 2000 ndër ndërkombëtarët qarkullonte ideja e kooptimit të TMK-së në punët e mbajtjes së rendit e ligjit.¹³⁹ Thuhet se TMK-ja ka lëshuar leje për ndërtimin e një restoranti në grykën e Deçanit.¹⁴⁰ Në vitin 2003 dy pjesëtarë të TMK-së janë arrestuar për sulm dhe kidnapim të një civili¹⁴¹ ndërsa policia e UNMIK-ut u desh të intervenonte të nxjerrë nga duart e TMK-së një ekip televiziv rus që ishte ndaluar deri sa po filmonte jashtë kazermës së tyre në të dalë të Prishtinës.¹⁴²

Një epror i KFOR-it thotë se “Gjeneral Çeku më shumë duhej të bënte diplomaci (me eprorët tjerë) se sa t'u jepte

¹³⁰ Intervistë e Grupit të Krizave me Gjeneralin e TMK-së, Imri Ilazi, Gjilan, 19 maj 2006.

¹³¹ Ibid.

¹³² Intervistë e Grupit të Krizave me Shefin e Qendrës së trajnimit kolektiv të TMK-së, Ferizaj, 15 maj 2006.

¹³³ Intervistë e Grupit të Krizave me gjeneralin e TMK-së, Imri Ilazi, Gjilan, 19 maj 2006.

¹³⁴ Intervista të Grupit të Krizave me Nuredin Lushtakun dhe Bashkim Jasharin, 16 e 17 maj 2006.

¹³⁵ Intervistë e Grupit të Krizave, maj 2006.

¹³⁶ Shih Raportin për Evropë të Grupit të Krizave numër 79, *Duke pritur UNMIK-un: Administrata vendore në Kosovë*, 18 tetor 1999.

¹³⁷ “U.S. warns KLA to disarm or lose aid”, (SHBA-ja i tërheq vërejtjen UÇK-së të çarmatoset ose do të humbasë ndihmat) Agjensia e Lajmeve, Associated Press, 30 gusht 1999; shih edhe Raportin për Evropë të Grupit të Krizave numër 88, *Çfarë ndodhi me UÇK-në?*, 3 mars 2000, që ekzaminon degëzimin e pjesëve të UÇK-së në fushat që përmend Çeku, por edhe në krimin e organizuar, gjashtë muaj pas lufte.

¹³⁸ Raporti i Grupit të Krizave *Çfarë ndodhi me UÇK-në?*, op.cit.

¹³⁹ Ibid, fq. 7, 9, 15.

¹⁴⁰ Intervistë e Grupit të Krizave me një zyrtar të UNMIK-ut, dhjetor 2004.

¹⁴¹ Shih: Naser Miftari dhe David Quin, “Duke i mbajtur mbrojtësit nën kontroll”, “Instituti për Raportim në Luftë dhe Paqe”, “Raporti i Krizës së Ballkanit”, 30 qershor 2003. (http://iwpr.gn.apc.org/?apc_state=henibcr2003&l=sq&s=f&o=156839)

¹⁴² Intervistë e Grupit të Krizave me zëdhënësin e policisë së UNMIK-ut, Derek Chappell, fundi i vitit 2003.

urdhra".¹⁴³ Pasi ishte inkuadruar në luftë më vonë, si interlokutor ushtarak profesional mes NATO-s dhe UÇK-së, Çeku solli një imazh të ekzistimit të një komande qendrore si dhe një popullaritet më të madh për TMK-në por nuk kishte forcën që ta bënte ashtu siç dëshironte ai. Ai shpesh u gjend në situata të palakueshme pasi nuk ishte në gjendje të largonte eprorët e padëgjueshëm dhe për shkak të kësaj shpesh ka pësuar bashkëpunimi me KFOR-in dhe UNMIK-un.¹⁴⁴ Ai u desh të përballej edhe me ndërrimet që prapa shpinës së tij i bënin KFOR-i dhe UNMIK-u. Ai qëllonte të ishte jashtë Kosovës në kohë të rënda, siç është shkurti i vitit 2004 kur u arrestua Komandanti i Zonës mbrojtëse në Prizren, Selim Krasniqi, nën akuzat për krime lufte.¹⁴⁵ Dëshira e tij që Inspektorati i TMK-së t'i raportojë Koordinatorit të TMK-së tregon se ai ishte i vetëdijshëm për kufizimet. Edhe pse duket më pak i sigurt dhe është më pak i arsimuar se sa Çeku, komandanti i ri, Sylejman Selimi, ka emër të madh në TMK dhe e di se çfarë ndërrimesh duhet bërë përbrenda që të sigurohet e ardhmja e TMK-së. Në muajt e parë në zyre ai ka bërë ndërrime në personel në Shtab, siç është gradimi i oficerëve nga komunitetet pakicë, gjë që Çeku e kishte më të vështirë ta bënte. Sylejman Selimi, me punën e tij, ka impresionuar KFOR-in dhe UNMIK-un.

Shtatë vite pas krijimit, TMK-ja është bërë organizatë e disiplinuar, që kryen operacione në kuadër të mandatit që ka dhe kjo ka bërë që raporti me shoqërinë kosovare të ndërrojë. Krekosja e UÇK-së është zhdukur. Shumica e shqiptarëve mendojnë se TMK-ja është marrë nëpër këmbë, është përballur me hetime gjyqësore dhe me mandat të kufizuar. Shoqëria po i del krah dhe po e merr në mbrojtje TMK-në duke u munduar ta mbrojtë imazhin e saj nga bashkësia ndërkombëtare skeptike e nganjëherë edhe armiqësore. Në të vërtetë, TMK-ja edhe dallon shumë nga Institucionet e Përkohshme të Vet-Qeverisjes (IPVQ): e parë si e përkorë dhe e disiplinuar në mënyrë spartane, TMK-ja del krejt e kundërt me IPVQ-në që ka reputacionin e të qenit e korruptuar, plëngprishës dhe e paafte. Hulumtues ndërkombëtarë kanë vërejtur se sa më transparente është TMK-ja se sa SHPK-ja.¹⁴⁶ Mediat e shqiptarëve të Kosovës, të gjitha pa dallim, shumë shpesh e kritikojnë SHPK-në por jo edhe TMK-në. Transmetuesi

publik, RTK-ja, e merr me shumë seriozitet këtë detyrë patriotike duke bërë programe dhe video-klipe pompoze për TMK-në.

Anketimet e opinionit publik tregojnë se TMK-ja është organizata më e popullarizuar ndër shumicën shqiptare e kjo po i bën të popullarizuar edhe komandantët e saj. Një anketë e bërë në maj të vitit 2006 jo vetëm që tregonte se ish-komandanti i TMK-së, Agim Çeku, është personi më i popullarizuar, por zbuloi edhe se pasuesi i tij, Sylejman Selimi, ka filluar të bëhet një prej figurave udhëheqëse në Kosovë.¹⁴⁷ Në takimet publike për sigurinë, të organizuara nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) në 31 komunat e Kosovës, në fillim të vitit 2006, TMK-ja ishte tema e dytë më e diskutuar, pas SHPK-së dhe para qeverisë komunale, IPVQ-së, UNMIK-ut dhe të tjerëve. Kur kihet parasysh se qytetarët ndeshen çdo ditë me SHPK-në por më rrallë me TMK-në, kjo tregon se sa e preokupuar mbetet shoqëria me të. Në anën tjetër, në këto takime gati askush nuk ishte i interesuar që të bisedojë për KFOR-in. Në këto takime TMK-ja ka dalë si institucioni më i lavdëruar, por vetëm nga shqiptarët dhe jo-serbët tjerë. Komentet e serbëve ishin që të gjitha negative.¹⁴⁸ SHPK-ja më pak e popullarizuar ishte më në mes.

Pasi Thaçi ka caktuar shumicën e eprorëve në rangjet më të larta, TMK-ja identifikohet me PDK-së ndërsa LDK-ja ishte e rezervuar ndaj saj¹⁴⁹ edhe pse në dy vitet e fundit ky semi-monopol politik është thyer. TMK-ja tani ka marrëdhënie më të zhvilluara me tërë spektrin politik të shqiptarëve të Kosovës. Ish-komandanti i UÇK-së e pastaj edhe i një zone mbrojtëse të TMK-së, Ramush Haradinaj, i zbehu këto bindje pasi lidhi koalicionin qeveritar me LDK-në, ndërsa tani që të njëjtën e bëri edhe Çeku, shumë pjesëtarë të TMK-së presin që ai të punojë edhe më shumë për ta. Selimi u distancua nga PDK-ja në janar të vitit 2005 në një fejtון në një gazetë¹⁵⁰ ndërsa në prill 2006 pranoi që të fotografohet duke e lexuar gazetën e LDK-së *Bota Sot*.¹⁵¹ Kryetari Sejdiu i LDK-së gjithashtu ka ndihmuar që të shërohen plagët e vjetra. Menjëherë pasi mori postin e kryetarit, i bëri një vizitë

¹⁴³ Intervistë e Grupit të Krizave, Prishtinë, shkurt 2005.

¹⁴⁴ Thuhet se Çeku kishte kërkuar nga PSSP-ja Holkeri që të shkarkojë një epror të TMK-së, që ishte kapur nga policia duke mbajtur një armë dhe i veshur në rroba civile në pjesën veriore të Mitrovicës, në nëntor 2003; në vend të kësaj, Holkeri e përfshiu atë në listën e 12 pjesëtarëve që qenë suspenduar për gjashtë muaj, në dhjetor 2003, e që më pas ishin rikthyer në postet e tyre. Intervistë e Grupit të Krizave me një zyrtar ndërkombëtar, Prishtinë, 12 dhjetor 2003.

¹⁴⁵ Shih raportin e Grupit të Krizave, *Kolapsi në Kosovë*, 22 prill 2004, fq.9.

¹⁴⁶ Intervistë e Grupit të Krizave, maj 2006.

¹⁴⁷ Me pesëshen si notën më të lartë, kryeministri Çeku mori notën 4,18, kryetari Sejdiu 4,16 ndërsa Selimi 3,83, pak më tepër se sa zëvendëskryeministri Haziri e shumë më shumë se sa liderët e opozitës, Thaçi e Surroi. KUMT Consulting, 2 qershor 2006.

¹⁴⁸ Intervistë e Grupit të Krizave me sekretariatit e ISSR, Prishtinë, 8 maj 2006.

¹⁴⁹ Shih raportin e Grupit të Krizave, *Kosova pas Haradinajt*, op.cit.fq. 17-22, për një shqyrtim të marrëdhënieve mes PDK-së, Drenicës dhe veteranëve të UÇK-së.

¹⁵⁰ Ibid, fq. 20.

¹⁵¹ "TMK-ja do të mbetet ushtri e gjithë qytetarëve të Kosovës", 21 prill 2006.

kompleksit memorial të familjes Jashari në Prekaz,¹⁵² një gjë të cilën Rugova nuk e ka bërë kurrë. Garda ceremoniale e TMK-së bëri paradë për kryetarin Sejdiu më 24 maj 2006 në shënimin e “Ditës së Kryetarit” por edhe pas kthimit të tij nga udhëtimi në SHBA në qershor.

Edhe pse TMK-ja është duke mësuar që të jetë apolitike, kjo nuk do të thotë që kanë ndërruar edhe raportet mes pjesëtarëve të saj. Ndër pjesëtarët e saj vetëm një numër i vogël janë ish-pjesëtarë të Forcave të Armatosura të Republikës së Kosovës (FARK) që gjatë luftës herë i bënin konkurrencë e herë e ndihmonin UÇK-në.¹⁵³ LDK-ja do të mirëpriste një ndërrim të personelit të TMK-së. Në vitin 2002 thuhet se kishte propozuar që TMK-ja të reflektojë më mirë përkrahjen prej 47 për qind të elektoratit për LDK-në por nuk ka bërë presion për t'u realizuar kjo. LDK-ja është e vetëdijshme se kjo do të mund të shkaktojë tensione me PDK-në e madje edhe dhunë. Duke reflektuar bindjen e pjesës më të madhe të bashkësisë ndërkombëtare për TMK-në, një diplomat u shpreh se “ajo nuk paraqet shoqërinë”.¹⁵⁴ Megjithatë, ajo bën një punë të mirë në mbajtjen nën vete të elementeve më radikale të shoqërisë së shqiptarëve të Kosovës. Por, pasi ndikimi i Drenicës do të pësojë më së shumti gjatë reformave në TMK, është e mundur që kjo harmoni nuk do të zgjasë shumë. Pasi PDK-ja rezistoi reformat universitare, të cilat larguan nga postet udhëheqëse disa akademikë mediokër të cilët ishin të afërt me të, ajo njësoj do të mund të kundërshtonte largimin komandantëve të Drenicës në TMK edhe pse profesionalizmi i tyre mund të vihet në pikëpyetje.

Eprorët, profesionalizmi i të cilëve mund të vihet në pikëpyetje, e kanë shfrytëzuar popullaritetin e TMK-së që të ruajnë postet e tyre por në këtë proces edhe ata vet janë pjekur. Në vatrat e militantëve të UÇK-së si Drenica e Deçani, TMK-ja ushtron një ndikim stabilizues e zbutës në gjeneratën e të rinjve që nuk patën rast të jenë në UÇK. Për më tepër, shumë nga personalitetet kontroverse të UÇK-së, siç janë Abdyl Mushkolaj në Deçan¹⁵⁵ dhe Sami

Lushtaku në Drenicë¹⁵⁶ më nuk janë në TMK. TMK e sheh veten si ndërmjetës mes shoqërisë dhe prezencës ndërkombëtare. Një manifestim i skajshëm i kësaj ishte plani që TMK-ja të jetë pajtimtar mes protestuesve dhe UNMIK-ut e KFOR-it në Pejë në vitin 2005, përfshirë këtu edhe mbrojtjen e fshatrave dhe kishave serbe.¹⁵⁷

Përveç atëherë kur nuk ka lejuar KFOR-i, komandantët e TMK-së janë munduar ta qetësojnë turmën gjatë trazirave të marsit 2004. Komandanti i Zonës Mbrojtëse të Drenicës, Bashkim Jashari, nuk ka lejuar të marshohet në dy fshatrat serbe. Në Gjilan dhe Ferizaj TMK-ja ishte më pak e suksesshme gjatë trazirave por më pas qe caktuar nga KFOR-i amerikan që të ruajë kishat serbe në Gjilan dhe të patrullojë bashkë me trupat amerikane. Prestigji i TMK-së në Dukagjin e Drenicë i ka dhënë mjaft vetëbesim sa të kërkojë disa herë nga UNMIK-u dhe KFOR-i që t'i lejohet të mbrojnë kishat dhe manastiret serbe. Kjo të kujton traditën e denjë për respekt të shqiptarëve që të mbrohen manastiret serbe në Kosovë,¹⁵⁸ edhe pse ka disa të tjerë që këtë traditë e shohin më tepër si reket i stilit mafioz.¹⁵⁹

Komunitetet pakicë që jetojnë të izoluara e që pranojnë mbrojtjen e TMK-së përfitojnë nivel më të lartë të sigurisë. TMK-së nuk i lejohen angazhime të drejtpërdrejta në çështjet e sigurisë por suksesi i një pilot-projekti që nisi në prill të vitit 2005 për ruajtjen e shtëpive të rindërtuara të ashkalinjve në Vushtri, e bindi UNMIK-un që në janar të vitit 2006 të shtojë në mandatin e TMK-së edhe “monitorimin e shtëpive të rindërtuara e të pabanuara të komuniteteve pakicë”.¹⁶⁰ Në fillim të vitit 2001, një mësues ashkali i ftoi pjesëtarët e TMK-së që të qëndrojnë natën në lagjen e tij që të pengojnë sulmet e shqiptarëve të tjerë. Aty ku patrullat e KFOR-it nuk ishin treguar efikase, TMK-ja solli përmirësim. Por, kur pjesëtarët e TMK-së hoqën dorë nga kjo detyrë nga frika se do të kenë probleme me KFOR-in, sulmet rifilluan.¹⁶¹ Një efekt anësor i angazhimit të rregullt të TMK-së në

¹⁵² Ku udhëheqësi i UÇK-së, Adem Jashari, bëri qëndresën e fundit kundër forcave serbe në mars 1998. Ai së bashku me shumë anëtarë të familjes së gjerë dhe bashkëfshatarë të tjerë qenë vrarë dhe kjo u bë shkas për kryengritje të gjerë. Shtëpitë e shkatërruara janë ruajtur; familja Jashari dhe shtëpia e tyre janë bërë objekte nderi e respekti për shqiptarët.

¹⁵³ Për një shpjegim të mirë të paraqitjes së UÇK-së dhe FARK-ut shih (në gjuhën angleze): “Wag the Dog: The Mobilisation and the Demobilisation of the Kosovo Liberation Army”, Bonn International Centre for Conversion, Brief 20, Friedrich Naumann Stiftung, 2001. PDK-ja e Hashim Thaçit është pasardhësj kryesore politike e UÇK-së; FARK-u ishte i afërt me LDK-në, partinë e të ndjerit President Rugova.

¹⁵⁴ Intervistë e Grupit të Krizave me një zyrtar të BE-së, 31 gusht 2005.

¹⁵⁵ Raporti i Grupit të Krizave, *Kosova pas Haradinajt*, op.cit.

¹⁵⁶ Ibid dhe raporti i Grupit të Krizave, *Çfarë ndodhi me UÇK-në?*, op.cit..

¹⁵⁷ Raporti i Grupit të Krizave, *Kosova pas Haradinajt*, op.cit. fq.9..

¹⁵⁸ Shih: Valon A. Sylja, “Rojet e kishave”, *Express*, 11 qershor 2006; Mark Krasniqi, “Manastirske vojvode u Kosovsko-Metohiskoj oblasti”, *Glasnik muzeja Kosova i Metohije*, 3 (Prishtinë, 1958), fq. 107-128.

¹⁵⁹ Intervistë e Grupit të Krizave me një prift ortodoks, mars 2006; Milutin Gjuriçiq, “*Obicaji i verovanja Albanaca*” (Beograd, 1994).

¹⁶⁰ Rregullorja 2006/3 e UNMIK-ut amandamenton Rregulloren 1999/8 të UNMIK-ut mbi “Themelimin e Trupave Mbrojtëse të Kosovës”.

¹⁶¹ Intervistë e Grupit të Krizave, Ferizaj, prill 2001. Shih edhe (në gjuhën angleze): “Denied a Future? The Right to Education of Roma/Gypsy children in Kosovo”, *Save the Children*, 2001, fq.10.

projektet për kthim në fshatrat serbe të Dukagjinit në vitin 2006, ku ofronin ndihmë mjekësore dhe ndihma tjera humanitare, ka qenë ulja e numrit të krimeve. Vjedhjet në fshatin Sigë u ndalën sa po TMK-ja u angazhua edhe atje.¹⁶²

Pa marrë parasysh se çfarë imazhi të shoqërisë shqiptare paraqet TMK-ja dhe pa marrë parasysh ndihmat që u ka ofruar komuniteteve të vogla e të izoluara serbe, për shumicën e serbëve ajo ende paraqet armikun, ajo promovon simbolet shqiptare, duke shënuar dhe duke u mishëruar me UÇK-në dhe përbëhet nga njerëz që ka gjasa të kenë marrë pjesë në sulmet kundër serbëve dhe pakicave tjera gjatë dhe pas luftës. Në vitin 2004, politikania serbe nga Graçanica, Rada Trajković, pat deklaruar për TMK-në, se po hapte istikame për qëllime të errëta rreth fshatrave serbe.¹⁶³ Në vitin 2005, një zyrtar komunal serb ka refuzuar ofertën që TMK-ja të ndihmojë në rindërtim duke i thënë një eprori amerikan se “TMK-ja është për ne njësoj si Al-Qaeda (Al-Kaida) për ju”.¹⁶⁴ Disa serbë janë të gatshëm të tolerojnë TMK-në nëse ajo mbetet forcë mbrojtëse civile, por vetëm një grusht serbësh të marginalizuar, kryesisht në jug-lindje, janë të gatshëm që t’i bashkohen asaj. TMK-ja ka edhe Zonën e Mitrovicës por ajo nuk ka kurrfarë përfaqësimi në veri të lumit Ibër. Kah fundi i vitit 1999, një politikan serb i Kosovës që larguar nga Këshilli i Përkohshëm Administrativ i UNMIK-ut në shenjë proteste për formimin e TMK-së,¹⁶⁵ ndërsa në veri të Mitrovicës formimi i Rojeve të Urës ishte njëfarë reagimi ndaj kësaj.¹⁶⁶

D. MARRËDHËNIET ME BASHKËSINË NDËRKOMBËTARE

Për shkak të rrënjëve të saj por edhe për shkak të synimit përfundimtar që ka, çfarëdo keqbërje e ndonjë pjesëtari të TMK-së ka tërhequr vëmendjen e bashkësisë ndërkombëtare shumë më shumë se sa kur kjo ndodhë në institucionet e krijuara nga UNMIK-u, siç është SHPK-ja,¹⁶⁷ edhe pse policia dhe shërbimi doganor janë më të

korruptuara dhe bashkëpunojnë më tepër me krimin e organizuar. Në fakt, deri sa në SHPK po shtohen problemet disiplinore, në TMK këto po pakohen. Me kalimin e SHPK-së në duart e vendorëve, eprorët e saj kanë frikë se ajo gjithnjë e më shumë do të politizohet. Në anën tjetër, pjesa më e madhe në TMK po bëjnë çmos që të rijnë sa më larg politikës. Pasi SHPK-ja ka marrë mbi vete shumë nga rolet e lakmueshme të TMK-së, kjo e fundit u desh që të fillojë të kërkojë një identitet të ri. Ajo është e vetëdijshme se nuk mund të marrë atë që dëshiron duke krijuar realitet tjetër në terren. Ajo ka nevojë për përkrahje nga jashtë. Ajo ka nevojë për NATO-në që të kenë partneritet me të.

Në vitin 1999, marrëdhëniet e UNMIK-ut e KFOR-it me TMK-në filluan me një ndjenjë të besimit dhe të qëllimit të përbashkët. Shefi i UNMIK-ut Bernard Kouchner dhe COMKFOR-i Mike Jackson u munduan të krijojnë sa më shumë hapësirë për UÇK-në në kuadër të Rezolutës 1244. Por, që nga viti 2000, TMK-ja hyri në një periudhë kur ajo shihej si problem ndërsa pjesëtarë të saj vënin lidhje me kryengritjet e shqiptarëve në Serbinë jugore (2000) dhe në Maqedoni (2001), si dhe me dhunën politike në Kosovë dhe me krimin e organizuar. Qysh në mars të vitit 2000 mediat ndërkombëtare raportonin se një vlerësim i brendshëm i OKB-së i lidhte pjesëtarët e TMK-së me “aktivitete kriminale – vrasje, keqtrajtim/torturë, sjellje të paligjshme sikur të ishte polici, për keqpërdorim të detyrës, frikësim, shkelje të neutralitetit politik si dhe për përdorimin e gjuhës së urrejtjes.”¹⁶⁸

Por, kjo nuk i preku marrëdhëniet me KFOR-in dhe UNMIK-un. KFOR-i mbajti oficerët e ndërlidhjes në Zonat e mbrojtjes të TMK-së ndërsa trajnuesit e IOM-it vazhduan të punojnë me të, ndërsa edhe pse UNMIK-u mbetej përgjegjës për TMK-në kishte pak përzierje të drejtpërdrejtë në punët e saj. Vetëm në shtator të vitit 2002, u themelua Zyra e Koordinatorit të TMK-së, e cila do të bënte koordinimin e angazhimit rreth TMK-së të UNMIK-ut, KFOR-it dhe zyrave diplomatike të pesë vendeve të NATO-s që përbëjnë “Quint”-in në Grupin e Kontaktit. Koordinatorin u bë edhe këshilltar dhe mentor i shefit të TMK-së, Çekut. Në pranverë të vitit 2003, kësaj zyre i u shtua edhe Grupi për Zhvillim të TMK-së, i cili, për çdo dy muaj, i ul bashkë PSSP-në, COMFOR-in, komandantin e TMK-së, Koordinatorin e TMK-së dhe zyrat e Quintit.

¹⁶² Intervistë e Grupit të Krizave me një burim në SHPK, Pejë, 1 qershor 2006.

¹⁶³ D. Damjanović, “Rovovi oko enklava?”, *Vecernje Novosti*, 22 nëntor 2004.

¹⁶⁴ Intervistë e Grupit të Krizave, 24 nëntor 2005.

¹⁶⁵ Shih raportin e Grupit të Krizave, *Çfarë ndodhi me UÇK-në?* op.cit. fq.6.

¹⁶⁶ Konferenca për gazetarë e PSSP-së Bernard Kouchner dhe COMKFOR-it Mike Jackson për krijimin e TMK-së, 21 shtator 1999.

¹⁶⁷ Në shtator 2005 një polic i SHPK-së dhe vëllai i tij janë vrarë nga shpërthimi i një bombe në veturën e tyre, në Viti. Sipas hetimeve bomba ishte e tyre dhe për cak kishin një nga dy shtëpitë serbe afër të cilave ishin parkuar ata natë. Por, ky

rast shpejt u u harrua, për dallim nga vëmendja që i u kushtua TMK-së dhe shpërthimit në urën e Llozistës.

¹⁶⁸ Shih (në gjuhën angleze): “Revealed: UN-backed unit’s reign of terror”, *The Observer* (Mbretëri e Bashkuar), 12 mars 2000. Shih edhe raportin e Grupit të Krizave *Çfarë ndodhi me UÇK-në?*, op. cit.

Vëmendja e jashtme në krimet e luftës dhe kryengritjet në vendet fqinje filluan që të ndërrojnë pikëpamjet për TMK-në. Në korrik 2001 një urdhër ekzekutiv ua ndalonte 20 shqiptarëve të Kosovës që ishin drejtpërdrejtë të lidhur me konfliktin në Maqedoni dhe në Serbinë jugore si dhe krime të luftës, që të hyjnë apo të bëjnë biznes në SHBA. Në listë ishin katër gjeneralë të TMK-së, përfshirë këtu edhe Daut Haradinajn dhe Rexhep Selimin. Daut Haradinaj, vëlla i kryeministrit të Kosovës të akuzuar më herët për krime lufte, më pas ishte arrestuar në Kosovë për krime lufte. Selimi dha dorëheqje në vitin 2003, pasi që i suspenduar për gati dy vite. Eprorë tjerë të TMK-së, të cilët janë akuzuar për krime lufte, janë edhe Komandanti i Zonës Mbrojtëse me seli në Prizren, Selim Krasniqi dhe dy ushtarë të tij, të arrestuar në shkurt 2004, dhe zyrtari për ndërlidhje, koloneli Lah Ibrahimaj, në mars 2005.

Konfliktet e përgjakshme të kohës së UÇK-së që u trashëguan edhe në TMK filluan të preokupojnë sistemin gjyqësor të UNMIK-ut. Në maj të vitit 2000, Ekrem Rexha, i njohur edhe si Komandant Drini, një komandant i shquar i UÇK-së dhe epror i lartë i TMK-së është vrarë në Prizren ndërsa për vrasjen e tij u akuzua, u gjykua, u lirua dhe përsëri u dërgua në gjykim një komandant tjetër i TMK-së. Në tërë Kosovën ka pasur një valë të dhunës kundër ish-luftëtarëve të FARK-ut. Në tetor 2003 Çeku i suspendoi për dy muaj shtatë pjesëtarë të TMK-së që dyshohej se kanë organizuar komplotin për vrasjen e një epror tjetër të lartë të TMK-së. Ai pat shpresuar se hetimet e policisë do ta largojnë këtë çështje nga duart e tij por kur hetimet nuk dhanë rezultate, ai i ktheu ata në detyrë në dhjetor 2003, vetëm dy ditë para se UNMIK-u dhe KFOR-i t'i futnin ata në një listë të dymbëdhjetë pjesëtarëve që ai i suspendoi për gjashtë muaj.¹⁶⁹ Hetuesit e policisë nuk gjetën dëshmi të mjaftueshme dhe që të gjithë u kthyen në vendet e tyre në mesin e vitit 2004. Në prill të vitit 2004, pjesëtari i TMK-së Shaqir Krasniqi është vrarë në afërsi të Klinës. Ai kishte zemëruar kolegët nga ish-FARK-u duke kremtuar vrasjen e një komandanti të FARK-ut një vit më herët.¹⁷⁰

Por ajo që më së shumti dëmtoi marrëdhëniet mes KFOR-it e UNMIK-ut në një anë dhe TMK-së në anën tjetër janë dyshimet për involvim të pjesëtarëve të TMK-së në krimin e organizuar e sidomos dyshimet për involvim në sulmet terroriste kundër serbëve.¹⁷¹ Mbi 250 pjesëtarë janë dëbuar nga forca mes viteve 2001 dhe

2003.¹⁷² Bombardimi i autobusit të Nish-Ekspresit në janar 2002, ishte i ndërlidhur me pjesëtarë të TMK-së. Një zëdhënës rajonal i TMK-së, Hamzë Behrami, ishte një nga ata që e hodhi vetën në ajër në përpjekjen e dështuar të Armatës Kombëtare Shqiptare (AKSH)¹⁷³ që të hedhë në ajër urën hekurudhore në Llozistë në veri të Mitrovicës, në prill 2003.¹⁷⁴ Kjo më në fund tërhoqi vëmendjen e UNMIK-ut dhe KFOR-it që përkohësisht suspenduan trajnimet jashtë vendit. KFOR-i filloi inspektimin e bazave të TMK-së me një intensitet të shtuar dhe mungesat pa arsye shënuan rënie të menjëhershme. Çekut i u dha një muaj që të japë emrat e oficerëve të TMK-që që ishin të involvuar në aktivitete dubioze dhe të dyshimta. Ai e dha vetëm një emër por thuhet se ai dërgoi një mesazh të fuqishëm brenda forcës që në TMK nuk ka vend për AKSH-në. Rreth 70 oficerë dhanë dorëheqje; KFOR-i hetoi edhe 54 të tjerë. Bazuar në vlerësimet e inteligjencës rekomandoi që edhe gjashtëmbëdhjetë apo tetëmbëdhjetë të tjerë të largohen nga organizata, ndërsa e tërë kjo në fund rezultoi me suspendimin e lartpërmendur të 12 pjesëtarëve.¹⁷⁵

Ky episod dobësoi autoritetin e Çekut dhe la KFOR-in të hidhëruar me paaftësinë e TMK-së që vet të pastrojë rangjet e veta. Kjo edhe hodhi dritë në të bazuarit jofunksional në zgjidhjet legaliste në një ambient me institucione që nuk mund të bëjnë këtë. Suspendimet u kritikuan nga Ombudspersoni si arbitrare. Shërbimi i zbulimit i KFOR-it nuk e ndihmoi policinë që të kompletojë paditë kundër oficerëve të suspenduar. Edhe pse do të duhej të kishin pushtet absolut në Kosovë, KFOR-i dhe UNMIK-u ia kishin lidhur duart vetvetes.

Komandantët e KFOR-t që shërbyen mes shtatorit 2002 dhe shtatorit 2004, gjenerali Mini dhe gjenerali Kammerhoff, nuk e donin TMK-së.¹⁷⁶ Mini, i cili mendonte të shpërbënte atë dhe ta riorganizojë si organizatë civile, më 2003 tërhoqi këshilltarët e KFOR-it nga komandat e zonave mbrojtëse. Trazirat e marsit 2004

¹⁷² Shih (në gjuhën angleze): Artan Mustafa and Jeta Xharra, "Kosovo officers under investigation", Instituti për Raportim në Luftë e Paqe, Raporti për Krizat në Ballkan, 11 dhjetor 2003. (http://iwpr.gn.apc.org/?apc_state=hsqfbc157183&l=en&s=f&o=157185).

¹⁷³ Ushtri guerile "fantazmë" me agjendë gjithë-shqiptare. Për një përshkrim të ngritjes dhe rënies së AKSH-së, shih Raportin për Evropë të Grupit të Krizave numër 153, *Pan-shqiptarizmi: Sa në të vërtet e kërcënon stabilitetin në Ballkan?*, 25 shkurt 2004, fq. 7-10.

¹⁷⁴ Jeta Xharra, "Kosovë: Rritet kërcënimi nga AKSH-ja", Instituti për Raportim në Luftë dhe Paqe, Raporti për Krizat në Ballkan, 16 maj 2003 (http://iwpr.gn.apc.org/?apc_state=henfbc157185&l=sq&s=f&o=157183).

¹⁷⁵ Intervistë e Grupit të Krizave me një zyrtar ndërkombëtar, Prishtinë, shtator 2003.

¹⁷⁶ Intervista të Grupit të Krizave me eprorë dhe zyrtarë, 2003-2005.

¹⁶⁹ Intervistë e Grupit të Krizave me një zyrtar ndërkombëtar, Prishtinë, dhjetor 2003.

¹⁷⁰ Shih raportin e Grupit të Krizave, *Kosova pas Haradinajt*, op.cit. fq.10-11, për informata shtesë për komandantin e FARK-ut, Tahir Zemaj.

¹⁷¹ Shih raportin e Grupit të Krizave *Kolapsi në Kosovë*, op.cit. fq.8-9, për problemet e TMK-së në vitin 2003.

erdhën në një kohë të mosbesimit të ndërsjellë. Brigada qendrore e KFOR-it qartazi e shihte TMK-në si një krah potencial i turmës së rebeluar¹⁷⁷ dhe e mbajti atë të mbyllur në kazerma. Ishte vetëm KFOR-i amerikan ai që i përdori të qetësojë turmën dhe të stabilizojë gjendjen.¹⁷⁸

Që nga trazirat, UNMIK-u dhe KFOR-i gradualisht e kanë ndërruar bindjen për TMK-në. Një zyrtar i KFOR-it e përmbledh këtë: “TMK-ja është e vetmja organizatë që nuk dështoi në mars të vitit 2004... vetëm pas kësaj filluam të kuptojmë rolin e TMK-së në Kosovë”. Trazirat ishin “alarm” – thotë ai – për ata që më parë mendonin se Kosova e vogël nuk ka nevojë për një ushtri.¹⁷⁹ Në fillim UNMIK-u priste që Standardi Tetë të plotësohet më së paku, por, siç u tha më herët, rezultatet kanë qenë më se inkurajuese. Afrimi u bë edhe më i lehtë pas rreshtimit të UNMIK-ut, e me këtë edhe të Grupit të Kontaktit, përkrah ambicieve të shqiptarëve të Kosovës për pavarësi.

TMK-ja, si edhe shumë shqiptarë të Kosovës, e shohin organizatën si faktor të stabilitetit dhe habiten se si bashkësia ndërkombëtare nuk e ka kuptuar këtë dhe nuk e ka përkrahur. Ish-komandanti Çeku shprehet kështu për pikëpamjet gati të kundërta: “Dikush nga ne është duke gabuar e unë besoj se kjo është bashkësia ndërkombëtare”.¹⁸⁰ Ai shton se UNMIK-u dhe KFOR-i nuk e kanë lejuar TMK-në që të duket mirë. Eprorët e TMK-së thonë se organizata e tyre nuk ka marrë ndihmën e njëjtë të niveleve të larta në përpjekjet për rekrutimin e serbëve apo për të operuar në veri të Ibrit, ashtu siç ndodhë me SHPK-në.¹⁸¹ Reklammat e KFOR-it promovojnë SHPK-në por jo edhe TMK-në.

TMK-ja paraqet vazhdimësi të UÇK-së ndër institucionet zyrtare të Kosovës. Kjo ka një efekt stabilizues. Megjithatë, ekziston dallimi në mes garantimit të sigurisë në një afat të shkurtër dhe themelimit të strukturave që do të garantojnë sigurinë në të ardhmen. Ndërkombëtarët që punojnë në këto dy çështje ndërrohen shpesh dhe TMK-ja merr sinjale kontradiktore nga ta, si brenda ashtu edhe jashtë Kosovës.

Brenda Kosovës, UNMIK-u dhe KFOR-i heshtur po i japin TMK-së sinjale në bazë të së cilave mund të fitojë përshtypjen se mund të vazhdojë drejt synimit të saj ushtarak. Edhe mandatin e saj UNMIK-u dhe KFOR-i tani e interpretojnë më butë dhe po angazhohen më tepër në shtimin e kapaciteteve të saj. Në janar 2006, UNMIK-u e amandamentoi rregulloren e TMK-së që të lejojë

pjesëtarë të zgjedhur që të ndjekin kurse për çështjet e sigurisë, duke i mundësuar KFOR-it amerikan që të mbajë trajnime të plota për oficerë të karrierës. Tash së voni, çdo dërgatë (Task-forcë) ushtarake e KFOR-it ka filluar të inkurajohet që të ofrojë trajnime për zonën mbrojtëse të TMK-së në zonën e tyre.¹⁸² Pasi kishte kërkuar që nga viti 2002, më në fund në vitin 2006 TMK-ja u lejua që të bëjë trajnime të sigurimit të armatimit për personelin që ruan bazat e saj dhe mban armë të mëdha. TV reklama e TMK-së që në prill e maj 2006 ftonte kadetët e ri, e quante atë ushtri të ardhshme të Kosovës ndërsa komandantët e zonave tregojnë për diskutime më të hapura me kolegët e tyre nga KFOR-i për mundësitë që kjo të ndodhë.¹⁸³ Por, në diskutimet e brendshme mes UNMIK-ut e KFOR-it, propozimet e tilla aventureske hasin në armiçësi.¹⁸⁴ KFOR-i dhe UNMIK-u e dinë se vendimi përfundimtar për TMK-në nuk do të merret nga ta. E tëra që mund të bëjnë është që heshtur ta ndihmojnë TMK-në që të bëhet një kandidat më i pranueshëm. Shqetësimi i tyre kryesor është që të mbahet stabiliteti gjatë mandatit të tashëm të tyre dhe hedhja e thërrmijave nga sofa për TMK-në është pjesë e kësaj.

Jashtë Kosovës, për shumicën TMK-ja është një pengesë drejt krijimit të një territori dhe identiteti funksional e multi-etnik. Trashëgimia e UÇK-së i largon tutje serbët dhe konsolidimi i saj do të nënkuptonte njohjen ndërkombëtare të fitores së shqiptarëve në luftë, që do të bënte intervenimin ndërkombëtar të dukej i njëanshëm. A ka qenë bashkësia ndërkombëtare arbitër neutral por efikas apo ka qenë aleate e UÇK-së? A mundet Kosova të pohojë se është çliruar vetë apo e ardhmja e saj i është dhuruar nga bashkësia ndërkombëtare? TMK-ja është aq e paqartë për ata që janë në favor të ndërtimit të një identiteti mbrojtës të Kosovës, siç janë Mbretëria e Bashkuar, SHBA-ja e NATO, sa edhe për ata që janë në favor të shpërbërjes së saj, siç janë Gjermania e Rusia.

Tani që bashkësia ndërkombëtare është përcaktuar për shtetësinë e Kosovës, në vitet e ardhshme polemikat me shqiptarët e Kosovës do të sillen rreth identitetit të këtij shteti. Që Kosova të bëhet sa më multi-etnike që të jetë e mundur janë të nevojshëm hapa të matur. TMK-ja e sotme ende përbëhet nga shumë elemente të njëanshme që nuk ndihmojnë ndërtimin e një Kosove për të gjithë: vazhdimësia e UÇK-së, simbolet shqiptare, ceremonitë komemorative për luftën e UÇK-së dhe kulti i Adem

¹⁷⁷ Diskutime të Grupit të Krizave me eprorë të Brigadës Shumë-Kombëshe Qendër, 18 mars 2004.

¹⁷⁸ Raporti i Grupit të Krizave, *Kolapsi në Kosovë*, op.cit.

¹⁷⁹ Intervistë e Grupit të Krizave, mars 2006.

¹⁸⁰ Intervistë e Grupit të Krizave, Prishtinë, 23 shtator 2003.

¹⁸¹ Intervista të Grupit të Krizave, maj 2006.

¹⁸² Tani ata po garojnë “Cili të na trajnoj neve”. Intervistë e Grupit të Krizave në TRADOC, Prishtinë, 15 maj 2006. Një ekip nga Komanda jugore e NATO-s në Napoli po ndihmon TMK-në dhe Zyrën e koordinitorit që të planifikojnë trajnimet.

¹⁸³ “Më nuk po zemërohen edhe aq shumë”, intervista të Grupit të Krizave, 16-17 maj 2006.

¹⁸⁴ Intervista të Grupit të Krizave me zyrtarë ndërkombëtarë, Prishtinë, maj 2006.

Jasharit. Por kjo është pasojë edhe e neglizhencës me të cilën është trajtuar kjo organizatë. KFOR-i në bashkëpunimin e vet me TMK-në është fokusuar në çështjet praktike e jo në simbole: Zona e gjashtë mbrojtëse ka ndërruar katër herë komandantin deri sa më 2003 nuk u gjet një të cilin KFOR-i amerikan e cilësoi si të besueshëm. Bashkëpunimi më i vogël i KFOR-it francez e ka lënë të vetmuar Zonën e Parë Mbrojtëse dhe komandantin saj të ri, të papërvojë dhe jo veçanërisht të aftë që vjen nga familja simbol Jashari.

Përpjekjeve graduale për transformimin e TMK-së nuk u është dhënë rasti. Disa ndërkombëtarë besojnë se TMK-ja duhet të fajësojë veten: “Çeku nuk mundi të hiqte qafe ‘djelmohat e këqij’. Me ata në TMK, ajo nuk mund të presë të bëhet organizatë ushtarake shtetërore kredibile... Jemi munduar ta bëjmë TMK-në të filtrojë rangjet e saja. Ajo nuk e ka bërë këtë. Disa vende kanë provuar të ndihmojnë por TMK-ja nuk ka pranuar”.¹⁸⁵ TMK-ja ka hezitur të transformohet për deri sa nuk e ka të qartë se kah po shkon. Transformimi që ka pasur në mend Gjenerali Mini do t’ia kishte zhduruar çfarëdo të ardhme ushtarake. Pastaj, përvoja e TMK-së me demobilizimin ka qenë edhe më e keqe. Programi i viteve 1999-2001 i menaxhuar nga IOM-i ka ofruar një varg trajnimesh dhe mundësisht për të filluar biznese për të ndihmuar kthimin në jetën civile të gati 15.000 pjesëtarëve të UÇK-së por shumica prej tyre përfunduan si të papunë. Demobilizimi i 2.000 rezervistëve ishte edhe më brutal: “Ata thjeshtë u hodhën në rrugë... Si komandantë të njësisve ne komprometuan veten tonë; u desh t’i gënjejmë se do të integroheshin në proceset e ardhshme”.¹⁸⁶ Pjesëtarët më të vjetër të TMK-së mund të presin vetëm 40 Euro në muaj si pension kur t’i mbushin 65 vjet.

Në çështjen e transformimit, TMK-ja dhe bashkësia ndërkombëtare janë të ngujuara në qarkun vicioz të mosbesimit dhe keqkuptimit. TMK-ja do të mbrojë rangjet e veta të fryra deri atëherë kur të shohë plane dhe një perspektivë që mund ta besojë. Ajo nuk ka zbatuar skemat për vlerësimin e profesionalizmit të oficerëve të saj por shumë nga strategët e saj e mirëpresin transformimin si një rast për të zbatuar testimin si filtër nëpër të cilin “nuk do të kalojnë më shumë se 50 për qind”.¹⁸⁷ “Nuk dëshirojmë të trajtohemi keq... Reformat duhet të jenë të kujdesshme dhe të sigurta e jo masive e të përnjëhershme”, thotë një oficer i TMK-që që njëherë e

ka “hëngër”.¹⁸⁸ Një zyrtar ndërkombëtar pajtohet se vendet donatore nuk përtojnë të flasin për ndihma për çështjet e sigurisë por rrallë edhe e realizojnë këtë.¹⁸⁹ OKB-ja e pranon se: “vazhdimisht... demobilizimit nuk i jepet prioritet nga ana e donatorëve”.¹⁹⁰ Një raport i OKB-së i marsit 2006, flet për:

[dështimin] që TMK-ja të vihet në matricën më të gjerë të zhvillimit të Kosovës. Ajo mbahet larg nga kosovarët dhe nga komuniteti i zhvillimit. Për shkak të kësaj është pothuajse e pamundur të ketë zhvillim serioz dhe reforma në TMK. Resurset politike dhe financiare nuk janë në dispozicion sepse këta janë të përjashtuar nga procesi i vendimmarrjes sa i përket fatit të TMK-së.¹⁹¹

¹⁸⁵ Intervistë e Grupit të Krizave me një zyrtar të lartë ndërkombëtar, Prishtinë, 24 maj 2006.

¹⁸⁶ Intervistë e Grupit të Krizave me një oficer të TMK-së, Gjakovë, 16 maj 2006.

¹⁸⁷ Intervistë e Grupit të Krizave me një epror të TMK-së, 25 maj 2006.

¹⁸⁸ Intervistë e Grupit të Krizave me një oficer të TMK-së, Gjakovë, 16 maj 2006.

¹⁸⁹ Intervistë e Grupit të Krizave, Prishtinë, 30 maj 2006.

¹⁹⁰ Shih (në gjuhën angleze): “A more secure world: Our shared responsibility”, raport i Panelit të lartë të OKB-së për kërcënimet, sfidat dhe ndërrimet, 1 dhjetor 2004, fq.72. Kjo ndodhë edhe pasi Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik “Organisation for Economic Cooperation and Development” – OECD, e ka klasifikuar këtë ndihmë si asistencë për zhvillim.

¹⁹¹ Shih (në gjuhën angleze): Edward Rees, “Security Sector Reform and Peace Operations: ‘Improvisation and Confusion’ from the Field”, studim i jashtëm për operacionet paqeruajtëse të Kombeve të Bashkuara, mars 2006, fq. 17.

IV. RRUGA PËRPARA NESH

Siguria në Kosovë në muajt në vijim si dhe në vitet menjëherë pas statusit varet shumë nga qëndrimi i Beogradit si dhe nga vullneti politik i bashkësisë ndërkombëtare. Sa do ta pajtohet Serbia me krijimin e shtetit të ri? Sa larg do të shkojë me përpjekjet e saj që të bëjë zonat e banuara me serbë, sidomos ato në veri, jo e qeverisur nga Prishtina? Beogradi tani po i afrohet momentit që të pranojë ndarjen si strategji të veten.¹⁹² Planet për të konsoliduar një identitet multi-etnik të Kosovës janë të rrezikuara nga hapat e ardhshëm të Beogradit; Beogradi ka në dorë çelësin që vendos nëse Kosova e pavarur do të jetë e cinguar dhe etnikisht shqiptare apo mban mjaft “brumë” që të mbetet e bashkuar në një formë të multi-etnicitetit.

Këtu mund të ndikojë bashkësia ndërkombëtare. Të përjashtosh ndarjen si opsion nuk do të thotë edhe se kështu do të bëhet: kjo duhet të kthehet në strategji. Tani për tani, edhe serbët, edhe shqiptarët, do ta shohin atë si një deklaram të përkohshëm që do të harrohet shumë shpejtë pasi të zgjidhet statusi. Nëse bashkësia ndërkombëtare dëshiron të tejkalojë në vend se ta thellojë ndarjen, de facto, që ekziston tani si dhe të evitohet krijimin e forcave të sigurisë mono-etnike në Kosovë, atëherë duhet që të ketë strategji edhe për reformimin e sektorit të sigurisë. Pa investim të energjisë dhe resurseve ndërkombëtare në inkuorimin serbëve të veriut në Kosovë, qytetarët nuk do të investojnë vetë në një identitet multi-etnik dhe një arkitekturë të sigurisë për të ruajtur atë.

Sigurisht që tensionet në veriun serb si dhe përgjatë vijës ndarëse në Mitrovicë do të shtohen sa më shumë që t’i afrohem ditës kur do të vendoset statusi. Edhe pse duket se Beogradi përjashton mundësinë që hapur të sjellë forcat e armatosura për të ndihmuar ekstremistët në veri të Mitrovicës, megjithatë do të mund t’u jepte dritën e gjelbër për këtë grupeve paramilitare. Paratë e qeverisë së Beogradit tanimë financojnë strukturat lokale paramilitare në komunat veriore. Mbetet të shpresohet se KNS dhe Beogradi do të përcaktohen për vetëpërmbytje. Nëse qëllim i tyre mbetet thellimi i ndarjes të pjesës mbi lumin Ibër me Prishtinën, një qasje graduale do të minimizonte rrezikun.

Nga ajo se si do të reagojnë serbët në veri, ndaj lajmit për shpalljen e pavarësisë dhe si do të përgjigjen KFOR-i e

UNMIK-u varet edhe sa do të mobilizohen luftëtarët shqiptarë nga Drenica e Dukagjini për të luftuar për Mitrovicën. Dhuna do ta ndante përgjithmonë Kosovën përgjatë lumit Ibër apo do t’i dëbonte serbët nga veriu i Mitrovicës. Prospektet e krijimit të një organizate të përbashkët të sigurisë mes Kosovës qendrore dhe veriut serb do të minoheshin. Serbët në jug të Ibrit si dhe shqiptarët në Serbinë jugore do të bëheshin shumë të cenusëshëm.

A. KONTEKSTI USHTARAK RAJONAL

1. Perceptimet e shqiptarëve dhe serbëve për NATO-n

Në raport me njëri tjetrin, shqiptarët dhe serbët e Kosovës, Prishtina dhe Beogradi, e shohin sigurinë e tyre si të papërmirësueshme. Prandaj është pozitive që të gjitha palët pajtohen që KFOR-i duhet të mbesë në Kosovë për një periudhë më të gjatë. Në një masë më të vogël që të dy këto palë pajtohen rreth idesë së konsolidimit të SHPK-së si një shtyllë vendore e sigurisë, edhe pse shumica e serbëve të Kosovës ende nuk i besojnë këtij institucioni.¹⁹³ Por Prishtina dhe Beogradi ende nuk e shohin NATO-n si një mjet që do të ndihmojë, por vetëm si mjet për ngrirjen e këtyre marrëdhënieve. Që të dyja e shohin çështjen e sigurisë rajonale si çështje të balancimit të forcave. Bashkëpunimi në sferën e sigurisë nuk është në agjendat e tyre. Deri sa nuk përcaktohet statusi, NATO gjithashtu nuk mund të bëjë hapa nga roli i mbajtjes së paqes drejt ofrimit të ndihmës palëve, që të participojnë në integrimin rajonal të sigurisë.

Për Beogradin, KFOR-i i ndal shqiptarët, gjë të cilën ushtria e saj më nuk ta bëjë. Kryetari Tadiq i ka thënë Grupit të Krizave se Beogradi do të insistojë që KFOR-i të mbesë edhe një kohë të gjatë,¹⁹⁴ ndërsa njëri nga këshilltarët e kryeministrit Koshtunica ka thënë: “ne as që dëshirojmë ta dërgojmë ushtrinë tonë atje, por do të ishte mirë që forcat ndërkombëtare të mbesin atje”.¹⁹⁵ Disa burime nga forcat serbe të sigurisë thonë se një nga tri prioritetet e tyre në Kosovë është që forcat ndërkombëtare të vazhdojnë të garantojnë sigurinë.¹⁹⁶ Serbia e sheh KFOR-in edhe si një mjet për t’ia mohuar Kosovës që të ketë forcat e veta të armatosura si dhe mjet për

¹⁹² Në fillim të muajit Maj 2006, ideja e ndarjes së Kosovës ishte paraqitur në *Politika* dhe *NIN* të Beogradit. Intervistat e Grupit të Krizave me zyrtarë të qeverisë së Serbisë në maj dhe qershor 2006, konfirmuan rishfaqjen e interesimit të Beogradit për këtë projekt.

¹⁹³ Sipas raporteve të paralajmërimit të hershëm, anketa që bëhen çdo çerekviti për UNDP-në, mes korrikut 2004 dhe dhjetorit 2005 besimi i serbëve të Kosovës ndaj SHPK-së asnjëherë nuk ishte mbi 5 për qind. Shih raportin numër 12: http://www.kosovo.undp.org/publications/ews12/ewr12_alb.pdf

¹⁹⁴ Bisedë e Grupit të Krizave me kryetarin Tadiq, qershor 2006.

¹⁹⁵ Aleksandar Simiq, i cili është edhe anëtar i ekipit negociator të Serbisë, 22 prill 2006, bazuar në raportet e mediave të Beogradit.

¹⁹⁶ Intervistë e Grupit të Krizave, Beograd, 11 maj 2006.

demilitarizimin e territorit. Për këtë “kemi hequr dorë nga kthimi i ushtrisë tonë në provincë dhe tani na duhet të luftojnë që të mbajmë për vete hapësirën ajrore mbi Kosovë e Metohi dhe të kërkojmë leje nga NATO për të survejuar me satelitë territorin”, thotë një politikan serb në Kosovë.¹⁹⁷

Pas rënies së Milosheviqit, Beogradi filloi t'i përmisojë dhe korrigjojë marrëdhëniet me NATO-n e KFOR-in.¹⁹⁸ Bashkëpunimi në dhënien fund të kryengritjes shqiptare në Luginën e Preshevës në Serbi ishte një kthesë vendimtare. Në maj të vitit 2001, shefi i atëhershëm i ushtrisë së atëhershme të Serbisë e Malit të Zi, Gjenerali Nebojsa Pavkoviq, i kishte thënë një gazete ushtarake amerikane: “Ne nuk jemi më armiqtë”.¹⁹⁹ Ministri i mbrojtjes, Prvoslav Daviniq, kishte thënë: “Në momentin që do të hyjmë në Partneritetin për Paqe (të NATO-s), ne do të bëhemi aleatë dhe partnerë të të gjitha vendeve që janë në Kosovë me KFOR-in”.²⁰⁰ Në qershor 2005 për herë të parë janë takuar ministri i mbrojtjes i Serbisë me komandantin e KFOR-it në Prishtinë nga i cili takim u njoftua për mbajtjen e një stërvitjeje të përbashkët si dhe për koordinim të patrullimeve në kufi. KFOR-it iu deshën disa ditë që të mohojë se stërvitjet do të bëhen edhe në territorin e Kosovës dhe në atë të Serbisë. Në korrik 2005, NATO dhe Serbia e Mali i Zi u dakorduan për kalim të lirë të paqeruajtësve nëpër territorin e SMZ-së së atëhershme. Kjo i mundëson KFOR-it që të sjellë furnizimet nëpër Serbi dhe bën të mundur që paqeruajtësit nga Bosnja e Hercegovina të dërgohen me shpejtësi në Kosovë për të shtuar forcën e KFOR-it nëse ndodh diçka e ngjashme me trazirat e marsit 2004.

Për shqiptarët e Kosovës, prezenca e NATO-s do të thotë se nuk lejohen të kthehen forcat serbe. Edhe pse marrëdhënia e NATO-s me UÇK-së ka qenë e paqartë, shqiptarët e Kosovës megjithatë e shohin atë si aleat të luftës ndërsa respektin e shton edhe më tepër pro-amerikanizmi i tyre. Megjithatë, kjo nuk mjaftoi që të ndalë mijëra qytetarë që të përleshën me KFOR-in në mars të vitit 2004. Prezenca e NATO-s pas statusit duhet të jetë e atillë që të ruajë ambientin pozitiv dhe për këtë qëndrimi ndaj TMK-së është më se i rëndësishëm. Përndryshe, do të jetë çështje kohe kur KFOR-i i ristrukturuar pas marsit 2004 në një forcë që të përballet me trazirat e brendshme, të fillojë të konsiderohet si forcë armiqësore. TV fushata agresive e KFOR-it në vitin 2005

tërhiqte vërejtjen se do të ketë reagim të ashpër, nëse turma sulmon manastiret apo vendbanimet serbe. Pas takimit të komandantit të KFOR-it me shefat ushtarakë të Serbisë e Malit të Zi, më 12 gusht 2005, komunikatat e lëshuara nga të dyja palët përmendnin gatishmërinë e shtuar të KFOR-it që të mbrojnë lokacionet fetare. Më 23 gusht 2005 KFOR-i demonstroi para priftërinjve ortodoksë serbë aftësitë për t'u përballur me demonstrata me 700 trupa që i u kundërvunë turmës së improvizuar. Ky qëndrim duhet të zëvendësohet me një që është më i orientuar kah partneriteti. Çeku, që tani është kryeministër i Kosovës, pat shprehur keqardhje që KFOR-i po investonte aq shumë duke u ushtruar për konfrontim e nuk po punonte në ngritjen e kapaciteteve vendore të sigurisë.²⁰¹

Përkundër prezencës së KFOR-it, shumë shqiptarë ende ndihen të kërcënuar. “Ne ende ndihemi të rrezikuar këtu, kujtimet e para shtatë viteve ende janë të freskëta”.²⁰² Populli ende e kujton pushtimin e viteve 1912-1913 por kapacitetet ushtarake dhe apetitet e Serbisë tani janë më të pakta se sa në vitin 1999²⁰³, kështu që shqiptarët i frikësohen infiltrimit e jo rikthimit të forcave serbe. Shumë politikanë nacionalistë serbë, zyrtarë dhe intelektualë, thonë se do të refuzojnë të pranojnë pavarësinë e Kosovës dhe shtojnë se kur rrethanat të ndërrojnë, pas njëzet apo njëqind viteve, ata do ta rimarrin atë. Sado joreale të jetë kjo, retorika e tillë u qet hije të keqe propozimeve si ajo për moratorium njëzetvjeçar për statusin siç ka propozuar kryetari Tadiq në shkurt 2006. Deklaratat e zyrtarëve si ato që “Kosova nuk mund të mbijetojë e pavarur, as financiarisht e as në aspektin e sigurisë... ajo do të bëhet ose pjesë e Serbisë ose e Shqipërisë”²⁰⁴ ua përkujtojnë shqiptarëve se sa i cenushtëm është territori i tyre dhe sa herë që shpërbëhen entitetet jo-natyrore siç ishin Perandoria Otomane apo Jugosllavia e ata u desh të përballeshin me Serbinë. Buxheti për mbrojtje i Beogradit është 560 milion euro, ai i TMK-së 15 milion euro. As Pakti i Stabilitetit, as Partneriteti për Paqe i NATO-s e as BE-ja nuk mjaftojnë që shqiptarët e Kosovës të ndihen të sigurt.

2. Shqetësimet dhe rreshtimi ushtarak i Serbisë

Për Serbinë është e kundërta: sipas kushtetutës jugosllave të 1974-tës dhe nën UNMIK-un pas 1999-tës, pasi

¹⁹⁷ Rada Trajkoviq, *Danas*, 19 dhjetor 2005, përmbledhur në “KIM Info Newsletter”, 21 dhjetor 2005.

¹⁹⁸ Ky ndërrim nuk vlen edhe për marrëdhëniet civile mes qeverisë së Serbisë dhe UNMIK-ut.

¹⁹⁹ Shih (në gjuhën angleze): “Kevin Dougherty, ‘Yugoslavia considers petitioning NATO for Partnership for Peace membership’”, *Stars and Stripes*, 3 maj 2001.

²⁰⁰ Intervistë në *Glas Juga*, korrik-gusht 2005.

²⁰¹ Intervistë e Grupit të Krizave me Gjeneral Çekun, 30 gusht 2005.

²⁰² Intervistë e Grupit të Krizave, maj 2006.

²⁰³ Pjesa më e madhe e më shumë se 1.000 tankeve, të cilat i disponon Serbia, nuk janë në gjendje të rregullt dhe nuk mund të përdoren për shkak të mungesës së pjesëve apo karburanteve. Sipas planeve për reduktim, numri i tyre do të ulet në 180.

²⁰⁴ Intervistë e ish-koordinatorit të qeverisë së Serbisë për Kosovën, Nebojsa Çoviq, *Blic*, 14 mars 2005.

Beogradi është detyruar të largohet nga Kosova, shumica shqiptare u ka bërë presion serbëve të Kosovës që të largohen. Kosova ka përhapur kryengritjet në territoret fqinje të banuara me shqiptarë: Ushtrinë Çlirimtare të Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit (UÇPMB) në Serbinë jugore në vitin 2000, dhe Ushtrinë Çlirimtare Kombëtare (UÇK) në Maqedoni në vitin 2001. Pasi ta reduktojë forcën e vet ushtarake të përbërë kryesisht nga rekrutët, nga 70.000 pjesëtarë në 21.000 ushtarë profesionistë, deri në vitin 2010,²⁰⁵ ushtria serbe do të përqendrohet në harkun nga lindja deri në veri të Kosovës.²⁰⁶ Të pengohen zonat e banuara me shqiptarë në Serbinë jugore që të bashkohen me Kosovën dhe të mbahet e hapur autostrada për në Maqedoni janë prioritetet më të larta. Dy brigada janë të vendosura në këtë zonë ndërsa në të ardhmen këtë punë do ta kryejë Brigada 78 e Mekanizuar e përbërë nga ushtarake krejtësisht profesionistë. Gati 30 baza ushtarake të madhësisë së një togu janë vendosur mes kufirit mes Kosovës dhe komunave me shumicë shqiptare në jug të Serbisë, Preshevës (me 90 për qind shqiptarë) dhe Bujanocit (me 55 për qind shqiptarë).²⁰⁷ Ndërtimi i një bazë e re, që po ndërtohet mes dy komunave është vonuar për disa vite dhe mbetet e paqartë nëse do të përfundojë. Një kompani e njësisë paramilitare të xhandarmerisë është vendosur në rajon për të mbështetur policinë multi-etnike në Preshevë dhe Bujanoc. Rotacioni i trupave në Serbinë jugore tani bëhet çdo muaj “që të evitohet korrupsioni i tyre nga shqiptarët”.²⁰⁸

Rreshtimi i forcave të Serbisë tregon se për shkaqe praktike, ushtria e saj e ka pranuar humbjen e Kosovës. Nuk duket se po përgatit forca të rregullta për ndonjë intervenim të mundshëm dhe rreshtimet janë defensive, duke e konsideruar jugun e Serbisë si domino tjetër për t’u rrëzuar dhe duke konsideruar si armiq, grupet militare klandestine pan-shqiptare, dhe jo strukturat zyrtare shqiptare që janë zhvilluar në Kosovë dhe Maqedoni. Udhëheqësit ushtarak të Serbisë besojnë në kontinuitetin dhe vitalitetin e rrjetit që mes viteve 1997 e 2001 kanë nxitur kryengritje në Kosovë, Serbi të jugut dhe Maqedoni. Një analist ushtarak i Beogradit ka përmendur një instancë që është potencialisht shqetësuese për

Serbinë jugore: ai ka thënë se luftëtarë shqiptarë kanë mundur të kalojnë nga Tetova në Pejë, nëpër kufirin Maqedoni-Kosovë, gjatë trazirave të marsit 2004 ndërsa KFOR-i nuk ka bërë asgjë për këtë.²⁰⁹ Edhe pse insinuatat për komplotet e TMK-së në media kanë pushuar në këta tetëmbëdhjetë muajt e fundit, ushtria ende e sheh TMK-në si pararoje apo inkubator i organizatës ushtarake paralele shqiptare dhe beson se TMK-ja ka mundur të interceptojë dhe zbulojë të gjitha komunikimet ushtarake në jug të Serbisë.²¹⁰

3. Drejt sigurisë kolektive

Ballkani perëndimor është duke kaluar nga ushtritë e mëdha me rekrutë e rezervistë në ushtria profesionale, të vogla e fleksibile. Gradualisht, modeli i sigurisë kolektive i përpiluar nga NATO është duke gjetur vend duke e zëvendësuar konceptin e nevojës për balancim të forcave mes etnive apo shteteve.²¹¹ Maqedonia, Shqipëria dhe Kroacia janë kandidatë për anëtarësim në NATO dhe po kontribuojnë me trupa në vatrat e krizës si Afganistani dhe Iraku. Maqedonia e ka shpërbërë forcën e vet ajrore dhe ia ka besuar mbrojtjen e hapësirës së saj ajrore anëtarit të NATO-s, Bullgarisë. Gjithnjë e më shumë po inkurajohet bashkëveprimi i forcave. Serbia nuk është ende në Partneritetin për Paqe por ka trajnuar një njësit xhenio për angazhim të mundshëm në misione ndërkombëtare si dhe ka vënë raporte bashkëpunimi me Kroacinë; një projekt i mundshëm i përbashkët është ai i ekipeve mjekësore ushtarake të përbashkëta, që do të përfitonte nga përvoja nga vitet e nëntëdhjeta.²¹² Mali i Zi i sapo pavarësuar mund të racionalizojë forcat paramilitare që ka krijuar si mbrojtje e mundshme nga Serbia gjatë kohës sa ishte në konfederatë me të.

Por ky model i sigurisë ka shumë pengesa para vetes: raportet mes Serbisë dhe Bosnjës e Hercegovinës për shkak të ngjarjeve të viteve 90-të, çështja e Mladiqit si dhe ekzistimi i dy ushtriave të dy entiteteve e pengojnë anëtarësimin në PpP. Nuk janë zhvilluar ide të reja as ndër lidhshpin politik por as ndër opinionin publik për nevojën që ushtria të luajë rol tjetër të ri; mendja e shumicës mbetet e ngujuar në të kaluarën. Strategët ushtarakë serbë stërvitjet ende i bëjnë duke e

²⁰⁵ Plani për reforma në ushtrinë serbe, e që thuhet se është miratuar më 6 qershor 2006, parasheh që numri i ushtarëve të zvogëlohet në 27.000 në vitin 2007 dhe me reforma të mëtejshme deri në vitin 2010 të krijohet një forcë krejtësisht profesionale. Raporte televizive të RTS e B92, përmbledhur në “VIP Daily News Report”, 15 qershor 2006.

²⁰⁶ Një brigadë e vogël është e vendosur në Sanxhak.

²⁰⁷ Shih Raportin për Evropë numër 152 (në gjuhën angleze), *Southern Serbia's Fragile Peace*, 9 dhjetor 2003, dhe Brifingun për Evropë të Grupit të Krizave numër 43 (në gjuhën angleze): *Southern Serbia: In Kosovo's Shadow*, 27 qershor 2006.

²⁰⁸ Intervista të Grupit të Krizave, Beograd, 11 dhe 13 maj 2006.

²⁰⁹ Intervistë e Grupit të Krizave, 13 maj 2006.

²¹⁰ Raportim mbi një diskutim të mbajtur brenda Ministrisë së Mbrojtjes të Serbisë e Malit të Zi, intervistë e Grupit të Krizave, Beograd, maj 2006.

²¹¹ Shih (në gjuhën angleze) Dimitar Bechev, “Worst-case scenarios and historical analogies: interpreting Balkan interstate relations in the 1990s”, në publikimin e Aleksandar Fatic, *Security in southeastern Europe* (Beograd, 2004), që hulumton hapat e rajonit drejt stabilitetit duke krahasuar luftërat gjatë viteve 90 në territorin e ish-Jugosllavisë me Luftërat ballkanike të viteve 1912-1913.

²¹² Intervistë e Grupit të Krizave, Beograd, 12 maj 2006.

paramenduar rimarrjen e Kosovës: “Kemi të bëjmë me një situatë vërtetë skizofrenike... A është kjo vetëm një stërvitje akademike? Nëse i pyet këta eprorë individualisht, ata të thonë se e tëra është imagjinatë... Jo pak koka të nxehta besojnë në legjendën e *Dolchstoss*²¹³ por brenda thellë e dinë se më nuk ia vlen të luftohet”.²¹⁴

Si në Serbi ashtu edhe në Kosovë, politikanët nuk dinë se janë përgjegjës për të mbikëqyrë sigurinë, kryesisht për shkak të traditës së gjatë që forcat e sigurisë të operojnë pa kontroll demokratik civil. Në Serbi nuk ka iniciativa për të shqyrtuar strategjinë e mbrojtjes që të identifikohen objektivat si dhe mjetet e shpenzimit për t’i arritur ato. Ne vend të kësaj “ata vetëm pyesin ‘sa shpejt mund të bëjmë reduktimet?’”²¹⁵ Në Kosovë mungesa e një elite të sigurisë është edhe më kritike. OKB-ja nuk ka lejuar IPVQ-që që të angazhohet në këtë çështje. Kuvendi nuk është i zhvilluar mjaftë. Mangësitë në dije dhe përvojë janë rezultat i përjashtimit të shqiptarëve të Kosovës nga qeverisja gjatë viteve nëntëdhjetë dhe nga standardi i ulët i arsimit. Një epror i TMK-së flet për “mentalitetin ballkanik, sipas të cilit i fortë është ai që ka ushtri të fortë”, edhe pse “gjithnjë e më shumë kosovarë po e kuptojnë se uniformat duhet të implementojnë e jo të marrin vendime politike”.²¹⁶

Kosova e Serbia nuk mund të marrin me mend se mund të bashkëpunojnë në çështjet e mbrojtjes. Nuk ka forume në të cilat mund të flitej për këtë. Serbia ende shpreson se do ta pengojë Kosovën që të bëhet me ushtri ndërsa Kosova ende nuk mund të flasë për çështjet e sigurisë.²¹⁷ Në anën tjetër, rajoni ka “probleme të përbashkëta të sigurisë: krimi i organizuar, korrupsioni, jostabiliteti”²¹⁸ dhe forcat e sigurisë të këtyre vendeve më shumë ka gjasa që në të ardhmen të përballen me kërcënimet siç janë

²¹³ Diçka sikur thënia “thikë pas shpine”, ky emër shënon bindjen që mbizotëron në qarqet nacionaliste-ushtarake të Gjermanisë pas Luftës së Parë Botërore, sipas të cilës ushtria e tyre nuk kishte humbur në fushëbetje por ishte tradhtuar nga klasa politike dhe të tjerë “në shtëpi”.

²¹⁴ Intervistë e Grupit të Krizave me një analist të mbrojtjes në Beograd, 12 maj 2006.

²¹⁵ Ibid.

²¹⁶ Intervistë e Grupit të Krizave me Shefin e Qendrës së Trajnimit Kolektiv të TMK-së, Muharrem Rrahmani, Ferizaj, 15 maj 2006.

²¹⁷ Një rast për të takuar TMK-në me shefin e ushtrisë së Serbisë e Malit të Zi u lëshua më 1 shtator 2005, gjatë ceremonisë së ndërrimit të komandit të KFOR-it. KFOR-i nuk kishte përgatitur mirë ftesën për Gjeneralin e Shtabit të Ushtrisë së Serbisë, Paskash. Reagimi i mediave bëri shumicën e liderëve politikë shqiptarë që të bojkotojnë ceremoninë. Përkundër bindjes së tyre (më të mençur), liderët e TMK-së u ndien të obliguar që t’i bashkëngjiten bojkotit.

²¹⁸ Intervistë e Grupit të Krizave me profesorin Zoran Dragishiq në Fakultetin e mbrojtjes civile, Universiteti i Beogradit, 12 maj 2006.

katastrofat natyrore se sa lufta e reja mes tyre.²¹⁹ PpP (PpP) i NATO-s mund të shtyjë vendet anëtare që të bashkëpunojnë. Vendet e Ballkanit Perëndimor, kandidatë për anëtarësim në aleancë, kanë themeluar Kartën e Adriatikut si krah multilateral rajonal i NATO-s,²²⁰ por as Serbia as Kosova nuk janë anëtare të saj.

A do të garantohet siguria nëse statusi ushtarak i Kosovës në konstelacionin rajonal mbetet “vrimë e zezë”? Shqiptarët e Kosovës thonë se pranimi i diktatit që të mos themelohen forcat e armatosura do të ishte i barabartë me disfatë ushtarake retrospektive, mohim i pavarësisë dhe status i rrezikshëm i shtetit të rendit të dytë: “Kosova nuk mund të jetë qengj në mesin e ujqëve”.²²¹ Edhe pse disa mikro-shtete nuk kanë forca ushtarake, ndërsa Kostarika nuk ka ushtri të përhershme, për rreth dy milion shqiptarët e Kosovës kjo do të ishte ide e papranueshme. Ajo ka banorë përfaqësues sa edhe Sllovenia, tani anëtare e NATO-s dhe me një ushtri me rreth 10.000 trupa. Çdo vend i Evropës Lindore që ka hyrë në BE, së pari është anëtarësuar në PpP dhe NATO. Pa ushtri, Kosova nuk do të jetë në gjendje që të hyjë në NATO.²²²

4. Ushtria si ilaç për paramilitarët

Më e rëndësishmja ndoshta është se nëse Kosovës i mohohet të ketë ushtri, atëherë kjo do të mbajë në jetë rrjetet ilegale. Në vend se të ndërtohen institucione shtetërore që do t’i nënshtroheshin presionit nga NATO dhe organizatave tjera që do të mbikëqyrin të arriturat e Kosovës në qeverisje dhe multi-etnicitet, vëmendja do të përqendrohej në sferën klandestine që shumë lehtë do të mund të eksploatohet nga krimi i organizuar. “Nëse ua ndalojmë që të kenë ushtri zyrtarisht, automatikisht do të dalë një zëvendësim ilegal i saj”, thotë një zyrtar perëndimor.²²³ Në anën tjetër, një ushtri e vogël e Kosovës do të kënaqte krenarinë e shqiptarëve, të cilët do të investonin në shtetin e ri dhe do të largonin vëmendjen nga ideja latente e pan-shqiptarizmit. Ushtritë çlirimtare fantazmë – prapa të cilave shpesh fshiheshin banditë – e të cilat janë shfaqur në Kosovë në vitet e fundit, do të humbnin çfarëdo legjitimiteti në sytë e shqiptarëve të Kosovës nëse këta do të kishin një ushtri të mirëfilltë. “Nëse kemi ushtrinë tonë, kjo do t’i bindë njerëzit se

²¹⁹ Intervistë e Grupit të Krizave me Pavle Janković, “International and Security Affairs Centre” (Qendra për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Siguri) Beograd, 12 maj 2006.

²²⁰ Shih (në gjuhën angleze): “Fact sheet on the Adriatic Charter”, U.S. State Department, në www.state.gov/p/eur/rls/fs/51348.htm.

²²¹ Politikani Jakup Krasniqi i cituar nga Leonard Kerquki, “Duarthatë midis ujqëve, kjo s’do të ndodhë”, *Lajm*, 26 maj 2006.

²²² Islanda është anëtarësuar pa pasur ushtri por vështirë se NATO do të pranojë një kandidat tjetër të tillë. Kërkesat e NATO-s janë gjithnjë e më strikte.

²²³ Intervistë e Grupit të Krizave, Prishtinë, 28 prill 2006.

armët ilegale duhet të legalizohen apo të dorëzohen, edhe pse kjo do të merrte pesë deri në dhjetë vite për t'u arritur", thotë një pjesëtar i TMK-së.²²⁴

Nëse arrihet relativisht qetë deri në përcaktimin e statusit final, atëherë kjo do të bëjë që rrjetet paramilitare gradualisht të shkatërrohen. Por, nëse tensionet eskalojnë, ekziston rreziku për mobilizim në të dyja anët gjë që do të ringjallte paramilitarët. Kjo do të ndodhte nëse serbëve të veriut të Kosovës, nuk do të ju mjaftonte vetëm më fjalë, kur flasin për milicinë për vet-mbrojtje dhe i ftojnë përkrahësit e tyre të armatosur nga qytetet e jugut të Serbisë; grupet tjera të asociuara me Partinë Radikale Serbe bashkëngjiten; derisa organizatat zyrtare të sigurisë në Serbi nuk ua ndalojnë këtyre që të hyjnë në Kosovë. Sigurisht që edhe shqiptarët nga vatrata e UÇK-së do të mobilizoheshin. Rrjetet e tilla paramilitare të ringjallura do të lënin në hije ushtritë zyrtare dhe do të shtynin dhe kthenin prapa, përpjekjet për bashkëpunim në sektorin e sigurisë në Ballkanin perëndimor.

B. OPSIONET USHTARAKE

Duke u përqendruar deri tani në ngritjen e policisë e jo të një ushtrie në Kosovë, bashkësia ndërkombëtare është përqendruar në sigurinë e njerëzve, në ndërtimin e një Kosove ku të gjithë njerëzit "pa marrë parasysh përkatësinë etnike, racore apo fetare, do të jetojnë, punojnë dhe lëvizin të lirë, pa frikë, armiqësi dhe rreziqe, dhe ku ka tolerancë, drejtësi dhe paqe për të gjithë".²²⁵ Shqiptarët e Kosovës nuk kanë qenë të gatshëm që ta pranojnë këtë ide; Beogradi e sheh si mashtrim të rrezikshëm.

Është koha e fundit që bashkësia ndërkombëtare t'i bëjë palët të bisedojnë për sigurinë në Kosovë. Kur të merret vendimi për statusin final do t'i ketë humbur shumicën e levave, përfshirë edhe mundësinë që të mikro-menaxhojë çështjet e sigurisë. Të gjitha komponentet, përfshirë masat legale, institucionale dhe administrative, duhet të bëhen bashkë ndërsa "përleshjet në kufi duhet të evitohen me çdo kusht".²²⁶ Për fat të keq, bashkësia ndërkombëtare ia ka lidhur duart vetes duke mos krijuar hapësirë të mjaftueshme për debat për çështjet e sigurisë dhe duke lënë hapur mundësitë për rezultate të paparashikueshme.

Grupi i Kontaktit ka filluar që së paku të mendojë për çështjen e sigurisë: takimet ku flitet për këtë janë bërë më

të shpeshta ndërsa kanë filluar të qarkullojnë edhe dokumente jozyrtare (non-paper). Kanë filluar të kristalizohen idetë rreth çështjeve që do të mbeten kompetenca të rezervuara siç janë organet e zbulimit. Megjithatë, kjo punë e Grupit të Kontaktit nëpër kryeqytete bie ndesh me një mekanizëm të sponsorizuar nga një pjesë tjetër e bashkësisë ndërkombëtare që synon të zhvillojë arkitekturën e sigurisë duke filluar nga poshtë lartë, nëpërmjet konsultimeve në Kosovë: Rishikimi i Sektorit për Siguri të Brendshme, i njohur me akronimin në gjuhën angleze ISSR (Internal Security Sector Review). Me fonde të mjaftueshme dhe me seli në ndërtesën e qeverisë në Prishtinë që nga muaji prill, ky është bërë një proces vizibil, edhe pse jo shumë i qartë, për qytetarët e Kosovës. OSBE-ja ka organizuar diskutime për të në pothuajse të gjitha komunat e Kosovës; panot që thërrasin "thuaj fjalën tënde për sigurinë" shihen gjithandej; emri ISSR promovohet në reklama televizive; autobusi i saj shkon nga një qytet në tjetrin; ka një TV debat, i cili që transmetohet çdo dy javë, në televizionin publik.

Ekziston brenga se ISSR mund të arrijë në përfundime që nuk përputhen me mendimet e Grupit të Kontaktit,²²⁷ edhe pse SHBA-ja më tepër është e brengosur me tempon e ngadalshëm të këtij procesi, gjë që rrezikon të vonojë edhe vendimin për statusin final. Në muajin maj Washingtoni u tërhoq nga propozimet e veta "konkurrente", përpilimin e të cilave e kishte kërkuar në një dokument jozyrtar të Universitetit të Mbrojtjes Kombëtare.²²⁸ Janë ilustrative dallimet mes çështjeve që kryeqytetet e botës i cilësojnë prioritete dhe pikëpamjeve të kosovarëve – kryeqytetet janë të përqendruara kryesisht në kundër-terrorizëm dhe krim të organizuar. Konsultimet e ISSR-së kanë zbuluar se sidomos kjo e para nuk është aspak prioritet për kosovarët.²²⁹

Roli i saktë i rezolutës së re të Këshillit të Sigurimit në krijimin e statusit të ri të Kosovës ende nuk dihet. Ndoshta do të ofrojë një kornizë të gjerë, pa kushte specifike për forcat e armatosura, ndoshta duke përdorur fraza të përgjithshme do të caktojë aktorë ndërkombëtarë siç janë NATO e BE-ja që të angazhohen në zhvillimin e strukturave vendore të sigurisë. Por, kalimi i pavarësisë së Kosovës nëpër Këshillin e Sigurimit mund të rezultojë edhe me mohimin e gjërave siç janë karrigeja në OKB ose ushtria. Kur themeluan TMK-në, KFOR-i dhe UNMIK-u u desh të manovrojnë rreth tekstit të Rezolutës 1244. Këtë herë, marifete të tilla nuk bënë të ketë. Çdo premtim për ushtrinë duhet të mbahet. Vendimi për

²²⁴ Intervistë e Grupit të Krizave, Ferizaj, 15 maj 2006.

²²⁵ Frazë nga preambula e Standardeve të UNMIK-ut, e përvetësuar nga Grupi i Kontaktit në deklaratën e vet të 22 shtatorit 2004.

²²⁶ Intervistë e Grupit të Krizave me një zyrtar të NATO-s, 8 maj 2006.

²²⁷ Intervista të Grupit të Krizave në Bruksel e Prishtinë, maj 2006.

²²⁸ Intervista të Grupit të Krizave, Prishtinë, maj e qershor 2006.

²²⁹ Pjesëmarrësit në debat pothuaj se nuk e përmendën fare këtë çështje, intervistë e Grupit të Krizave me sekretariatit e ISSR, Prishtinë, 8 maj 2006.

statusin i jep bashkësisë ndërkombëtare një rast që aspiratat e Kosovës për të pasur ushtri të futen në binarë të parashikueshëm dhe të qëndrueshëm. Nëse kjo përdoret si mënyrë për të penguar këto aspirata, ka gjasa që gjërat të marrin drejtim tjetër dhe më të rrezikshëm. Ky rast duhet të shfrytëzohet që të parashikohet e ardhmja e këtyre aspiratave dhe të kanalizohen në një drejtim që, sado i hidhur që të jetë për Serbinë, nuk do të jetë kërcënues për të ardhmen. Lënia e të gjitha opsioneve të hapura për periudhën pas statusit i hap derën jostabilitetit. Kushtet e qarta për ushtrinë e ardhshme duhet të jenë pjesë e kornizën për zhvillimin ushtarak të Kosovës.

Debati duhet të sillet rreth saj nëse Kosova duhet të ketë ushtri dhe nëse po, atëherë çfarë do të jetë qëllimi dhe çfarë do të jenë detyrat e saj e jo të ndalet në atë se çfarë do të ndodhë me TMK-në. Mospërputhja mes perspektivës së varfër ekonomike dhe popullatës së re e gjithnjë në rritje padyshim përbën kërcënimin më të madh për sigurinë në Kosovë në një afat më të gjatë, duke kërcënuar me më shumë kriminalitet, më shumë tronditje sociale dhe ekstremizëm.²³⁰ Sipas kësaj, del se pasja e një ushtrie vetëm sa do ta rëndonte gjendjen ekonomike e me këtë do të shtonte krizën. Për më tepër, pasi Kosova është e ndarë në vija etnike, të cilën lumi Ibër e bën edhe më të trashë, a nuk do të ishte gjë më e mirë që të bëhet një demilitarizim i plotë i vendit? Serbia sigurisht do të pajtohej me këtë.

1. Dobitë e pasjes së ushtrisë

Sipas TMK-së, dobia më e madhe nga pasja e një ushtrie në Kosovë vjen nga vet ekzistimi i saj: “Një forcë mbrojtëse legale është simbol që definojnë një shtet të pavarur,²³¹ simbol që “do të luajë rol të madh në zhvillimin e shtetit të ri... që do të ndihmojë kombin të kalojë kohët e vështira të tranzicionit duke u bërë shembull i unitetit, integritetit e bashkëpunimit, shembull të cilin të tjerët do të duhej ta ndiqnin”.²³² Do t’i jepte Kosovës “shembull të mirë të profesionalizmit institucional dhe shërbimit apolitik ndaj shtetit... përqendrimit në lidhshmëri dhe vet-disiplinë”. Sovraniteti i vendeve në BE nuk është më i fortë siç ka qenë dhe ideja e shtetit në Evropë ka hyrë në një fazë post-moderne dhe Kosova nuk do ta ketë një pavarësi të stilit të shekullit nëntëmbëdhjetë, por, përkundër kësaj, nuk është ide e mençur të thuhet se nuk ka nevojë për të pasur ushtri. Një ushtri që do të funksiononte mirë mund të jetë mbrojtja më e mirë nga krijimi i një shteti të dështuar.

Ndërsa, nëse pranohet ideja e ushtrisë, atëherë ka mjaft hapësirë për të biseduar për formën dhe kompetencat e

saj. Ushtria e Kosovës nuk do të ketë nevojë për kapacitete ofensive: për avionë, tanke e artileri të rëndë. Më të theksuara do të ishin degët e logjistikës dhe inxhinierisë, në çka do të inkorporohej ekspertiza e TMK-së. Madje do të mund të krijohej ashtu që synim primar ta ketë kontributin në misionet ndërkombëtare, me njësi që do të përfitonin nga eksperiencia e UÇK-së/TMK-së dhe gjeografia e Kosovës duke u specializuar për deminim dhe luftë në reliev malor. Nëpërmjet PpP-së dhe Kartës së Adriatikut, Kosova do të mund të bashkonte pjesë të ushtrisë së saj me ushtritë e vendeve fqinje, ashtu siç kanë bërë Republika Çeke dhe Sllovakia duke bashkëpunuar me njëra tjetrën. Kosova do të mund të krijonte njësi të përbashkëta dhe të lidhte marrëveshje të përbashkëta me Maqedoninë, Shqipërinë, Malin e Zi e në fund edhe me Serbinë. Rajone të ndryshme të “hartës” së NATO-s po krijojnë grupe luftarake të përbashkëta. Për shembull, është duke u krijuar grupi luftarak Skandinavo-Baltik; dhe NATO do të mund të pëlqente formimin e një grupi luftues të Ballkanit Perëndimor.

2. Idetë e TMK-së

Nga idetë e para, të izoluara, për shndërrimin në një ushtri me 10.000 apo 20.000 pjesëtarë, idetë e udhëheqësve të TMK-së gradualisht i janë përshtatur realitetit të kufizimeve buxhetore dhe bashkëpunimit ndërkombëtar. Në tetor 2005, ish-komandanti Çeku e shpërndau një dokument, “Rruga jonë në NATO”, ku përshkruhej krijimi i një force mbrojtëse nga TMK-ja e që do të ishte plotësisht operacionale pas pesë viteve. Edhe pse “fjalët për forcat ajrore kanë larguar lexuesit e rastësishëm”,²³³ propozimi, në vija të trasha, ishte mjaft i arsyeshëm sa të bëjë disa njerëz në KFOR që ta marrin më seriozisht dhe të sugjerojnë që ai të përpunohet. Oficerë nga Mbretëria e Bashkuar dhe SHBA-ja kontribuan me inputet e tyre, në një grup punues për TMK-në i themeluar në dhjetor 2005. TMK-ja synon që të përpilojë një “libër të bardhë” që përshkruan hapat që duhet ndërmarrë; mbikëqyrësit e organizatës e shohin këtë si një ushtrim që do të shtojë kapacitetet e TMK-së për analiza të organizatës.²³⁴

Një evoluim i dukshëm i TMK-së vërehet në renditjen e prioritetëve në dokumentin e tetorit 2005 dhe në draftin e tanishëm. Mbrojtja e atdheut – prioriteti “më i lartë edhe pse me më së paku gjasa të ndodhë” – ka rënë në vendin e fundit ndërsa në krye të listës është mbështetja e autoritetëve civile, pasuar nga mbrojtja civile, rindërtimi dhe mbrojtja shëndetësore civile (për zonat e largëta); ndihma në funksionimin e shërbimeve elementare dhe të domosdoshme, gjatë emergjencave civile; dhe përkrahja e policisë gjatë trazirave apo shkeljeve tjera të rendit

²³⁰ Shih ISSR Shqyrtimi strategjik i mjedisit, op. cit.

²³¹ Dokument i TMK-së, maj 2006.

²³² “Rruga jonë në NATO”, TMK, 2005.

²³³ Intervistë e Grupit të Krizave me Koordinatorin e TMK-së, gjeneralmajorin Chris Steirn, 28 prill 2006.

²³⁴ Intervista të Grupit të Krizave, Prishtinë, mars-maj 2006.

kushtetues. Detyrat tjera të propozuara, nga lartë poshtë, janë kontributi për sigurinë rajonale dhe pjesëmarrja në operacionet e koalicionit, kontributi në luftën globale kundër terrorizmit dhe detyrat ceremoniale.

Propozimet parashohin një forcë me rreth 3.500 trupa: një brigadë e lehtë me degë shtesë. Boshti i saj do të ishte një brigadë për reagime të shpejta me 1.540 trupa që do të përbëhej nga dy batalione këmbësorie me 513 trupa secila, batalioni i inteligjencës dhe zbulimit (320 trupa) dhe kompania e mbështetjes logjistike me 120 trupa. Kapacitetet ekzistuese të mbrojtjes civile dhe projektet për infrastrukturë do të shndërroheshin në Komandën e Forcave Tokësore me 916 trupa. Komandat e ndara në tri rajone do të mbanin disa nga veçoritë e strukturës me zona mbrojtëse, duke mbajtur lidhjet me komunat, përgjegjësitë për rekrutim, rezervistë dhe “mobilizim kombëtar”. Komandat tjera kryesore do të ishin ajo e trajnimit dhe e doktrinës si dhe ajo për mbështetje logjistike. Elementet tjera, në kuadër të batalionit mbështetës të shtabit qendror do të ishin: policia ushtarake (75 trupa), garda ceremoniale (90) dhe katër helikopterë. Trajnimet graduale, me theks të veçantë në brigadën e reagimit të shpejtë, parashihet të zgjasin deri në vitin 2011.

Disa njësi të propozuara do të mund të reduktoheshin apo të eliminoheshin por do të jetë e vështirë që të krijohet një forcë koherente me më pak se 2.000 apo 2.500 ushtarë. Shpenzimet për paga dhe mirëmbajtje të lokacioneve nuk janë problem aq i madh sa do të ishte blerja dhe mirëmbajtja e pajisjeve, materialit shpenzues dhe karburantit. Helikopterët janë tepër të shtrenjtë, përveç nëse merren si donacione. Por edhe atëherë, shpenzimet për mirëmbajtjen e tyre do të rëndonin buxhetin. Nevoja për mjete transportuese është edhe më e madhe. TMK-ja ka një laramani kamionësh të vjetër të marrë në formë të donacioneve

3. Rreziku i shtëpisë së lënë në gjysmë

Disa propozime për transformimin e TMK-së kanë qenë të rezervuara apo kanë sugjeruar që ajo të mos shndërrohet në ushtri të mirëfilltë. Fjalja në marrëveshjen mes KFOR-it e UÇK-së për demilitarizim që parasheh “krijimin e një ushtrie në Kosovë, që i përngjan Gardës Nacionale të SHBA-së” mund të jetë ndjellakeqe. Një oficer i NATO-s thotë: “Rezervistët zakonisht janë ushtarët më të dobët dhe shpesh kalojnë në sferën e paramilitarëve, gjë që Kosova duhet të evitojë me çdo kusht. Nëse ata mbesin të lidhur fortë me komunitet e tyre atëherë do të jenë më të prirë për politizim dhe korrupsion... dhe do të paraqesin rrezik për këtë shoqëri jostabile”. Ai nënvizon se rezervistët duhet të jenë ushtarë në ushtrinë e ardhshme kështu që për disa vite të mos

mbetet asnjë (rezervist)”.²³⁵ Ka shumë argumente në favor të idesë së centralizimit të ushtrisë në apo afër Prishtinës. Ushtarët duhet të jetojnë me ushtarët dhe duhet të tejkalohej qasja që shihet në TMK ku pjesëtarët e saj udhëtojnë çdo ditë nga shtëpia në kazermë dhe prapa. Kjo do të forconte ndjenjën e përkatësisë, do të zvogëlonte shpenzimet, do të mundësonte mbajtjen e më shumë trajnimeve dhe do të ndihmonte të tejkalohej ndjenja e tashme e pasjes së një force të përbërë nga rrjetet e UÇK-së lojale ndaj një regjioni të caktuar e në të cilat “shefat” lokalë janë më të fortë se sa strukturat zyrtare.

Një masë tjetër që do të ndihmonte të shkëputen lidhjet me botën paramilitare, por që kushton pak më tepër, është që AK-47-shi (Kallashnjikovi) që është armë e përhapur ndër paramilitarët, të zëvendësohet me automatikun amerikan M-16 apo me ndonjë automatik të vendeve të Evropës Perëndimore që janë anëtare të NATO-s. AK-47-shat që përdorë TMK-ja janë nga koha e UÇK-së që KFOR-i ka lejuar të përdoren.

Edhe pse disa kanë propozuar që Kosova të mos ketë më shumë se një xhandarmeri apo një “Gardë Kosovare” që është një koncept i paqartë, këto opsione që në dukje të parë janë më të buta, në anën tjetër janë edhe më problematike. Policia e Kosovës tanimë ka marrë disa role që përndryshe do t'i kryente ushtria, siç janë Njësitë Rajonale për Mbështetje të Operacioneve (ROSU-të) që në të vërtetë kryejnë punën e xhandarmerisë. Nëse nuk lejohet krijimi i ushtrisë, atëherë evoluimi ushtarak do të vazhdonte duke prekur etosin e policisë.²³⁶ T'i japësh TMK-së, apo forcës së re të dalë nga pjesëtarët e TMK-së rol të xhandarmerisë mund të krijojë tepriçë të policisë dhe “luftë” me SHPK-në. Lënë anash krijimin e paradokohshëm të Xhandarmerisë së Evropës, nuk ka standarde të përgjithshme se si duhet të duken këto forca paramilitare ndërsa përvoja me to në Ballkan është tepër e përgjakshme. “Kështu do t'i dërgohej mesazh i gabuar vendeve fqinje”, thotë një zyrtar ndërkombëtar.²³⁷ Në

²³⁵ Intervistë e Grupit të Krizave, 2 shtator 2005.

²³⁶ Gjatë vitit të fundit, UNMIK-u është munduar që ta afrojë SHPK-në me komunitetin serb dhe të theksojë se SHPK-ja është një “shërbim” e jo një “forcë”. Kjo mund të zhbëhet nëse shqiptarët fillojnë ta konsiderojnë atë si mjet për të krijuar ushtri. Rasti më i fundit është ai i Malit të Zi, i cili që prej viteve 1997-1998 ka krijuar një forcë paramilitare me 4.500 pjesëtarë nën vallon e forcës policore, që komandohet nga eprorë ushtarakë profesionistë dhe është e pajisur me autobllinda dhe predha anti-tank. Në shqyrtimin e rolit të policisë në Irlandën Veriore, Raporti “Patten” konkludoi se do të ishte gabim që policisë t'i shtohen njësi të stilit ushtarak dhe se më mirë është që sa herë të ketë trazira të thirret ushtria. Shih (në gjuhën angleze): The Report of the Independent Commission on Policing for Northern Ireland, fq. 48, në: www.belfast.org.uk/report.htm.

²³⁷ Intervistë e Grupit të Krizave, Prishtinë, 31 gusht 2005.

anën tjetër, një ushtri e vogël do të mund të vihej dhe vepror në përputhje me rregullat e NATO-s. Anëtarësia në PpP do të “kyçte forcën në një varg standardesh e kriteresh që nuk do të mund të shkeleshin dhe abuzohen nga politika apo patronazhi vendor”.²³⁸

4. Me apo pa TMK-në?

Madhësia dhe kompetencat e ushtrisë së ardhshme të Kosovës janë gjëra për të cilat mund të arrihet një pajtim mes të gjithëve; më e vështirë është se prej nga të fillohet me krijimin e ushtrisë së re. TMK-ja mendon se duhet filluar prej saj. Zyrtarët e NATO-s në Bruksel preferojnë të fillohet prej zeros ndërsa pjesëtarët e TMK-së të aplikojnë për vende në ushtrinë e re. Kjo nuk ndodh aq shumë për shkak të asaj se sa pjesëtarë të TMK-së do të jenë në forcën e re – sipas tyre do të jenë mes 700 e 1.500 – por më shumë ka të bëjë me vet idenë e TMK-së. A është TMK-ja një organizatë që funksionon mirë apo një strukturë jofunksionale dhe e korruptuar? Në të vërtetë, ka nga pak prej këtyre të dy skajeve, edhe pse në dy vitet e fundit ka treguar tendencë që të zhvillohet në organizatë funksionale. Pikë tjetër është nëse ushtria e re duhet të jetë vazhdim i evoluimit të UÇK-së apo ajo duhet të ketë rrënjë më të gjëra dhe, teoritikisht, të bëhet më e lehtë për serbët që të anëtarësohen në të. Megjithatë, asgjë nuk mund të bëhet pa pasur pajtimin e shqiptarëve të Kosovës dhe TMK-së si dhe NATO-s, përfshirë këtu edhe donatorët e mundshëm.

Nevojiten resurse të mëdha dhe shtim të kapaciteteve që të mund të fillohet. Së pari do të duhej bërë demobilizimin; pensionimin apo risistemimin në shoqëri të 1.500 deri 2.400 pjesëtarëve aktivë të TMK-së. Një pilot-projekt i financuar me 400.000 euro nga Mbretëria e Bashkuar që synon të ndihmojë largimin nga forca të 80 eprorëve të lartë apo të atyre që janë mbi 55 vjeçar dhe të hapet rruga për risistemizim dhe pensionim është shtyrë për një vit derisa UNDP-ja të gjejë më tepër fonde.²³⁹ Pa resurse tjera, demobilizimi nuk mund të vazhdohet. Projekti është ndalur në korrik 2006 pasi shumë pak janë paraqitur vullnetarisht për demobilizim. Pjesëtarët e TMK-së presin ose mundësi të reja në kuadër të transformimit të TMK-së ose presin që qeveria e Kosovës të dalë më propozimet për skemën e pensionimit të pjesëtarëve të TMK-së. Ligji për pensionet për invalidët dhe familjet e dëshmorëve të UÇK-së, i miratuar nga OKB-ja e që do të fillojë të zbatohet nga janari 2007, e lidhë krijimin e shtetit të Kosovës me UÇK-në dhe ngarkon financiarisht buxhetin e vendit.

Struktura e IOM-së që ofroi trajnime për zanate apo përkrahje për vet-punësim të 11.000 ish-pjesëtarëve të UÇK-së, në vitet 2000-2001 vonoi disa muaj të fillojë të punojë ndërsa pas këtyre viteve është ndërprerë. Trajnimet nuk i ishin përshtatur kërkesave të tregut.²⁴⁰ TMK-ja është shumë e ndjeshme sa i përket kualitetit të kësaj skeme që do të ofrohet dhe pret që qeveria e Kosovës të marrë iniciativën dhe të ndërmjetësojë mes tyre dhe bashkësisë ndërkombëtare:

Risistemimi nuk mund të bëhet ashtu siç u veprua me UÇK-në në vitin 1999, kur nuk kishte as qeveri, as buxhet, as Kuvend për të miratuar ligje. Tash është kohë tjetër. Paradoksi qëndron në atë se ndërkombëtarët po vepron sikur në vitet 1999 e 2000. Në vend se të punojnë me qeverinë ashtu që ata të miratojnë ligjin për risistemim, ata po bëjnë presion të drejtpërdrejtë mbi TMK-në... Por ne nuk kemi çfarë t'u ofrojmë pjesëtarëve tonë. Ka kaluar koha kur kjo ka mundur të bëhet pa kriterë. Tani Kosova ka një strukturë institucionale; ndërkombëtarët duhet të punojnë me institucionet.²⁴¹

Përvoja nga Serbia dhe Kroacia tregon se megjithatë është më mirë që një organizatë ndërkombëtare me përvojë, siç është IOM-i të bëjë risistemimin. Organizatat vendore ka shumë gjasa që të korruptohen.²⁴²

Trajnimet për ushtrinë kërkojnë vendimet strategjike për modalitetet dhe financimin. Kjo punë do të zgjaste së paku pesë vite dhe për kryerjen e saj do të mund të kontraktuhej një kompani private apo të bëhej nga një ekip i NATO-s apo KFOR-it. Opsioni i dytë është më i mundur. Pyetjet tjera janë se sa mund të përdoren infrastruktura dhe stafi trajnues ekzistues i TMK-së, eprorët e lartë dhe trupat në përgjithësi. Kush do të ketë në dorë ushtrinë e ardhshme? Procesi në përgjithësi nuk mund të fillojë derisa NATO, qeveria e Kosovës dhe TMK-ja nuk dakordohen rreth planit për seleksionim dhe trajnim dhe derisa fondet të mos jenë në dispozicion.

5. Mes shpërbërjes dhe transformimit

Që nga Marrëveshja për demilitarizim dhe transformim e vitit 1999,²⁴³ NATO vë theksin në demilitarizim ndërsa TMK-ja në transformim. Kur i caktoi standardet që duhet të plotësojë TMK-ja, bashkësia ndërkombëtare u fut në një transaksion tjetër nga i cili nuk pritej shumë por në të

²³⁸ Intervistë e Grupit të Krizave me stafin e Zyrës së Koordinatorit të TMK-së, Prishtinë, 31 gusht 2005.

²³⁹ Intervista të Grupit të Krizave me stafin e zyrën e Koordinatorit të TMK-së, Prishtinë, gusht 2005-qershor 2006.

²⁴⁰ Shih “Wag the Dog”, op. cit.

²⁴¹ Intervistë e Grupit të Krizave me zëdhënësin e Zonës së Tretë Mbrojtëse të TMK-së (Dukagjin), Pejë, 1 qershor 2006.

²⁴² Intervistë e Grupit të Krizave me një analist të mbrojtjes, Beograd, 24 korrik 2006.

²⁴³ Shih fusnotën 6.

cilin TMK-ja është treguar shumë më e mirë se që është pritur. Në maj 2006, PSSP-ja Jessen-Petersen për të, kishte thënë: “Në të gjitha fushat ka përparim impresiv në vazhdimësi ndërsa ju jeni institucioni që prinë dhe që është model për implementimin e standardeve tjera”.²⁴⁴ Raportimi i fundit i UNMIK-ut në Këshillin e Sigurimit, më 20 qershor 2006, për TMK-në ka pasur vetëm fjalë të mira.²⁴⁵ Pëshpërimat që vijnë nga Brukseli për shpërndarjen e TMK-së janë veçanërisht të dhimbshme sepse duket se nuk marrin parasysh përpjekjet e saj që t’i bëjë gjërat mirë dhe duket se NATO po i trajton si mëkatarë.

Nëse do të themelohet ushtria e Kosovës, atëherë janë tri raporte që ajo mund të ketë me TMK-në:

- Të mos ketë raporte fare: TMK-ja shpërbëhet ose rekrutimi për ushtrinë e re bëhet jashtë TMK-së, pa ndonjë program se si të aplikojnë pjesëtarët e saj;
- Të filtrohet TMK-ja dhe pjesëtarët e saj që plotësojnë kriteret të emërohen në poste në ushtrinë e re, ndërsa pjesa tjetër e pjesëtarëve të ushtrisë së re të merren nga jashtë TMK-së. TMK-ja ose do të zhdukej ose do të mbetet organizatë e tepërt që pret një program për risistematizim; dhe
- Transformimi i thjeshtë i TMK-së në ushtri të re, me apo pa filtrim të pjesëtarëve të saj.

Opsioni i dytë duket më praktik dhe i vetmi që ka gjasa të pranohet nga bashkësia ndërkombëtare dhe nga shqiptarët. Kjo do të evitonte edhe grackën e ri-gradimit të rangjeve të TMK-së.

6. Gjetja e “brumit” të duhur

Krijimi i një ushtrie që do të paraqiste identitetin jo-etnik të Kosovës do të jetë më i lehtë nëse punohet paralelisht me pritjet e shqiptarëve e të TMK-së në vend se të punohet në kundërshtim me to. Nëse TMK-ja është pikënisje, ajo do të pranojë verifikimin nga ana e NATO-së të pjesëtarëve që dëshirojnë të kenë vend të organizatën e transformuar. Një e treta deri gjysma e pjesëtarëve të tashëm do të pranonin risistematizimin apo pensionimin nëse donatorët dhe qeveria e Kosovës dalin me një paketë adekuate të risistematizimit dhe pensionimit; 1.500 deri 2.000 të tjerët do të provonin të kualifikoheshin që të mbesin në forcë. Përveç testeve, NATO do të mbante

të drejtën edhe të refuzojë ata për të cilët dyshon se janë të përfshirë në aktivitete të dyshimta, si për shembull ata që KFOR-i kërkonte që Çeku t’i suspendonte në vitin 2003.

Nga ky proces do të mbesin mes 700 e 1.000 pjesëtarë që do të bëheshin pjesë e forcës së re. Planet e TMK-së, të përpiluara me këshillat e KFOR-it, janë një rast tjetër për NATO-n që t’u japë formën e duhur gjërave. Këto plane parashohin që dy komponentet kryesore të jenë komanda e forcave tokësore me 916 trupa që do të kryejë detyrat që tani ka TMK-ja dhe brigada e këmbëtorisë me 1.600 trupa, kështu që NATO do të mund të caktonte shumicën e “të mbijetuarve” të TMK-së në komandën apo brigadën e parë. Në të vërtetë, numrat e të dy komponentëve – sidomos të këmbëtorisë – do të mund të ishin më të vegjël. Në fund, 500 apo më pak pjesëtarë të TMK-së do të mund të caktoheshin në elementin e këmbëtorisë ndërsa vendet tjera do të mbeteshin të hapura për rekrutët e rinj.

Sikur në rastin e SHPK-së, simbolet dhe distinktivët do të mund të ishin etnikisht neutralë. Shtabi i përgjithshëm i TMK-së qysh tani është duke punuar në dizajnimin e tyre. Uniforma e tashme e TMK-së është në thelb uniforma e UÇK-së kështu që duhet të zëvendësohet. Gjuha në simbole do të ishte ajo angleze që do të promovonte identitetin e ushtrisë jashtë vendit që synon bashkëpunimin rajonal dhe pjesëmarrjen në misionet ndërkombëtare. Derisa aktivitetet civile të TMK-së, të inxhinierisë dhe rindërtimit, do të mund të vazhdoheshin, detyrat e ushtrisë së re në sferën e sigurisë brenda Kosovës do të minimizoheshin, përsëri duke mbajtur vëmendjen në projektet jashtë vendit.

Donatorët dinë të jenë neglizhencë kur është fjala për financimin e multi-etnicitetit. Me paga prej 500 eurove në muaj Serbia e ka shumë më lehtë të fitojë lojalitetin e mësuesve dhe mjekëve serbë në Kosovë se sa IPVQ-ja që paguan 200 euro në muaj. Buxheti për pagat në ushtri do të ketë rol të madh në përcaktimin e atyre që do të rekrutohen dhe të mbahen në forcë si dhe në shkallën e multi-etnicitetit. Shumica e pjesëtarëve të TMK-së marrin rreth 200 euro në muaj, që është paga mesatare në shërbimet publike në Kosovë, por që është pagë e vogël dhe me të cilën vështirë jetohet. Në rajonet më të varfra siç janë Deçani, Drenica apo Mitrovica mundësitë për punësim janë më të vogla por në vendet si Prishtina qëndrimi në TMK nga pjesëtarët e saj shihet si sakrificë. Nëse pagat në ushtri do të mbesin të ulëta, atëherë shumica e rekrutëve do të vijnë nga zonat më të varfra me mentalitet më luftarak si dhe do të duhej bazuar më tepër në stoicizmin dhe përkushtimin e pjesëtarëve të tashëm të TMK-së.²⁴⁶ Nëse pagat nuk janë dukshëm më të mëdha

²⁴⁴ Komunikata për shtyp e UNMIK-ut numër 1556 (në gjuhën angleze) “KPCDG congratulates KPC on efforts to reach out to ethnic minorities”, 31 maj 2006.

²⁴⁵ Shih (në gjuhën angleze) “Report of the Secretary General on the United Nations Interim Administration Mission in Kosovo”, S/2006/361, 5 qershor 2006, në: www.un.org/Docs/sc/sgrep06.htm.

²⁴⁶ Dorën në zemër, disa nga këta janë ushtarët më profesionistë që ka Kosova, së paku në mesin e shqiptarët.

atëherë një numër krejt i vogël i të rinjve urbanë e të arsimuar shqiptarë dhe një numër krejt i vogël i serbëve do të kërkojnë vend në ushtri.

7. Përfaqësimi i interesave të Serbisë

Me fillimin e procesit për statusin final, deklaratat e Serbisë janë përqendruar në heqjen e ushtrisë nga ekuacioni. Në një takim me komandantin e NATO-s për Evropën Jugore, në janar 2005, kryetari Tadiq është shprehur: “Krijimi i një ushtrie të re në një shtet të pavarur të Kosovës e Metohisë, që në një afat më të gjatë do të ishte armiqësore ndaj Serbisë e Malit të Zi, do të ishte absolutisht e papranueshme për stabilitetin dhe do të destabilizonte rajonin”.²⁴⁷ Duke elaboruar konceptin e Beogradit “më tepër se autonomi, më pak se pavarësi” në maj 2005, këshilltari i kryeministrit Koshtunica, Aleksandar Simiq, qartësoi se Kosova nuk duhet të ketë ushtri të sajën, dogana apo kontroll të plotë monetar.²⁴⁸ Në shtator 2005, shefja e Qendrës Koordinuese, Sanda Rashkoviç-Iviq, me më shumë zgjuarsia propozoi që Kosova të demilitarizohet që të pengohet formimi i formacioneve paramilitare si dhe të largohet frika e shqiptarëve se forcat serbe do të mund të ktheheshin.²⁴⁹ Në maj 2006, negociatori Leon Kojen, parashikoi “demilitarizimin gradual të brendshëm” të Kosovës, pa forca serbe apo shqiptare dhe “veçanërisht pa organizata paramilitare”. I vetëdijshëm se policia mund të ishte rrugë drejt ushtrisë, kërkoi që numrat e policisë, përbërja dhe pajisjet e saj të jenë “në përputhje me standardet evropiane”.²⁵⁰

Rreth asaj se a duhet të ketë Kosova ushtri ka pak gjasa që Prishtina e Beogradi të pajtohen. Mangësitë e një “shtëpie të lënë në gjysmë”, të një force me mandat të paqartë dhe të stilit paramilitar janë diskutuar më lartë. Vendimi i bashkësisë ndërkombëtare për këtë çështje duhet të jetë në përputhje me vendimin fundamental për të ndarë Kosovën nga Serbia, duke e njohur si shtet të pavarur. Të marrësh një vendim që bie ndesh me këtë është opsion më destabilizues që do të ushqejë dhe zgjasë mosnjohjen e Kosovës nga Serbia dhe do ta inkurajonte atë që të marrë hapa më të guximshëm. Nëse Kosova bëhet pjesë e organizatave dhe proceseve rajonale, evropiane dhe

multilaterale, përshtirë edhe ato të sferës së sigurisë dhe ushtarake, do të jetë më e vështirë për Serbinë që të mos e njoh këtë vend.

Për Serbinë kjo është tepër simbolike dhe ka të bëjë me vet ndjenjën e saj të identitetit. Edhe pse nuk dëshiron të sundojë më mbi shqiptarët, qasja e saj ndaj statusit final ishte në kërkim të formulës shumëvalente për shpëtimin e fytyrës dhe që do t'i lejonin të mbante sovranitetin formal. Pasja e një ushtrie në Kosovë e bën këtë të pamundur dhe do t'i vinte vulën e disfatës përpjekjeve të saj. T'i kufizohet Kosovës që të ketë vetëm forcë policore do t'i mundësonte Beogradit që në mënyrë retrospektive të shënojë fitore të kufizuar. Megjithatë, kalkulimet e Serbisë për çështjet e sigurisë janë të cinguara për shkak të mungesës së njohurive dhe interesimit për mënyrën si vepron shoqëria shqiptare në Kosovë: “Kemi vetëm një apo dy libra për këtë çështje”,²⁵¹ “që nga viti 1912, ushtria jonë ende nuk e ka kuptuar Kosovën; kjo na ka sjellë një shekull të tërë të gabimeve”.²⁵² Plani i Serbisë për demilitarizimin e Kosovës do të mund të provokonte mu atë që ajo i frikësohet – shtimin e grupeve paramilitare shqiptare.

Megjithatë, janë katër fusha në të cilat mund të bëhet kompromis në çështjen e ushtrisë: kufizimi i numrave dhe kompetencave; reduktimi apo eliminimi i trashëgimisë së UÇK-së; shtyrja e aktivizimit; dhe dhënia NATO-s një rol të madh në krijimin dhe udhëheqjen e saj. Kjo duhet të bëhet me kujdes: nëse teprrohet me kompromise kjo do të shkaktonte kundërefekt në Kosovë dhe do të inkurajonte Beogradin. Për më tepër, nëse Serbia mban qëndrimin e tashëm – ose të gjitha ose asgjë – atëherë asnjë nga këto kompromise nuk do t'i duket tërheqëse derisa të mos përcaktohet statusi final.

Ndonëse në Beograd ka shumë pak prej atyre që janë të gatshëm të flasin për pavarësinë e Kosovës e lëre më ushtrinë e saj, ata që flasin për këtë thonë se “ushtria është prerogativ i shtetit, por frika dhe shqetësimet e fquinjëve duhet gjithashtu të merren parasysh”. Ata parashohin një forcë profesionale me 3.000 deri 4.000 trupa, “pa forca ajrore apo tanke dhe nën kontroll të fuqishëm të forcave

²⁴⁷ Shih (në gjuhën angleze) “President Tadic: Army of independent Kosovo to destabilize region”, agjencia e lajmeve FoNet, 24 janar 2005.

²⁴⁸ Fjalim i mbajtur në konferencën: “Assessing Developments in the Western Balkans: Problems of Today, Ideas for the Future”, Bratisllavë, 20-21 maj 2005, përmbledhje në: www.sfpa.sk/dok/2005-06-21-ConferenceSummary.doc.

²⁴⁹ “Srbiji suverenitet, Kosovu izvrsna, zakonodavna i sudska vlast” (Serbisë sovranitetin, Kosovës pushteti ekzekutiv, ligjvënës dhe gjyqësor), *Danas*, 22 shtator 2005.

²⁵⁰ Përmbledhja e mediave “VIP Daily News”, 31 maj 2006.

²⁵¹ Intervistë e Grupit të Krizave me dr. Zoran Dragishiq, Fakulteti i mbrojtjes civile, Universiteti i Beogradit, 12 maj 2006. Shih edhe komentimin e historianit Predrag Markoviç në *Vecernje Novosti*, 15 korrik 2006: “A e dini sa akademikë serbë flasin shqip? Asnjë... Nëse shqiptarët e Kosovës janë aq problem i madh, atëherë pse të diturit e Serbisë nuk janë munduar t'i njohin ata më mirë?... Qëndrimi nënçmues nuk na ka lënë t'i shohim proceset që po zhvilloheshin atje, derisa nuk u bë vonë. Çfarëdo që të jetë zgjidhja për Kosovën, ne duhet t'i njohim shqiptarët më mirë”, 17 korrik 2006.

²⁵² Intervistë e Grupit të Krizave me Aleksandër Radiq, redaktor i çështjeve të mbrojtjes dhe sigurisë në shërbimin “VIP News”, Beograd, 13 maj 2006.

ndërkombëtare për një periudhë më të gjatë”.²⁵³ Në diskutimet me zyrtarë perëndimorë, komandanti i ushtrisë pranon, ndonëse “ndër dhëmbë”, se një ushtri profesionale në Kosovë, nën tutelën e NATO-s, është opsion më i mirë se sa alternativa ilegale, paramilitare.²⁵⁴ Të tjerë që pranojnë pavarësinë megjithatë insistojnë që Kosova të ketë vetëm polici.²⁵⁵ Sa vështirë e ka bashkësia ndërkombëtare të kuptojë shqetësimet rajonale mund të shihet në hutinë e një oficeri perëndimor, që pyeste: “nëse Serbia vërtetë e kupton PpP-në, atëherë nuk ka pse të kundërshtojë një vend tjetër të PpP-së në jug të saj?”²⁵⁶

Caktimi i kufijve formalë në numra dhe kompetenca mund të jetë pjesë e vendimit të përgjithshëm për statusin. Edhe pse struktura e tashme e bisedimeve si dhe qëndrimet e Beogradit dhe Prishtinës e bëjnë gati të pamundur që kjo të bëhet subjekt i negociatave të drejtpërdrejta, që të dyja palët duhet të obligohen që sa më parë të jetë e mundur të vejnë në letër konceptet e tyre për strukturat vendore të sigurisë në Kosovë. Më pas duhet të shtrohen pyetje më të detajizura, të maten qëndrimet, siç është bërë me decentralizimin, pronën dhe borxhet dhe me të drejtat e komuniteteve.

Pasi që do të jetë Grupi i Kontaktit e jo Emisari Special i Sekretarit të Përgjithshëm për procesin e statusit (ish-kryetari i Finlandës, Martti Ahtisaari²⁵⁷), ai që do të përcaktojë dhe definojë qështjet e sigurisë në marrëveshjen për statusin final,²⁵⁸ atëherë ose Grupi i Kontaktit ose – pasi t’ia delegojë këtë – NATO do të mund të përpilonte një letër, një aneks apo një vendim në një formë legalisht apo politikisht obliguese që do t’i shtohet marrëveshjes për statusin final, duke caktuar pragun e sipërm të numrave dhe kompetencave të forcës ushtarake vendore, që do të sillëshin rreth atyre të planifikuar: jo më shumë se 3.000 trupa, pa tanke, pa artileri të rëndë, pa predha tokë-tokë dhe pa fluturake sulmuese. Kjo do të kënaqte edhe aspiratat e Prishtinës edhe garancat që kërkon Beogradi që Kosovën të mos e konsiderojë kërcënim. Restriksionet do të ishin të kufizuara në kohë (ndoshta dhjetë apo njëzet vite) apo, çka do të ishte edhe më mirë, do të lidheshin me anëtarësimin e Kosovës dhe Serbisë në PpP: që do të ishte kohë e mjaftueshme që qëndrimet të pihen në një anë dhe në anën tjetër sovraniteti të mos mbetet i cunuar përgjithmonë.

²⁵³ Intervistë e Grupit të Krizave me një analist të mbrojtjes, Beograd, 12 maj 2006.

²⁵⁴ Intervistë e Grupit të Krizave me një zyrtar perëndimor për qështjet e mbrojtjes, 19 korrik 2006..

²⁵⁵ Intervista të Grupit të Krizave me Goran Svilanoviqin, 11 maj 2006, dhe me një zyrtar të lartë, qershor 2006.

²⁵⁶ Intervistë e Grupit të Krizave, Prishtinë, 28 prill 2006.

²⁵⁷ Zyra e Ahtisaarit e pëlqen shumë akronimin UNOSEK.

²⁵⁸ Intervistë e Grupit të Krizave me një zyrtar të NATO-s, Bruksel, 24 korrik 2006.

Një letër apo aneks i tillë do të paraqiste pranim nga ana e NATO-s të interesave të Serbisë në qështjet e sigurisë dhe jo marrëveshje formale me Beogradin. Do të ishte e dëshirueshme që Serbia të kënaqet me faktin që ka mundur të negociojë pragun e sipërm të ushtrisë së Kosovës dhe prezencën e vazhdueshme të NATO-s, por nëse mbetet në pozicionet që mban tani do ta humbasë edhe këtë rast.

8. Respektimi i traditës

Përveç bashkëpunimit me KFOR-in, e vetmja përvojë tjetër ushtarake e përbashkët për shqiptarët e serbët është ish-APJ-ja, imazhi i të cilës ndryshoi dramatikisht në vitet e 90-ta, kur edhe u transformua në ushtri serbe. Rekrutimet e shqiptarëve u ndërpre në vitin 1991. Shqiptarët e shohin UÇK-së dhe pasardhësen e saj, TMK-në, si mbrojtëse të tyre, ndërsa serbët APJ-në (dhe MUP-in) si mbrojtës të tyre. Serbët e Kosovës kanë traditën e tyre të rezistencës e realizuar nëpërmjet Rojeve të Urës gjysmë-të-ndaluar dhe rezervistët e ish-APJ-së që tani kanë formuar një milici mbrojtëse.²⁵⁹ A mundet ushtria e re ta tejkalojë këtë ndarje? Pasi serbët në veri sipas të gjitha gjasave do të refuzojnë të inkorporohen në institucionet qendrore, një alternativë mund të jetë që të lejohet rekrutimi i njësive kryesisht serbe në këtë pjesë, hap ky që vetëm sa do të thellonte ndarjen e madje do të mund të shpinte edhe në përleshje përbrenda ushtrisë, apo që të pranohet se rekrutimi i serbëve do të jetë i vogël në numër, së paku në vitet e para. Ata që hyjnë në forcë do të mund të avancoheshin që të kompensohet numri i paktë i tyre, ndërsa në ndërkohë do të rekrutoheshin një numër më i madh i pakicave tjera të Kosovës – boshnjakë, turq, romë, ashkalinj, egjiptianë – që të ruhet njëfarë multi-etniciteti.

Si do që të jetë, NATO nuk mund t’i lejojë qeverisë së Kosovës që të bëjë çfarë të dojë me ushtrinë. Programi i standardeve është përqendruar më tepër në përpjekjet se sa në vet rezultatet. Kur të vlerësojë gatishmërinë e Kosovës për anëtarësi në PpP, NATO duhet të shikojë rezultatet. Kjo do të kërkojë më tepër kreativitet politik të liderëve të Kosovës, e jo vetëm “të ngjyrosen numrat”. Nëse ushtria e re absorbon traditën e UÇK-së nëpërmjet TMK-së, atëherë ajo duhet të absorbojë edhe disa nga traditat e serbëve të Kosovës. Përndryshe do të kemi një asimetri të padrejtë ndërsa individët serbë që do të rekrutohen do të njolloosen dhe do të konsiderohen nga komuniteti i tyre si kolaboracionistë. Nuk është reale që të pritet gatishmëri e lartë e serbëve që të bëhen pjesë e ushtrisë menjëherë, por procesi pesëvjeçar i rekrutimit

²⁵⁹ Shih (në gjuhën angleze) “Kosovo Serbs recruit ex-soldiers for defence” (Serbët e Kosovës rekrutojnë ish-luftëtarët për t’u mbrojtur), agjencia Reuters, 20 qershor 2006; intervista të Grupit të Krizave, Mitrovicë dhe Washington, SHBA.

dhe trajnimit për komandën e këmbësisë mund të jetë një rast për t'i bërë ata për vete, dikur më vonë. Atëherë, rrethanat ndodh të jenë të favorshme që ministria e drejtësisë të ftojë grupe të Rojave të Urës apo të milicive për vet-mbrojtje që të aplikojnë për poste në ushtri, njësoj sikur që pjesëtarët e UÇK-së dhe MUP-it janë ftuar që të aplikojnë për anëtarësim në SHPK në vitet 1999-2000 dhe 2003-2006.

Pasi duhej një fillim i ri për forcën e sigurisë që identifikohet me njërin nga grupet etnike në konfliktin e Irlandës Veriore, raporti i Pattenit e konsideronte si të dëmshëm vendimin që të shpërndahet "Royal Ulster Constabulary" (forca e sigurisë e Mbretërisë së Bashkuar) por rekomandoi që ajo të ndërrojë emrin, të krijojë simbole të reja dhe gradualisht të ndërrojë raportin ndër personelit të saj.²⁶⁰ Kështu edhe ushtria e Kosovës duhet të absorbojë identitetin e UÇK-së por të jetë mjaft e gjerë që të inkorporojë edhe identitetet tjera. "Në TMK, UÇK-ja u bë më e civilizuar, më e disiplinuar dhe më e butë. Puna është kryer", thotë një nga komandantët e saj më radikalë.²⁶¹ TMK-ja është e gatshme që të lëshohet në duart e NATO-s për riorganizim, "madje edhe nëse vetëm dhjetë pjesëtarë të saj ia dalin të hyjnë në forcën e re".²⁶² Eprorët e saj e pranojnë se ende janë vetëm në gjysmë të rrugëtimit për t'u bërë ushtarë profesionist, ndërsa përpara kanë sfida edhe më të mëdha. Ata gjithashtu janë të vetëdijshëm se bashkëpunimi me NATO-n dhe trajnimet e ofruara nga ta, janë e vetmja rrugë drejt suksesit. Ajo që nuk pranojnë të bëhet është që të "fshihet historia", që TMK-ja të mos pranohet si pikënisje e ushtrisë së re.²⁶³ Do të ishte për tu habitur nëse NATO nuk merr parasysh dhe nuk shfrytëzon gatishmërinë e TMK-së që të ndërrojë: caku është i njëjtë vetëm se rrugëtimi do të jetë më i lehtë.

Që nga maji 2006, jozyrtarisht, zyrtarët e NATO-s janë duke thënë se: "TMK-ja duhet të shpërndahet. Është jofunksionale dhe bartë shumë bagazh nga e kaluara".²⁶⁴ Por, kjo nuk është rezultat i vlerësimeve se çfarë do të funksiononte më mirë në terren por më parë është përpjekje për të pajtuar pikëpamjet e ndryshme të anëtarëve të NATO-s: "Bashkësia ndërkombëtare nuk është e hapur ndaj idesë që TMK-ja të bëhet ushtri... më

shumë do të përkrahej krijimi nga zeroja i një force tjetër të sigurisë, profesionale dhe me kritere të qarta".²⁶⁵

Nga distanca, kjo qasje radikale mund të duket atraktive. Ndërsa në terren më shumë ka gjasa që kjo të marrë kundërpërgjigje duke nxitur pakënaqësi dhe duke dështuar që të krijojë një institucion të qëndrueshëm e gjithëpërfshirës. Një ushtri e krijuar kështu mund të mos gëzojë lojalitetin as të shqiptarëve e as të serbëve, duke lënë forcat private paralele si instrumente të preferuara. Është vonë që Kosova të dizajnohet nga fillimi, sikur institucionet e tashme të mos ekzistonin. "Miq të tonë po e dizajnojnë Kosovën në kompjuterët e tyre... Kosova nuk është një lodër", thotë një oficer i TMK-së në Pejë.²⁶⁶ Një komandant zone që njihet si më i moderuar tmerrohet nga ideja që vite të tëra të zhvillimit mund të humben: "Çfarëdo zgjidhjeje që nuk merr parasysh realitetin do të prodhojë krizë... Njerëzit nuk do të aplikojnë që të bëhen pjesë e ushtrisë së re nëse e dinë se TMK-ja do të shuhet".²⁶⁷ Një tjetër komandant zone thotë se ai do t'u bënte thirrje shqiptarëve që të mos i bashkohen një ushtrie të tillë.²⁶⁸ Një diplomat në Prishtinë shpreh shqetësimin se flakja e TMK-së do të ishte ofenduese dhe jopraktike: "Nuk duhet të veprojmë në kundërshti me atë që presin kosovarët. TMK-ja është e respektuar dhe e disiplinuar".²⁶⁹

9. Dobitë e shtyrjes së kësaj pune

Një ide që qarkullon ndër zyrtarët ndërkombëtarë është që të caktohet një vonesë prej tri deri në pesë vite pasi të caktohet statusi i Kosovës për të filluar formimi i një ushtrie dhe gjatë kësaj periudhe TMK-ja të mbetet.²⁷⁰ Në këtë mënyrë, leja dhe ndihma e bashkësisë ndërkombëtare për aspiratat ushtarake të Kosovës mund të lidhet me implementimin e mirëfilltë të provizioneve të marrëveshjes për statusin final, veçanërisht kur është fjala për trajtimin e pakicave, duke i dhënë kështu bashkësisë ndërkombëtare leva shtesë në shtetin e ri. Vonesa mund të sjellë dobi edhe duke dhënë më tepër kohë edhe për ndërveprim politik më dinamik mes shqiptarëve e serbëve, për krijimin e një elite me më shumë njohuri për

²⁶⁰ Shih (në gjuhën angleze) "The Report of the Independent Commission on Policing for Northern Ireland", op. cit., fq. 99.

²⁶¹ Intervistë e Grupit të Krizave, 16 maj 2006.

²⁶² Intervistë e Grupit të Krizave me një Komandant Zone të TMK-së, 31 maj 2006.

²⁶³ Intervista të Grupit të Krizave, maj dhe qershor 2006.

²⁶⁴ Intervistë e Grupit të Krizave, 8 maj 2006.

²⁶⁵ Burime diplomatike anonime, Bruksel, të cituara nga Augustin Palokaj, "TMK-ja nuk mund të jetë ushtri e Kosovës", *Koha Ditore*, 19 maj 2006.

²⁶⁶ Intervistë e Grupit të Krizave, 1 qershor 2006.

²⁶⁷ Intervistë e Grupit të Krizave, 19 maj 2006.

²⁶⁸ Intervistë e Grupit të Krizave, 1 qershor 2006. Komandanti i një Zone tjetër, megjithatë shprehet se: "Nëse mendojnë se për strukturën e re mund të gjejnë pjesëtarë të ri që janë më pakë patriotë, e kanë shumë gabim". Intervistë e Grupit të Krizave, 31 maj 2006.

²⁶⁹ Intervistë e Grupit të Krizave, 24 maj 2006.

²⁷⁰ Shih komentet e një zyrtari të UNOSEK-ut, të raportuara nga Leonard Kerquki, "Shpërblim për përmeshjen e standardeve!", *Lajm*, 25 maj 2006.

sigurinë dhe për inkorporimin e konceptit të sigurisë humane. Përvoja e ISSR-së mund të ndihmojë në këtë.

Por vonesa mund të kuptohet edhe si anashkalim. Do të jetë qenësore mënyra si bëhet kjo vonesë. A do të jetë pjesë e një programi pro-aktiv, të qartë e me orar të caktuar për ndërtimin e kapaciteteve shtetërore, apo do të jetë mbulesë për moskuptim të marrëdhënieve mes shqiptarëve e serbëve, për mosangazhim dhe pranim të heshtur të shtetit gjysmë-të-dështuar të Kosovës? Vonesa nuk do t'i kontribuojë stabilitetit nëse periudha e ndërmjetme nuk shfrytëzohet për të riorganizuar TMK-në, për të trajnuar elementët e ushtrisë së ardhshme dhe nëse nuk krijohen kapacitetet për politika të mbrojtjes si dhe nëse nuk krijohet vet ministria e mbrojtjes. Madje edhe implementimi i një plani të dakorduar do të kërkonte afate të gjata për finalizimin e detajeve të misionit trajnues të NATO dhe vendosjes së tij, për gjetjen e donatorëve, për filtrimin e TMK-së dhe caktimit të atyre që do të mbesin dhe atyre që do të risistematohen si dhe për riorganizimin e mëtutjeshëm. Koha më e afërt për arritjen e operacionalitetit të plotë ushtarak do të ishte së paku pesë vite. Kështu, gjatë tërë kësaj kohe elementi këmbësorik i ushtrisë që do të jetë në fazën e trajnimit do të ishte i mbyllur në kazerma dhe në lokacionet për trajnim dhe nuk do të kishte prezencë operacionale në rrugë.

Vonesa në formimin e ushtrisë do të ishte veçanërisht problematike nëse do të kombinohej me shpërndarjen e menjëhershme të TMK-së. Dokumenti (non-paper) i Universitetit të Mbrojtjes Kombëtare i SHBA-së ka propozuar kohën kalimtare prej 180 ditëve mes shpërndarjes së TMK-së dhe rekrutimit për forcën e re. Disa anëtarë të Grupit të Kontaktit do të preferonin që kjo kohë kalimtare të jetë disa vite – apo e pacaktuar në kohë. Edhe pse disa qeveri, si ajo e Gjermanisë, shprehin besimin e plotë se KFOR-i mund të pengojë krijimin e çfarëdo vakumi në siguri,²⁷¹ kjo nuk është edhe aq reale. KFOR-i është tepër i madh dhe i ngathtë që të luajë rolin që ka TMK-ja dhe të kënaqë aspiratat që përcjellin atë. Aktorë vendorë të padëshirueshëm do të nxitonin që të zënë hapsirën e krijuar, që do të mbetej e lirë pas shpërbërjes së TMK-së.

V. KONKLUZION

Demilitarizimi i plotë në Kosovë është i pazbatueshëm. Nuk ka mjaft besim ndër palët që demilitarizimi të jetë i qëndrueshëm. Do të bëhej një fasadë prapa së cilës do të fshiheshin grupet e armatosura jozyrtare që do ta bënin vendin më pak të sigurt. Një ushtri e vogël, e zhvilluar nën mbikëqyrjen e NATO-s, është zgjidhja më e mirë edhe për demilitarizimin gradual të shoqërisë e edhe për të futur Kosovën në marrëveshjet rajonale për siguri. Kjo e fundit është thelbësore për demilitarizim të qëndrueshëm dhe siguri rajonale.

Pothuajse të gjitha shtetet kanë ushtritë e tyre. Nëse nuk i kushtohet vëmendje shtyllës së sigurisë, atëherë shteti do të jetë i dobët. Kosova ka tepër shumë mangësi institucionale e strukturore që e pengojnë suksesin e saj. Të kthesh popullaritetin, autoritetin dhe profesionalizmin gjithnjë në rritje të TMK-së në një institucion të përhershëm të sigurisë do t'i ndihmonte shtetit të ri. Nëse menaxhohet mirë, ushtria mund të bëhet mjet që do të ndihmojë zhvillimin e një shteti të ri stabil dhe pa identitet etnik. Ndërtimi i një ushtrie profesionale, të bashkuar dhe që përfaqëson të gjitha komunitetet, në një shtet të përcarë thellë mes shumicës shqiptare dhe pakicës serbe refuzuese, kërkon që hapat të zgjidhen me kujdesin më të madh. Ata që nuk dëshirojnë nuk mund të detyrohen të bëhen bashkë. E për ndërtimin e ushtrisë nuk bën të mos merren në konsideratë institucionet ekzistuese dhe shpresat e shumicës.

Të ndërrosh identitetin e Kosovës nga një identitet ekskluzivisht shqiptar në një identitet multi-etnik apo së paku etnikisht neutral, do të jetë një punë e vështirë. Bashkësia ndërkombëtare duhet të jetë realiste dhe të përdorë me kujdes levat që ka, e jo t'i humbasë ato. Nuk duhet të anashkalojë rastin që ofron TMK-ja – me evoluimin e pjesshëm nga rrënjë paramilitare, me varësinë nga NATO dhe nevojën për ekspertizën e saj dhe me vullnetin për të ndërruar – që të ketë duar më të lira në farkëtimin e ushtrisë së re.

Nëse e lëmë anash çështjen e bagazhit historik të TMK-së, propozimet specifike që po përpilohen për të transformuar atë në një ushtri të re apo për të krijuar një forcë krejtësisht të re janë shumë të ngjashme. Disa parashikojnë një forcë mbrojtëse të bazuar në këmbësori e që do të ishte një strukturë e veçantë, ndërsa TMK-ja do të mbetej një degë e ndarë e mbrojtjes civile dhe inxhinierisë. Planet e përpiluara nga vet TMK-ja propozojnë që këto dy struktura të jenë në kulmin e ushtrisë së ardhshme. Sipas cilësdo qasje, së paku gjysma e TMK-së së tashme do të demobilizohet dhe shumica e pjesëtarëve që kalojnë testin do të hynin në degën e

²⁷¹ Intervistë e Grupit të Krizave me një diplomat gjerman, 28 qershor 2006.

mbrojtjes civile dhe të inxhinierisë e jo në brigadën e këmbësorisë që do të bazohej kryesisht në rekrutë të ri.

Nëse rezultatet do të jenë të ngjashme me këtë që u tha, nuk është e nevojshme që tranzicioni të bëhet në mënyrë të vrazhdë. Është e dobishme që TMK-ja ta shohë procesin, si një tranzicion i radhës e jo si përjashtim të saj nga procesi dhe si proces i shpërbërjes së saj. Bërja bashkë e dy strukturave nën një kulm do të kushtonte më pak se sa mbajtja e dy organizatave. Njësoj sikur që do të ishte e panevojshme e madje edhe e dëmshme që në këtë fazë njësitë speciale, kufitare dhe ato SWAT të SHPK-së të transferohen në sferën ushtarake gjë që do t'i hiqte TMK-së funksionet e statusit ushtarak.

Ushtria duhet të jetë e vogël – mes 2.000 e 3.000 trupa – e pajisur me armatim të lehtë dhe e trajnuar nga një mision i veçantë i NATO-së, sipas një plani dhe orari transparent. Nuk duhet të dyfishojë funksionet e SHPK-së por të ndërtohet e orientuar kah operacionet jashtë vendit, duke bërë hapat e parë operacionale në iniciativat rajonale dhe në paqeruajtje ndërkombëtare. Një mundësi për misionin e parë jashtë vendit duhet të kërkohet qysh në vitin 2007, duke përfutur nga përvoja e TMK-së siç është deminimi. Angazhimi në sigurinë e brendshme duhet të jetë shumë i kufizuar dhe të mos shkojë më larg se sa kompetencat që ka sot TMK-ja.

Një letër, aneks apo ndonjë formë tjetër legalisht apo politikisht obliguese, e përpiluar dhe e autorizuar nga Grupi i Kontaktit apo NATO, që do t'i shtojë marrëveshjes për statusin final, e pranuar edhe nga Këshilli i Sigurimit dhe nga Kuvendi i Kosovës,²⁷² do të duhej të kodifikonte krijimin e ushtrisë së re, të caktonte kufijtë për madhësinë e saj dhe kompetencat e ushtrisë si dhe rolin e NATO-së në mbikëqyrjen e saj. Synimi është që Kosova gradualisht të përgatitet për anëtarësim në PpP të NATO-s (bashkë me Serbinë) dhe pastaj marrëveshja do të zëvendësohej me një trakt tjetër të ri.

Çdo vonesë në aktivizimin e ushtrisë së Kosovës duhet të arsyetohet me trajnime pro-aktive dhe programe për shtim të kapaciteteve. Këto vite të ndërmjetme nuk duhet të shihen si vakum por si angazhim për ngritjen graduale të standardeve të ushtrisë, nën udhëheqjen e NATO-s, deri sa ajo të jetë e gatshme të jetë plotësisht operacionale. Ky përkushtim, tani i vërtetuar, i bashkësisë ndërkombëtare do të ndihmonte të qetësohen kapardisjet e palëve të ndryshme rreth të ardhmes së Kosovës, do të ndihmonte që Kosova gradualisht të bëhet burim i stabilitetit dhe do të garantonte barazinë e saj me fqinjët e vet.

KFOR-i i NATO-s, natyrisht, do të qëndrojë edhe pasi të përcaktohet statusi final, por pyetja është për sa? Është e mundur që pas disa viteve SHBA-ja do të dojë të tërheqë forcat e veta dhe t'ia dorëzojë punën një force të BE-së, siç ka bërë në Bosnjë. Kjo do t'i dobësonte forcat që garantojnë sigurinë dhe mund t'i japë BE-së më tepër punë se sa që mund të kryejë në mënyrë konstruktive. NATO duhet ta vlerësojë me kujdes marrëdhënien që ka me Kosovën.

A duhet që ushtria e re e Kosovës në fund të marrë rolin mbrojtës që luan KFOR-i dhe, nëse po, a duhet që kjo të bëhet sipas një marrëveshjeje? Caktimi i orareve mund t'i bëjë të gjithë peng të rrethanave; më e preferueshme është që kjo të bëhet me vlerësimin e standardeve të arritura. Si një mision paqeruajtës ndërkombëtar, KFOR-i nuk mund të integrojë forcat vendore nën komandën e vet. Më e preferueshme është që pasi Kosova të kualifikohet dhe anëtarësohet në PpP, atëherë mekanizmat e PpP-së të përdoren që ushtria të përgatitet për të marrë rolin e KFOR-it dhe në fund t'ia mundësojë KFOR-it që të tërhiqet krejtësisht.

Shumë varet nga ajo se si Serbia do të pranojë statusin e ri të Kosovës dhe nga përparimi i saj drejt integritetit Evropë-Atlantike. Nëse izolimi i saj thellohet dhe Serbia bëhet burim jostabiliteti në rajon, atëherë edhe prezenca prej 20 viteve e KFOR-it nuk do të mjaftojë. Nëse Serbia shpejt i përshtatet realitetit dhe vendos që të ndihmojë progresin e Kosovës, atëherë KFOR-i shumë më herët do të bëhet i panevojshëm. Megjithatë, NATO duhet të planifikojë që të qëndrojë një kohë të gjatë në Kosovë; nëse jep shenja se mendon të largohet para kohe, kjo do të mund të kishte reperkusione. Gjithashtu, shumë varet edhe nga vet progresi në Kosovë, në ndërtimin e një qeverisjeje të mirë, që tejkalon ndarjen mes komuniteteve dhe sjell zhvillim ekonomik, që do të pengojë trazirat sociale dhe do të zvogëlojë ndikimin e krimit të organizuar.

NATO duhet të ketë rol të fuqishëm këshillëdhënës në zhvillimin e politikës mbrojtëse të Kosovës dhe duhet të mbajë së paku kontroll të dyfishtë mbi ushtrinë për aq gjatë sa KFOR-i të jetë këtu. Ndërkohë Kosova duhet të zhvillojë kapacitete e veta. Zyra e Koordinatorit të TMK-së duhet të bëhet themeli mbi të cilën do të ndërtohet ministria e mbrojtjes. Që nga fillimi i vitit 2007, Koordinatorin (që duhet të ndërrojë emrin dhe t'i raportojë KFOR-it e jo UNMIK-ut) duhet të jetë një ndërkombëtar që është nëpunës civil i çështjeve të mbrojtjes e jo gjeneralmajor siç është rasti tani. Gjatë dy viteve të ardhshme, stafi ndërkombëtar duhet të marrë rol këshillëdhënës ndërsa ministri i mbrojtjes të caktohet në vitin 2008.

Kosova duhet të zhvillojë dhe mekanizma dhe shprehë të qeverisjes gjithëpërfshirëse të sektorit të sigurisë. Këshilli

²⁷² Shih Raport për Evropë i Grupit të Krizave numër 161, Kosova: Drejt statusit final, 24 janar 2005.

kombëtar i sigurisë duhet të përfshijë serbët e Kosovës, duhet të themelohet si i pavarur dhe të koordinojë politikën, me rregulla që ndihmojnë të tejkalohen taktikat e bojkotit të liderëve serbë që duket se do t'i ndërmarrin. Misioni mbikëqyrës ndërkombëtar që do të themelohet pas statusit final duhet të dërgojë një zyrtar të vet që të zë këtë vend të mbetur bosh (për shkak të refuzimit të liderëve të serbëve të Kosovës) dhe të përfaqësojë interesat e tyre.

NATO dhe BE-ja duhet të vazhdojnë të bëjnë presion mbi Prishtinën që kjo të tregohet më kreative në akomodimin

e serbëve të Kosovës në përgjithësi e në veçanti sa i përket sigurisë. NATO e BE-ja duhet të punojnë bashkërisht edhe në krijimin e një atmosfere të përkrahjes së iniciativave të Prishtinës. Anëtarësimi i Serbisë në BE dhe në NATO duhet që pjesërisht të kushtëzohet me trajtimin që i bën fqinjët jugor: nëse i inkurajon apo i dekurajon serbët e Kosovës që të integrohen në shtetin e ri, e sidomos nëse e nxit veriun serb që të ndahet apo e udhëzon që të pajtohet me Prishtinën.

Prishtinë/Beograd/Bruksel, 28 korrik 2006

SHTOJCA A

HARTË E KOSOVËS

Kosova / Kosovo

Produced by




The boundaries and names displayed on this map do not imply official recognition by the United Nations

Source: NIMA, WEU

SHTOJCA B**FJALORTH I SHKURTESAVE DHE I AKRONIMEVE**

| | |
|----------------|--|
| AAK | Aleance për Ardhmërinë e Kosovë, parti politike e udhëhequr nga Ramush Haradinaj |
| AKSH | Armata Kombëtare Shqiptare, lëvizje guerile “fantazmë” e shpallur organizatë terroriste nga Misioni i OKB-së në Kosovë në vitin 2003 |
| COMKFOR | Komandanti i KFOR-it |
| ZPSSP | Zëvendës Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm |
| BE | Bashkimi Evropian |
| FARK | Forcat e Armatosura të Republikës së Kosovës |
| FPU | Njësitë e Formuara të Policisë (anglisht: F ormed P olice U nits), në fakt njësitë speciale kundër trazirave |
| GDP | Prodhimi i përgjithshëm vendor (anglisht: G ross D omestic P roduct) |
| FMN | Fondi Monetar Ndërkombëtar |
| IOM | Organizata Ndërkombëtare për Migrim (anglisht: I nternational O rganisation for M igration) |
| ISSR | Rishikimi i Sektorit për Siguri të Brendshme (anglisht: I nternal S ecurity S ector R eview) |
| APJ | Ushtria Popullore e Jugosllavisë |
| SHKK | Shërbimi Korrektues i Kosovës (burgjet) |
| KFOR | Forca paqeruajtëse ndërkombëtare në Kosovë e udhëhequr nga NATO |
| UÇK | Ushtria Çlirimtare e Kosovës por edhe Ushtria Çlirimtare Kombëtare |
| TMK | Trupat Mbrojtëse të Kosovës, strukturë e mbrojtjes civile, pasardhëse e UÇK-së |
| GZHTMK | Grupi për Zhvillim i TMK-së, i njohur me akronimin anglisht KPCDG (K osovo P rotection C orps D evelopment G roup) |
| SHPK | Shërbimi Policor i Kosovës |
| K-SHIK | Shërbim jozyrtar i inteligjencës i afërt me PDK-në |
| LDK | Lidhja Demokratike e Kosovës, partia më e madhe politike në Kosovë, që udhëhiqej nga kryetari i ndjerë Ibrahim Rugova |
| LKÇK | Lëvizja Kombëtare për Çlirim e Kosovës |
| LPK | Lëvizja Popullore e Kosovës |
| BSHK | Brigada Shumë-Kombëshe, deri në vitin 2005 një nga pesë komponentet rajonale të KFOR-it |
| TFSHK | Task-Forca Shumë-Kombëshe, gjashtë pasardhëset më fleksibil të BSHK-ve të KFOR-it |
| MUP | Ministria e Punëve të Brendshme e Serbisë |

| | |
|---------------|---|
| IPVQ | Institucionet e Përkohshme të Vetë-Qeverisjes |
| KNS | Këshilli Nacional Serb, organizatë politike ombrellë e serbëve të Kosovës |
| KS-OKB | Këshilli i Sigurimit i OKB-së |
| NATO | Organizata e Traktit Veri-Atlantik (N orth A tlantic T reaty O rganisation) |
| OKB | Organizata e Kombeve të Bashkuara |
| OSBE | Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë |
| PDK | Partia Demokratike e Kosovës, pasardhësja kryesore politike e UÇK-së dhe partia më e madhe opozitare, e udhëhequr nga Hashim Thaçi |
| PpP | Partneriteti për Paqe i NATO-s |
| PSSP | Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara |
| ROSU | Njësitë Rajonale për Mbështetje të Operacioneve, njësitë speciale të SHPK-së, të njohura me akronimin në gjuhën angleze: ROSU (R egional O perational S upport U nit) |
| RTK | Radio Televizioni i Kosovës, transmetuesi publik në Kosovë |
| SWAT | Njësitë policore me armë dhe taktika speciale, akronim në gjuhën angleze sipas S pecial W eapons and T actics |
| TRADOC | Komanda e Trajnimit dhe Doktrinës e TMK-së, akronim në gjuhën angleze sipas T rainning and D octrine C ommand |
| UÇPMB | Ushtria Çlirimtare e Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit |
| UNDP | Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara, akronim në gjuhën angleze sipas U nited N ations D evelopment P rogram |
| UNMIK | Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë |
| UNOSEK | Zyra e Emisarit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, për Procesin e Statusit të Ardhshëm të Kosovës, akronim sipas emrit në gjuhën angleze U nited N ations O ffice of the S pecial E nvoy of the S ecretary-General for the future status process for K osovo |